



Bruksel, 30.10.2024  
DPS(2024) 692 përfundimtar

## **DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT**

### **Raporti për Kosovën\* – 2024**

#### *Shoqëron dokumentin*

#### **KOMUNIKATË NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK E SOCIAL EVROPIAN DHE KOMITETIN E RAJONEVE**

#### **Komunikata e vitit 2024 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së**

{KOM(2024) 690 final} - {DPS(2024) 690 final} - {DPS(2024) 691 final} –  
{DPS(2024) 693 final} - {DPS(2024) 694 final} - {DPS(2024) 695 final} –  
{DPS(2024) 696 final} - {DPS(2024) 697 final} - {DPS(2024) 698 final} –  
{DPS(2024) 699 final}

---

\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet lidhur me statusin dhe në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

## Përmbajtja

1. Hyrje .....	3
1.1 Konteksti .....	3
1.2 Gjetjet kryesore të raportit .....	3
2. Bazat e procesit të aderimit .....	22
2.1. Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike.....	22
2.1.1 Demokracia.....	22
2.1.2 Reforma e administratës publike .....	24
2.2. Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore.....	26
2.2.1 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.....	26
2.2.2. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria .....	40
2.3. Zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria .....	48
2.3.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut .....	48
2.3.2 Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE .....	52
2.4. Prokurimi publik, statistikat dhe kontrolli financiar .....	54
Kapitulli 5 – Prokurimi publik .....	54
Kapitulli 18 – Statistikat .....	56
Kapitulli 32 – Kontrolli financiar .....	57
3. Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal.....	58
4. Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë .....	59
5. Standardet evropiane.....	63
Grupimi tematik 2: Tregu i brendshëm .....	63
Kapitulli 1 - Lëvizja e lirë e mallrave .....	63
Kapitulli 2 - Liria e lëvizjes së punëtorëve .....	64
Kapitulli 3 - E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve .....	64
Kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitali.....	65
Kapitulli 6 – E drejta e kompanive .....	65
Kapitulli 7 – E drejta e pronësisë intelektuale.....	66
Kapitulli 8 – Politikat e konkurrencës.....	67
Kapitulli 9 – Shërbimet financiare .....	68
Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit.....	69
Grupimi tematik 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse .....	70
Kapitulli 10 – Transformimi digjital dhe media .....	70
Kapitulli 16 – Tatimet .....	71
Kapitulli 17 – Politikat ekonomike dhe ato monetare.....	72
Kapitulli 19 – Politikat sociale dhe punësimi.....	73
Kapitulli 20 – Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë .....	74

Kapitulli 25 – Shkenca dhe kërkimet shkencore.....	75
Kapitulli 26 – Arsimi dhe kultura .....	76
Kapitulli 29 – Unioni doganor.....	78
Grupimi tematik 4: Agjenda e gjelbër dhe lidhjet e qëndrueshme infrastrukturore .....	78
Kapitulli 14 – Politikat e transportit.....	79
Kapitulli 15 – Energjia .....	80
Kapitulli 21 – Rrjetet trans-evropiane .....	82
Kapitulli 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike .....	82
Grupimi tematik 5: Resurset, bujqësia dhe kohezioni .....	84
Kapitulli 11 – Bujqësia .....	84
Kapitulli 12 – Siguria e ushqimit, politikat e veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë .....	85
Kapitulli 13 – Peshkataria dhe akuakultura .....	86
Kapitulli 22 – Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore .....	86
Grupimi tematik 6: Marrëdhëniet me jashtë.....	87
Kapitulli 30 – Marrëdhëniet me jashtë .....	87
<b>SHTOJCA I – MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-SË DHE KOSOVËS .....</b>	<b>89</b>
Shtojca II – Të dhëna statistikore.....	91

# 1. HYRJE<sup>1</sup>

## 1.1 KONTEKSTI

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë është në fuqi që nga prilli i vitit 2016. Kosova paraqiti kërkesë për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022. Autoritetet mbesin të përkushtuara në rrugën evropiane të Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar dialogu i ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të dy palët janë zotuar të zbatojnë plotësisht të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Aneksi i Zbatimit të saj, të arritur në vitin 2023. Angazhimi konstruktiv në normalizimin e marrëdhënieve të tyre është kërkesë edhe në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor. Në përputhje me deklaratën e 3 qershorit 2023 të Përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së, BE është duke zbatuar masa të kthyeshme ndaj Kosovës. Përfaqësuesi i Lartë ka rekomanduar heqjen e atyre masave.

Nga 1 janari 2024, mbajtësit e pasaportave të Kosovës gëzojnë të drejtën e udhëtimit pa viza në BE.

Kosova është angazhuar në mënyrë aktive në zbatimin e Planit të ri të për Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor në katër shtyllat: (i) integrimi gradual me tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian; (ii) integrimi ekonomik rajonal; (iii) reformat themelore; dhe (iv) rritja e mbështetjes financiare. Më 9 tetor Kosova ka miratuar Agjendën e saj të Reformave të paraparë me Instrumentin për Reforma dhe Rritje Ekonomike<sup>2</sup> (Planin për Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor). Agjenda e Reformave mbulon hapat e reformave në këto fusha: (i) qeverisja, reforma e administratës publike dhe menaxhimi i financave publike; (ii) tranzicioni i gjelbër dhe ai digjital; (iii) zhvillimi i sektorit privat; (iv) zhvillimi dhe ruajtja e kapitalit njerëzor; dhe (v) bazat e aderimit në BE dhe sundimi i ligjit.

## 1.2 GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT<sup>3</sup>

### BAZAT E PROCESIT TË ADERIMIT

#### Demokracia

Korniza për **zgjedhjet** është e favorshme për organizimin e zgjedhjeve demokratike. Kosova ka vazhduar të konsolidojë kornizën e re ligjore për zgjedhjet. Më 21 prill 2024, Kosova ka mbajtur një votim për largimin e kryetarëve të komunës me qëllim të hapjes së rrugës për zgjedhje të reja lokale në veri të Kosovës. Përkundër disa sfidave, votimi në përgjithësi ishte i organizuar mirë. Megjithatë, ai ka dështuar për shkak të pjesëmarrjes jashtëzakonisht të ulët të votuesve pas vendimit të partive politike që përfaqësojnë serbët e Kosovës në veri për t'u tërhequr nga procesi dhe për të bërë thirrje për bojkot. Është kritike që në të katër komunat në veri të mbahen zgjedhje lokale gjithëpërfshirëse në të cilat serbët e Kosovës marrin pjesë pa parakushte.

**Kuvendi** përballet me një sërë sfidash në ushtrimin e kompetencave të tij. Qeveria edhe më tej ka shumicë solide në Kuvend, por mosmarrëveshjet dhe mungesa e bashkëpunimit brenda shumicës

<sup>1</sup> Raporti i vitit 2024 paraqitet në një format dhe strukturë të rinovuar. Gjetjet kryesore të raportit (paraprakisht kutitë e vlerësimit me ngjyrë gri), së bashku me rekomandimet janë bashkuar dhe gjenden në fillim të raportit. Për më tepër, në pjesën për bazat e integritimit në BE, për lexueshmëri dhe krahasueshmëri më të mirë në të gjitha raportet, të dhëna të caktuara jepen (edhe) në formë diagramesh.

<sup>2</sup> GZ L, 2024/1449, 24.5.2024.

<sup>3</sup> Ky raport mbulon periudhën nga 15 qershori 2023 deri më 1 shtator 2024. Ai bazohet në të dhëna nga një sërë burimesh, përfshirë kontributet nga qeveria e Kosovës dhe Shtetet Anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informata nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare. Ai përfshin edhe rezultatet e vlerësimeve dhe indekseve krahasuese të nxjerra nga palë të tjera të interesit, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit.

Në raport përdoren këto nivele të vlerësimit për të përshkruar gjendjen aktuale: fazë e hershme, njëfarë niveli i përgatitjes, nivel mesatar i përgatitjes, nivel i mirë i përgatitjes dhe nivel i avancuar. Për të përshkruar përparimet e arritura gjatë periudhës raportuese, në raport përdoren këto nivele: kthim prapa, nuk ka progres, progres i kufizuar, pak progres, progres i mirë dhe progres shumë i mirë. Aty ku është e përshtatshme, gjithashtu përdoren hapa të ndërmjetëm.

dhe me partitë opozitare kanë penguar aftësinë e Kuvendit për të miratuar ligje, për të emëruar anëtarë të organeve publike dhe për të ofruar mbikëqyrje efektive. Anëtarët e *Listës Serbe* kanë bojkotuar punën e Kuvendit gjatë periudhës raportuese. Forcimi i ndërtimit të konsensusit, transparencës dhe mbikëqyrjes mund të përmirësojë punën e Kuvendit dhe të ndihmojë në krijimin e një procesi legjislativ më të qëndrueshëm dhe më efikas. Kuvendi duhet të përmirësojë menaxhimin e tij të brendshëm, të miratojë planet e punës dhe të vë në funksion një sistem votimi elektronik dhe për regjistrimin e vijueshmërisë.

Institucionet përgjegjëse për procesin e **integritit** janë kryesisht të vendosur. Ndonëse Kosova ka demonstruar përkushtim të fortë ndaj agjendës së saj të BE-së, politika e brendshme përçarëse ka penguar zbatimin. Qeveria duhet të punojë për të krijuar mbështetje politike ndërpartiake për të zbatuar në mënyrë më efektive reformat në për integrim në BE. Ajo gjithashtu duhet të përfshijë ministrinë e linjës në vendimet që lidhen me politikën e BE-së nën përgjegjësinë e tyre dhe të rrisë koordinimin ndërministror.

Sa i përket **qeverisjes**, iniciativat për ndryshimin e përgjegjësive të disa ministrive janë pritur me kritika për mungesë të konsultimeve publike dhe mospërfilljen e rreziqeve të mundshme që lidhen me këto reforma. Kosova ka bërë progres të dukshëm në përmirësimin e barazisë gjinore në nivelin qendror dhe atë lokal. Ka vazhduar të ketë sfida në marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe institucioneve qendrore.

Organizatat e **shoqërisë civile** (OSHC-të) në Kosovë veprojnë në një mjedis kryesisht të favorshëm. Shoqëria civil mbetet aktive dhe e larmishme, duke luajtur rol domethënës në hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e reformave për integrim në BE. Kosova ka ndërmarrë veprime konkrete për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e financimit publik të OSHC-ve, por edhe më tej ka sfida në raportimin dhe vlerësimin e efektivitetit të fondeve të ndara.

## Reforma e administratës publike

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** dhe ka bërë **progres të kufizuar** në zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar. Kosova ka avancuar në zvogëlimin e barrës administrative duke thjeshtësuar procedurat përmes zbatimit të programit përkatës për periudhën 2022-2027. Megjithatë, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative mbetet pamjaftueshëm i zbatuar për të garantuar sigurinë juridike. Në përgjithësi, ky sektor vazhdon të përballet me disa sfida në sigurimin e një sistemi rekrutimi dhe shpërblimi në shërbimin civil që funksionon mirë dhe që mund të mbajë dhe tërheqë staf të kualifikuar. Vonesat në zbatimin e reformave për të ristrukturuar agjencitë në vartësi i zgjasin jetën organizimit joefikas të administratës, me linja të paqarta llogaridhënieje.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar dhe vlejné akoma. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të përmirësojë sistemin për shërbim civil meritator përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë në përputhje me parimin e meritës dhe Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në përputhje me vendimin përkatës të Gjykatës Kushtetuese;
- të përmirësojë efikasitetin e shërbimit civil përmes: (i) reduktimit të numrit të pozitave të paplotësuar dhe atyre të zyrtarëve të lartë menaxherialë që janë ushtrues detyre dhe zbatimit të planifikimit dhe monitorimit efektiv vjetor të menaxhimit të burimeve njerëzore; (ii) finalizimit të procesit të klasifikimit dhe sistemit të vendeve të punës; dhe (iii) finalizimit të rishikimit të organizimit të brendshëm të organeve publike në nivelin qendror;
- të përmirësojë llogaridhënien dhe sigurinë juridike të administratës publike përmes: (i) përsheptimit të procesit të racionalizimit të agjencive të pavarura; dhe (ii) vazhdimin të zvogëlimit të barrës administrative dhe digjitalizimit të shërbimeve;
- të rishikojë legjislacionin për menaxhimin e financave publike për ta përafëruar atë me standardet ndërkombëtare, në veçanti përmes vënies në fuqi të një kërkesë formale për të përgatitur dhe

publikuar rregullisht një deklaratë të rrezikut fiskal si pjesë e dokumentacionit të buxhetit; dhe sigurimit që metodologjia e investimeve publike të jetë e integruar në legjislacionin e rishikuar.

## Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

---

Kosova gjendet **ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes** për zbatimin e *acquis*-së së BE-së dhe standardeve evropiane në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore. Kosova ka bërë **progres të kufizuar** përmes përmirësimit të funksionimit të gjyqësorit, avancimit të luftës kundër korrupsionit dhe forcimit të mbrojtjes së të drejtave themelore.

### ***Funksionimi i gjyqësorit***

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** në funksionimin e gjyqësorit dhe ka bërë **progres të kufizuar**. Kosova ka arritur shkallë më të lartë të zgjidhjes së lëndëve dhe ka arritur të zvogëlojë numrin e mbetur të lëndëve të pazgjidhura civile. Janë bërë përmirësime të vazhdueshme në përdorimin e Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve. Funksionimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) është përmirësuar në aspektin e komunikimit dhe transparencës, ndërsa Kuvendi më në fund ka zgjedhur të tre anëtarët porotë të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Megjithatë, vonesat dhe përpjekjet e vështira për të hartuar së bashku reformat në drejtësi në përputhje me Deklaratën e Përbashkët të Zotimit, të marsit 2023, tregojnë mungesë të përsëritur të vullnetit për të forcuar sistemin e drejtësisë. Konsultimet për këto reforma dhe për amendamentet në Ligjin për KPK-në janë nxituar dhe nuk është siguruar shqyrtim kuptimplotë. Përkundër këshillave të forta të BE-së, Komisioni i Venedikut nuk është konsultuar nga Qeveria dhe Kuvendi lidhur me amendamentet përfundimtare në Ligjin për KPK-në dhe për reforma të tjera kyçe. Kjo ka ndikuar negativisht në cilësinë e legjislacionit dhe përafrimin e tij me standardet evropiane. Ka vazhduar puna në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, por nevojitet përparim më i shpejtë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe akoma vlejnë gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të sigurojë që legjislacioni lidhur me integritetin dhe llogaridhënien e gjyqësorit të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe rekomandimet përkatëse të Komisionit të Venedikut, dhe të përshpejtojë përdorimin e mekanizmave ekzistues për llogaridhënien, integritetin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë në rolet dhe përgjegjësitë e KPK-së dhe KGJK-së lidhur me zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe politikave;
- të reformojë më tej administratën gjyqësore dhe të forcojë kapacitetet menaxhuese të prokurorisë dhe gjyqësorit për të arritur objektivat strategjike në mënyrë efektive, përfshirë reduktimin e mëtejshëm të numrit të rasteve të pazgjidhura bazuar në një plan të qartë veprimi me auditime dhe kontroll të brendshëm, dhe zbatimin e strategjisë së TI-së;
- të sigurojë hetime të plota penale, të përmirësojë cilësinë e aktakuzave dhe të sigurojë procedura penale efektive, përfshirë rastet e dhunës me bazë gjinore. Për këtë qëllim, të forcohet bashkëpunimi ndërmjet prokurorëve dhe policisë, si dhe roli drejtues i prokurorëve në hetime.

### ***Lufta kundër korrupsionit***

Kosova është **ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes** në luftën kundër korrupsionit dhe në përgjithësi ka bërë **progres të kufizuar**. Edhe më tepër institucione kanë miratuar plane integriteti. Kuvendi ka miratuar Ligjin për Prokurorinë Speciale (PSRK), me qëllim të forcimit të trajtimit nga drejtësia penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Ka pasur disa përparime në gjykimin e rasteve të korrupsionit, gjë që ka rezultuar në një numër më të madh vendimesh dhe dënimesh të formës së prerë nga gjykatat. Megjithatë, rezultatet ndikohen nga pamjaftueshmëria e burimeve e kapaciteteve dhe nga mungesa e paanshmërisë e llogaridhënies në shërbimin prokurorial dhe gjyqësor. Angazhimi më i fortë për të arritur rezultate solide në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë mbetet i domosdoshëm, përfshirë forcimin e përdorimit të instrumenteve kundër korrupsionit, si deklarimi i pasurisë dhe integritetit të institucioneve

publike.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe gjerësisht vlejné akoma. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të forcojë më tej kapacitetet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) në aspektin e stafit dhe ekspertizës, për të siguruar që ajo të mund të ushtrojë mandatin e saj në mënyrë efektive;
- të zbatojë më tej legjislacionin ekzistues kundër korrupsionit; të miratojë një strategji kombëtare dhe plan veprimi kundër korrupsionit për periudhën 2024-2027, në përputhje me praktikrat dhe standardet më të mira evropiane;
- të forcojë cilësinë e hetimeve në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, përmes rritjes së kapaciteteve të Njësisë së Posaçme Hetimore të Policisë dhe sigurimit të bashkëpunimit efektiv të saj me PSRK-në.

### ***Të drejtat themelore***

Në përgjithësi, korniza ligjore garanton mbrojtjen e të drejtave themelore dhe është në përputhje me standardet evropiane. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka caktuar një koordinator kombëtar dhe ka ngritur një sekretariat qendror për luftimin e dhunës me bazë gjinore. Është arritur pak progres në zbatimin e Ligjit për të Drejtat e Fëmijëve. Qeveria ka miratuar Strategjinë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve. Kosova më në fund ka zbatuar edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për pronësinë e tokës në Manastirin e Deçanit. Është arritur progres në procesin e verifikimit të diplomave nga universiteti në Mitrovicën e Veriut. Megjithatë, duhet të fuqizohet me tej zbatimi i legjislacionit. Disa masa të Qeverisë kanë minuar të drejtat e komuniteteve joshumicë. Miratimi i Kodit Civil mbetet në pritje.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të adresojë mangësitë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht përmes miratimit të Ligjit për Njohjen e Statusit, Shërbimet dhe Përfitimet, dhe përmirësimit të qasjes së tyre në të drejtat në praktikë;
- të forcojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Strategjisë për Dhunën me Bazë Gjinore; të emërojë një udhëheqës të ri të Agjencisë për Barazi Gjinore; dhe të përmirësojë integrimin gjinor të legjislacionit, rregulloreve dhe politikave;
- të ruajë mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë dhe të përmirësojnë zbatimin e tyre.

### ***Liria e shprehjes***

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** dhe ka bërë **progres të kufizuar**. Janë arritur disa përmirësime në lirinë e mediave, përfshirë qasjen në dokumente publike. Megjithatë, kjo është shoqëruar me zhvillime që janë perceptuar si përpjekje të Qeverisë për të ushtruar kontroll mbi mediat.

Është miratuar Ligji i ri për rregullatorin e mediave. Ai kontribuon në përmirësimin e rregullimit të mediave, por amendamentet e Kuvendit nuk kanë arritur të pasqyrojnë shumicën e rekomandimeve nga BE dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë. Funkionimi i Komisionit të Pavarur të Mediave është përmirësuar. Transmetuesi publik është përballur me paqëndrueshmëri, me një sërë dorëheqjesh në mesin e menaxhmentit të lartë dhe anëtarëve të bordit. Ai duhet të trajtojë me shpejtësi shqetësimet që lidhen me llogaridhënien dhe pavarësinë redaktoriale. Mediat në Kosovë janë pluraliste, por këtij sektori edhe më tej i mungon transparenca dhe qëndrueshmëria financiare. Të dhënat për tregun audiovizual mbesin të pamjaftueshme, përfshirë lidhur me pronësinë dhe financimin e mediave.

Sulmeve kundër gazetarëve u kushtohet vëmendje e duhur nga policia dhe gjyqësori, por akoma ka një nivel pandëshkueshmërie, përfshirë për shkak të vështirësisë për të hetuar rastet komplekse që kanë ndodhur në veri. Mjedisi në veri të Kosovës është kufizues dhe i favorshëm për autocensurë për publikun, mediat dhe OSHC-të.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar dhe vlejné akoma. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të përmirësojë kapacitetet e autoriteteve të prokurorisë, gjyqësorit dhe atyre të zbatimit të ligjit për të trajtuar rastet që lidhen me lirinë e shprehjes;
- të zhvillojë protokolle dhe trajnime për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve, përfshirë mekanizmat për paralajmërim të hershëm dhe reagim të shpejtë; të përmirësojë kushtet e punës së gazetarëve dhe punonjësve të mediave; dhe të forcojë raportimin profesional;
- të sigurojë zbatimin e Ligjit të ri për Komisionin e Pavarur të Mediave përmes sigurimit të përafritit të plotë me *acquis*-në e BE-së dhe standardet evropiane; dhe të shqyrtojë Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës për të siguruar financim të qëndrueshëm, duke ruajtur pavarësinë e saj.

## Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

---

Kosova ka njëfarë niveli të përgatitjes dhe ka bërë njëfarë progresi. Reagimi ndaj sulmit të shtatorit 2023 në Banjskë ka treguar nivel të lartë të profesionalizmit të Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës ka rekrutuar dy gjenerata të reja të zyrtarëve policorë serbë të Kosovës; Prokuroria Speciale (PSRK) ka rekrutuar nëntë prokurorë specialë shtesë. Numri i aktakuzave në rastet e krimit të organizuar është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Ligji i ri për PSRK-në mundëson ngritjen e ekipeve hetimore multidisiplinare për raste komplekse dhe ofron bazë ligjore për Njësinë e Posaçme Hetimore të Policisë për të trajtuar rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Kosova ka miratuar një strategji të re për drogën; është funksionalizuar Observatori Kombëtar i Drogave. Kosova ka përmirësuar qeverisjen e migrimit dhe ka zhvilluar një fushatë informuese për udhëtimin pa viza në BE, që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2024. Kosova gjithashtu ka miratuar një ligj të ri për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të amendamentojë Ligjin për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit për ta harmonizuar plotësisht atë me direktivat përkatëse të BE-së; dhe të rrisë numrin e dënimeve përfundimtare për pastrim parash; të ngritë një qendër kombëtare për luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- të vazhdojë zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor për migrimin; të zbatojë një sistem të integruar të menaxhimit të kufijve në përputhje me legjislacionin aktual dhe praktikën më të mira evropiane; të amendamentojë Ligjin për të Huajt në përputhje me standardet e BE-së; dhe të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e tij me politikat e BE-së për vizat;
- të vazhdojë me organizimin e fushatës së komunikimit për të drejtat dhe detyrimet që lidhen me udhëtimin pa viza në BE, të përmirësojë kontrollet në nisje dhe të angazhohet me shtetet anëtare më të prekura të BE-së për të shmangur aplikimet e pafinancuara për azil.

### ***Lufta kundër krimit të organizuar***

Kosova është ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes në luftën kundër krimit të organizuar dhe ka bërë njëfarë progresi. Bashkëpunimi me Europolin ka avancuar, dhe Kosova ka marrë pjesë në operacione të përbashkëta dhe ka vendosur një zyrtar ndërlidhës në



Europol. Sasia e informatave të shkëmbyera përmes Aplikacionit të Rrjetit për Shkëmbimin e Sigurt të Informatave (SIENA) është rritur ndjeshëm. Riorganizimi i Policisë ka avancuar dhe është në pritje të fazave përfundimtare të proceseve të rekrutimit. Sipas rekomandimeve, Policia e Kosovës i drejton aktivitetet e saj sipas parimeve të policisë së udhëhequr nga inteligjenca dhe zyrtarët e caktuar zbatojnë qasjen e policisë në komunitet. Policia po kryen hetime financiare në mënyrë më sistematike. Është arritur njëfarë progresi në fushën e konfiskimit të pasurive, ndërsa edhe më tej ka nevojë për përmirësime sistematike. Ministria e Punëve të Brendshme dhe agjencitë e saj ekzekutive kanë miratuar plane integriteti. Ka pasur njëfarë progresi në fushën e krimit kibernetik, luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (KAVL).

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejnë akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të gjejë mënyra për të siguruar që përbërja e Policisë të pasqyrojë përbërjen etnike të komunave të Kosovës;
- të miratojë një strategji të re për krimin e organizuar; të përmirësojë më tej hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar të profilin të lartë, përfshirë pastrimin e parave; dhe të shënjestrojë e të identifikojë mënyrë proaktive dhe të përbashkët grupet dhe rrjetet e organizuara kriminale; të forcojë më tej efikasitetin e regjimit të konfiskimit penal, përmes themelimit të një fond konfiskimi dhe rritjes së përdorimit të pasurive të konfiskuara nga prokuroria dhe policia;
- të forcojë përpjekjet për të parandaluar dhe luftuar kontrabandën me migrantë dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

## ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA

### Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** dhe ka bërë **progres të mirë** në zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Rritja e fuqishme ekonomike, ndonëse më e ngadaltë, dhe një performancë e fortë e të ardhurave kanë kontribuar në rënie të mëtejshme të deficitit buxhetor në vitin 2023. Megjithatë, vazhdon të ketë sfida fiskale marrë parasysh bazën e ngushtë tatimore, dobësitë në menaxhimin e investimeve publike dhe mbikëqyrjen e dobët financiare dhe llogaridhënien të ndërmarrjeve publike (NP). Përkundër faktit se është arritur njëfarë progresi, rezultatet e tregut të punës mbetën të dobëta. Sektori bankar vazhdon të jetë i kapitalizuar mirë dhe i qëndrueshëm. Është arritur njëfarë progresi në përmirësimin e mjedisit afarist dhe reduktimin e joformalitetit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejnë akoma gjerësisht. Për të përmirësuar funksionimin e ekonomisë së tregut, Kosova duhet në veçanti:

- të përmirësojë cilësisë e shpenzimeve publike përmes adresimit të dobësive në menaxhimin e investimeve publike;
- të forcojë bazën e të ardhurave përmes reduktimit të zbrazësive dhe përjashtimeve me anë të amendamentimit të legjisllacionit tatimor;
- të zvogëlojë rreziqet fiskale përmes përmirësimit të mbikëqyrjes financiare dhe llogaridhënies së NP-ve.

### Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE

---

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** dhe ka arritur **progres të kufizuar** sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE. Sistemi arsimor nuk ofron shkathtësitë e nevojshme dhe nuk është në përputhje adekuate me nevojat e tregut të punës. Është arritur njëfarë progresi në promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe digjitalizimin e ekonomisë. Kjo e fundit mbetet shumë e varur nga firmat e vogla dhe ato mikro, të

cilat nuk mund të konkurrojnë ndërkombëtarisht. Hapja e tregut është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2019.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe akoma vlejné gjerësisht. Për të përmirësuar konkurrencën dhe për të mbështetur rritjen afatgjatë, Kosova duhet në veçanti:

- të harmonizojë arsimin me nevojat e tregut të punës përmes bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin afarist dhe rishikimit të kornizës ligjore për arsim dhe aftësim profesional (AAP) dhe arsimin e të rriturve;
- të zhvillojë procedura transparente dhe konkurruese për shpërndarjen e energjisë së ripërtëritshme;
- të lehtësojë investimet e sektorit privat dhe të përmirësojë mekanizmat për tërheqjen e IHD-ve në sektorët strategjikë përmes promovimit të adoptimit të produkteve e shërbimeve me vlerë më të lartë të shtuar dhe inovacionit.

## Kapitulli 5 – Prokurimi publik

---

Kosova është **ndërmjet njëfarë niveli dhe një niveli mesatar të përgatitjes** dhe ka bërë **progres të kufizuar** në fushën e prokurimit publik. Kosova ka filluar të rrisë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të prokurimit publik dhe autoriteteve kontraktuese përmes formimit të një sekretariati të përbashkët koordinues. Përkundër disa nismave rregullatore nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), prokurimi publik mbetet i prirur për parregullsi dhe i cenueshëm ndaj korrupsionit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të miratojë një ligj të ri për prokurim publik dhe ligj të ri për koncesionet në përputhje me *acquis*-në e BE-së; të përgatisë legjislacionin përkatës zbatues; dhe të sigurojë zbatimin e duhur të këtij legjislacioni;
- të sigurojë që Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) të jetë plotësisht funksional dhe të mbetet funksionalisht i pavarur, me kapacitete të forcuara për të siguruar që procesi rishikimit të tij të kryhet me kohë, efektiv dhe transparent;
- të përmirësojë platformën e prokurimit elektronik në përputhje me Ligjin e ri për Prokurimin Publik dhe të përmirësojë efikasitetin e tij, përfshirë ndërlidhjen me sistemet e tjera përkatëse qeveritare të TI-së.

## Kapitulli 18 – Statistikat

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. Kosova ka bërë **njëfarë progresi** me shpërndarjen e produkteve të reja statistikore dhe përmirësimin e shpeshtësisë së transmetimit të të dhënave në Eurostat. Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare është kryer dhe rezultatet preliminare janë publikuar në korrik 2024

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të sigurojë qasje më të mirë dhe përdorim më të mirë të burimeve të disponueshme të të dhënave administrative, me fokus në veçanti në përmirësimin e qasjes në të dhënat nga Autoritetet Tatimore dhe Doganat;
- të vazhdojë rritjen e numrit të produkteve statistikore dhe shpërndarjen e tyre nga Eurostat;
- të plotësojë vendet ekzistuese të punës që janë të paplotësuara dhe të forcojë kapacitetet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

## Kapitulli 32 – Kontrolli financiar

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë dhe ka bërë **progres të kufizuar**. Zbatimi i strategjisë së menaxhimit të financave publike për periudhën 2022-2026 dhe plani i saj i veprimit në lidhje me kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP) mbeti i ngadalshëm. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe sigurimi i cilësisë mbesin të ulëta, dhe kapacitetet e njëjësive të auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm mbesin të dobëta. Mbikëqyrja parlamentare e menaxhimit të fondeve publike ka vazhduar të jetë joefikase.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të hartojë dhe miratojë një ligj të ri për menaxhimin e financave publike dhe llogaridhënien bazuar në praktikën më të mirë të BE-së dhe standardet ndërkombëtare; dhe të harmonizojë ligjin për KBFP me ligjin e ri për menaxhimin e financave publike;
- të përmirësojë llogaridhënien menaxheriale të përdoruesve të buxhetit si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal përmes sigurimit që menaxherët të fuqizohen dhe të mbahen përgjegjës bazuar në kritere të qarta të performancës;
- të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe Kuvendit përmes përmirësimit të kontrollit parlamentar të ekzekutimit të buxhetit dhe zbatimit dhe përcjelljes në mënyrë të vazhdueshme dhe efikase të rekomandimeve të auditimit të ZKA-së.

## GRUPIMI TEMATIK 2: TREGU I BRENDSHËM

### Kapitulli 1 - Lëvizja e lirë e mallrave

Kosova është **ndërmjet njëfarë niveli dhe një niveli mesatar të përgatitjes** në këtë fushë. Është arritur **progres i kufizuar** në zbatimin e Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Ligjit për Inspektimet.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të bëjë përpajime në mbikëqyrjen e tregut dhe njohjen reciproke në përputhje me *acquis*-në e BE-së dhe të rrisë kapacitetet zbatuese të organeve të vlerësimit të konformitetit dhe mbikëqyrjes së tregut;
- të vazhdojë zbatimin e Ligjit të ri për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Ligjit për Inspektimet dhe të miratojë aktet nënligjore përkatëse;
- të fillojë zbatimin e kërkesave të Rregullores së BE-së për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (RVAKK).

## Kapitulli 2 - Liria e lëvizjes së punëtorëve

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve dhe ka bërë **progres të kufizuar**. Negociatat për marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me Slloveninë, Kroacinë dhe Austrinë janë duke vazhduar.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të bëjë progres në negociata për marrëveshje të reja dypalëshe për sigurimet sociale, veçanërisht me shtetet anëtare të BE-së;
- të fillojë punën përgatitore për t'iu bashkuar Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES);
- të fillojë punën në legjislacion për të mbrojtur të drejtat e pensionit suplementar të punonjësve të lëvizshëm që kanë punuar jashtë vendit, përfshirë në shtetet anëtare të BE-së.

## Kapitulli 3 - E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

---

Kosova mbetet **mesatarisht e përgatitur** dhe ka arritur **progres të kufizuar**. Tregu postar i Kosovës është plotësisht i liberalizuar dhe korniza ligjore është në përputhje me Direktivën e BE-së për Shërbimet Postare. Megjithatë, ligjet sektoriale akoma nuk janë në përputhje me Direktivën e BE-së për Shërbime dhe plani përkatës i veprimit ka skaduar pa zbatim të kënaqshëm. Pika e vetme e kontaktit nuk është plotësisht funksionale. Kosova duhet të harmonizojë kornizën e saj ligjore me *acquis*-në e BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar vetëm pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të heqë barrierat e identifikuar për të drejtën e themelimit të ndërmarrjeve dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve; dhe të miratojë e zbatojë një plan veprimi për t'i bërë ligjet sektoriale në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të BE-së;
- të harmonizojë Rregulloren për shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare, dhe të forcojë kapacitetet institucionale për të monitoruar dhe siguruar pajtueshmërinë me rregullat e reja në tregun postar;
- të harmonizojë kornizën ligjore me *acquis*-në e BE-së për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, përfshirë me Direktivën për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën për testin e proporcionalitetit, para miratimit të rregullores së re për profesionet.

## Kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitali

---

Kosova është **përgatitur mesatarisht** dhe ka bërë **progres të kufizuar**, me përmirësime në shkëmbimin e informacionit dhe kapacitetet mbikëqyrëse në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar vetëm pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të harmonizojë më tej kornizën ligjore me Direktivën 2 të BE-së për Shërbimet e Pagesave;
- të ndërmarrë veprime për të luftuar krimin ekonomik dhe financiar; dhe të harmonizojë me *acquis*-në e BE-së Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;

→ të vazhdojë me forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar; dhe të forcojë efektivitetin e konfiskimit të pasurive dhe të pasurive të fituara me vepër penale.

## Kapitulli 6 – E drejta e kompanive

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes**, dhe **nuk ka arritur progres** në përafrimin e mëtejshëm të kornizës së saj ligjore me *acquis*-në e BE-së për të drejtën e kompanive.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të finalizojë dhe miratojë projektligjin për shoqëritë tregtare për ta harmonizuar më tej kornizën ligjore me *acquis*-në e BE-së për të drejtën e kompanive;
- të harmonizojë më tej legjislacionin me *acquis*-në më të fundit për përdorimin e instrumenteve dhe proceseve digjitale në të drejtën e kompanive dhe në konvertimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare;
- të harmonizojë më tej kornizën ligjore me *acquis*-në e BE-së për raportimin e kompanive, raportimin ndërmjet vendeve të ndryshme, raportimin për qëndrueshmërinë e korporatave dhe transparencën, si dhe të forcojë si strukturat për mbikëqyrjen e auditimit të institucioneve ashtu edhe pavarësinë/objektivitetin profesional të auditorëve dhe firmave të auditimit; dhe të sigurojë që këto struktura të financohen në mënyrë të mjaftueshme dhe të qëndrueshme.

## Kapitulli 7 – E drejta e pronësisë intelektuale

---

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e të drejtës së pronës intelektuale. Është arritur **njëfarë progresi** me miratimin e Ligjit të ri për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Gjykata Komerciale, e cila është e mandatuar për të zgjidhur rastet dhe mosmarrëveshjet në këtë fushë, ka filluar punën e saj në mënyrë efikase. Kosova duhet të forcojë kapacitetet dhe burimet e saj për të implementuar dhe zbatuar më mirë kornizën ligjore për DPI.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të përmirësojë zbatimin e legjislacionit të miratuar në aspektin e strategjisë dhe kapaciteteve të mjaftueshme;
- të miratojë legjislacionin për zbatimin e ligjeve të pronësisë industriale (për topografitë e produkteve gjysmëpërçuese dhe sekretet tregtare);
- të forcojë bashkëpunimin me Zyrën e Bashkimit Evropian për Pronësi Intelektuale, duke përfutur nga ekspertiza, rrjetet dhe bazat e specializuara të të dhënave të saj.

## Kapitulli 8 – Politikat e konkurrencës

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** dhe ka bërë **progres të kufizuar** në këtë fushë. Ndonëse Kosova ka vazhduar të rishikojë kornizën ligjore të konkurrencës, ajo nuk ka arritur shumë progres në fushën e ndihmës shtetërore.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të ngritë Komision funksional për Ndihmë Shtetërore, në përputhje me detyrimet e MSA-së;

- të harmonizojë kornizën legjislativë në fushën e ndihmës shtetërore me *acquis*-në e BE-së; dhe të sigurojë zbatimin e legjislacionit për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore;
- të garantojë pavarësinë operative dhe kapacitetet funksionale të autoriteteve të konkurrencës dhe atyre për ndihmë shtetërore; dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet të gjitha palëve të interesit, përfshirë ministritë, rregullatorët dhe gjyqësorin.

## Kapitulli 9 – Shërbimet financiare

Kosova është **përgatitur mesatarisht** dhe ka arritur **njëfarë progresi** në qeverisjen e bankës qendrore.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të harmonizojë kornizën e saj ligjore me Direktivën Solvency II; dhe të sigurojë zbatimin e legjislacionit përkatës;
- të vazhdojë përpjekjet për përafrim me *acquis*-në e BE-së lidhur me rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë, fondet e investimeve, shërbimet e investimeve, infrastrukturën e tregjeve financiare dhe financat digjitale;
- të harmonizojë kornizën e saj ligjore me versionet e rishikuara të Direktivës së BE-së për Kërkesat e Kapitalit, Rregulloren për Kërkesat e Kapitalit, Direktivën e Rimëkëmbjes dhe Rezolucionit të Bankave dhe Direktivën e Skemës së Garancisë së Depozitave.

## Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë. Ka pasur **progres të kufizuar** përveç miratimit të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit për Çmimin e Produkteve Farmaceutike.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të miratojë ligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe të zbatojë plotësisht Ligjin për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve;
- të ndërmarrë reformat e duhura të financimit në shëndetësi për të siguruar progres drejt mbulimit universal në shëndetësi; dhe të përmirësojë efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore;
- të zbatojë masa për reduktimin e faktorëve të rrezikut për sëmundjet jo-ngjitëse / gjendjet kronike, për të mbrojtur kapitalin njerëzor dhe siguruar rritje ekonomike në të ardhmen.

## GRUPIMI TEMATIK 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RRIJTJA EKONOMIKE GJITHËPËRFSHIRËSE

### Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e transformimit digjital dhe mediave. Kosova ka bërë **progres të kufizuar** në përgatitjet për të harmonizuar legjislacionin e saj me *acquis*-në e BE-së përmes forcimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe strategjike, veçanërisht me miratimin e strategjisë për e-qeverisje dhe asaj për siguri kibernetike dhe planit përkatës të veprimit. Kosova ka nënshkruar dhe ratifikuar Marrëveshjen e Asociimit me Komisionin Evropian për t'iu bashkuar Programit të Evropës Digjitale të financuar nga BE.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në

vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të harmonizojë legjislacionin e saj me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, Direktivën e BE-së për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit (NIS2), Pakon e Instrumenteve të BE-së për sigurinë kibernetike 5G dhe Aktin e Shërbimeve Digjitale e Aktin e Tregjeve Digjitale;
- të sigurojë që rregullatorit të telekomit dhe atij të mediave t'u ndahen resurse të përshtatshme për të përmbushur mandatin e tyre në mënyrë të pavarur; dhe të zhvillojë një zgjidhje për të siguruar që transmetuesi i shërbimit publik të financohet në mënyrë të qëndrueshme;
- të zbatojë bartshmërinë e numrave për të siguruar shfrytëzimin efektiv të burimeve të numrave dhe nxitjen e konkurrencës.

## Kapitulli 16 – Tatimet

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë dhe ka arritur **njëfarë progresi** në zbatimin e auditimit të bazuar në rrezik dhe digjitalizimin e shërbimeve. Auditimet e pajtueshmërisë dhe masat për formalizim kanë çuar në të ardhura më të larta tatimore.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të iniciojë një rishikim të politikave tatimore, përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi të ardhurat e korporatave, tatimin mbi vlerën e shtuar dhe akcizën; dhe të harmonizojë më tej legjislacionin e tij tatimor me *acquis*-në e BE-së; të miratojë strategjinë e re për luftën kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimin financiar (2023-2026);
- të forcojë kapacitetet administrative dhe profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) përmes vendosjes së rregullave të qarta për vendet e punës, rekrutimin, vlerësimin e performancës, promovimin e bazuar në merita dhe transferimet.

## Kapitulli 17 – Politikat ekonomike dhe ato monetare

---

Kosova është e **përgatitur mesatarisht** dhe ka bërë **njëfarë progresi** në këtë fushë. Pas emërimit të tre zëvendësgubernatorëve dhe riorganizimit funksional të bankës qendrore është normalizuar funksionimi i bankës qendrore. Është arritur njëfarë progresi në mbledhjen e të dhënave dhe transmetimin e tyre në Eurostat. Megjithatë, vazhdon të ketë mospërputhje metodologjike në disa fusha.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të rrisë kapacitetet e saj për të raportuar për statistikën financiare qeveritare sipas ESA 2010; dhe të sigurojë monitorimin e rregullt të standardeve;
- të përmirësojë cilësinë e parashikimeve makroekonomike në procesin buxhetor.

## Kapitulli 19 – Politikat sociale dhe punësimi

---

Kosova është **ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. Ka pasur **progres të mirë**, në veçanti me finalizimin e strategjisë së re të punësimit, hartimin e Ligjit të ri për Punësimin, intensifikimin e inspektimeve në sektorët e punës me rrezikshmëri më të lartë, fillimin e pilotimit të Skemës për Garantimin e Punësimit të Rinjve në dy komuna dhe fillimin e një reforme të thellë për ndihmën sociale. Shkalla e aksidenteve me fatalitet në punë ka rënë në



krahasim me vitet e mëparshme.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në periudhën e ardhshme, Kosova, në veçanti, duhet:

- të përgatitet për zbatimin e plotë të Skemës për Garantimin e Punësimit të Rinjve bazuar në mësimet e nxjerra gjatë fazës së pilotimit; të miratojë Ligjin për Punësimin dhe amendamentet në Ligjin e Punës për të harmonizuar kornizën e saj ligjore me *acquis*-në më të fundit të BE-së, veçanërisht në lidhje me mosdiskriminimin në punësim dhe pushimin prindëror;
- të intensifikojë inspektimet në sektorët e punës me rreziqe më të larta; të miratojë Ligjin e ri për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe strategjinë përkatëse; të zbatojë rregullat dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë; dhe të forcojë dialogun social;
- të vazhdojë reformën e skemave të ndihmës sociale për ta bërë atë pro të varfërve; të përmirësojë qasjen në shërbimet sociale, veçanërisht për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara; dhe të përmirësojë kapacitetet e komunave, në veçanti lidhur me ekzekutimin e buxhetit social, kontraktimin e shërbimeve dhe sigurimin e cilësisë.

## Kapitulli 20 – Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

---

Kosova është e **përgatitur mesatarisht** në këtë fushë dhe Qeveria ka arritur **njëfarë progresi** përmes vazhdimit të zbatimit të Strategjisë 2030 për Zhvillimin e Industrisë dhe Mbështetjen e Bizneseve.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në periudhën e ardhshëm, Kosova, në veçanti, duhet:

- të vazhdojë tutje me zbatimin e strategjisë për zhvillimin e industrisë dhe mbështetjen e biznesit 2030 dhe shtyllën e rritjes së qëndrueshme ekonomike në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2021-2030;
- të përmirësojë urgjentisht kapacitetet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- të përfundojë krijimin e dy agjencive të ndara për promovimin e investimeve dhe mbështetjen e NVM-ve; dhe të sigurojë që të dyja të kenë burime të mjaftueshme.

## Kapitulli 25 – Shkenca dhe kërkimet shkencore

---

Kosova është **në një fazën të hershme të përgatitjes**. Kosova ka arritur **progres të kufizuar** përmes ndërmarrjes së hapave të mëtejshëm drejt një qasjeje strategjike për kërkimin shkencor, për shembull përmes miratimit të Programit Kombëtar të Shkencës për periudhën 2023-2028. Kosova nuk ka mundur të ruaj performancën e arritur në kuadër të programit kornizë të BE-së për kërkime shkencore dhe inovacion.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të hartojë dhe zbatojë një strategji gjinore për kërkim shkencor në nivel kombëtar, si dhe për integrimin dhe promovimin e plotë të grave dhe vajzave në kërkime shkencore dhe në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë;
- të intensifikojë masat për të krijuar një trend pozitiv në pjesëmarrjen e Horizon Europe dhe të avancojë në zhvillimin e një Strategjie të Specializimit të Zgjuar;



→ të krijojë një sistem për të ofruar në mënyrë të besueshme statistikat e kërkimeve shkencore, shkencës e teknologjisë dhe inovacionit.

## Kapitulli 26 – Arsimi dhe kultura

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e arsimit dhe kulturës. Ka pasur **progres të kufizuar** gjatë periudhës raportuese. Zbatimi i ligjit të ri për arsimin e hershëm ka filluar me pilotimin e kurrikulave të reja për vitin akademik 2023/2024. Është miratuar një reformë për rekrutimin e stafit në sektorin e arsimit, përfshirë inspektorët. Përkundër këtyre masave, rezultatet akoma nuk janë të dukshme, dhe akoma ka nevojë për përmirësime të mëdha në cilësinë e arsimit. Pjesëmarrja e Kosovës në Erasmus+ është duke u përmirësuar, gjë që konfirmon trendin pozitiv të vitit të kaluar. Ndërsa Ligji për Artin dhe Kulturën është miratuar, strategjia e kulturës akoma është në pritje për t'u miratuar.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të zbatojë udhërrëfyesin e përshkruar në strategjinë e arsimit të Kosovës për periudhën 2022-2026; dhe të vazhdojë të përcjellë rekomandimet e Diagnostikimit të Shpejtë të Arsimit të kryer nga Fondacioni Evropian për Trajnime, si për qeverisjen e AAP-së dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënësve dhe shkollave;
- të finalizojë zbatimin e kornizës së re të kurrikulës për arsimin bazë; të bëjë rishikimin e teksteve aktuale dhe të ofrojë trajnime të qëndrueshme për mësimdhënësit; të zbatojë sistematikisht mekanizmat e sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit;
- të vazhdojë punën për forcimin e qeverisjes së AAP-së dhe të rrisë cilësinë e arsimit dhe AAP-së për profesionet e kërkuara në funksion të Skemës për Garantimin e Punësimit të Rinjve.

## Kapitulli 29 – Unioni Doganor

---

Kosova është e **përgatitur mesatarisht** dhe ka arritur **progres të mirë** përmes miratimit të Kodit e ri Doganor dhe të Akcizave, zgjerimit të shfrytëzimit të terminaleve doganore publike dhe uljes së ndjeshme të tarifave të terminaleve doganore. Është rritur numri i operatorëve ekonomikë të autorizuar. Janë ndërmarrë hapa të konsiderueshëm për forcimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të Doganës së Kosovës.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të hartojë dhe miratojë legjislacionin zbatues të Kodit të ri të Doganave dhe të Akcizave;
- të vazhdojë të forcojë kapacitetet administrative dhe profesionale të doganave përmes finalizimit dhe zbatimit të Udhëzimit të ri Administrativ, si dhe zbatimit të rregullave të Kodit Doganor dhe të Akcizave për vendet e punës, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe transferimet meritore;
- të heqë të gjitha tarifatat që u ngarkohen eksportuesve/importuesve në терминаlet doganore publike, ato që funksionojnë si publike dhe терминаlet private brenda vendit.

## GRUPIMI TEMATIK 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHJET E QËNDRUESHME INFRASTRUKTURE

### Kapitulli 14 – Politikat e transportit

---

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë dhe ka bërë **njëfarë progresi**

me miratimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së transportit multimodal, miratimit të strategjisë për një sistem të transportit inteligjent dhe hapjes së korridoreve të reja ajrore me Shqipërinë. Kërkohen më shumë veprime për të zbatuar *acquis*-në e BE-së. Rekomandimet e vitit të kaluar akoma vlejné pjesërisht.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të miratojë Ligjin e ri për Rrugët; të investojë në mirëmbajtjen dhe inspektimin e rrugëve; të vazhdojë fushatat parandaluese; dhe të ngritë një mekanizëm monitorimi sistematik për mbledhjen e të dhënave të aksidenteve;
- të harmonizojë kornizën ligjore me *acquis*-në e BE-së, veçanërisht me pakon IV për transport hekurudhor, si për tregun ashtu edhe për shtyllën teknike;
- të miratojë planin e veprimit për strategjinë e sistemit inteligjent të transportit dhe të sigurojë disponueshmërinë e kapaciteteve dhe burimeve të mjaftueshme për zbatimin e saj; dhe të harmonizojë kornizën legislative me *acquis*-në e BE-së për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha llojet e transportit.

## Kapitulli 15 – Energjia

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e energjisë. Kosova ka bërë **njëfarë progresi** në këtë fushë përmes miratimit të Ligjit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, nisjes së bashkimit të tregut me Shqipërinë, përfundimit me sukses të ankandit të parë të energjisë diellore dhe investimeve të mëtejshme në rritjen e eficiencës së energjisë në ndërtesa publike dhe rezidenciale. Megjithatë, Kosova mbetet shumë e varur nga termocentralet e vjetruara me qymyr dhe duhet të përshpejtojë shpërndarjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë në përputhje me strategjinë e saj të re të energjisë. Operatori i Sistemit të Transmisionit të Kosovës, KOSTT, duhet të sigurojë përmbushjen e obligimeve të tij sipas Marrëveshjes së Koneksionit me ENTSO-E, pa devijime nga rrjeti. Kosova duhet të miratojë sa më shpejt që të jetë e mundur planin e saj kombëtar për energji dhe klimë (PKEK), në përputhje me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të miratojë pakon e amendamentuar të ligjeve për energji, për të siguruar përafrimin me Pakon e Integritimit të Energjisë Elektrike dhe Pakon e Energjisë së Pastër; dhe të nisë ankandin e parë për energji të erës;
- të përshpejtojë përmirësimin e aspekteve mjedisore që ndërlidhën me termocentralin Kosova B dhe punimet për dekomisionimin e pjesëve jofunkionale të termocentralit Kosova A;
- të përmirësojë zbatimin e legjislacionit për eficiencë të energjisë, përfshirë në fushën e performancës energjetike të ndërtesave; dhe të vazhdojë shtrirjen e investimeve për eficiencë të energjisë në ndërtesat publike dhe ato rezidenciale.

## Kapitulli 21 – Rrjetet trans-evropiane

---

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. Është arritur **progres i kufizuar** në këtë fushë përmes vazhdimit të punimeve në Linjën Hekurudhore 10 dhe fillimit të bashkimit të tregut të energjisë elektrike me Shqipërinë. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të zbatojë projektet në pritje të koneksionit dhe të forcojë kapacitetet e saj institucionale dhe administrative për zbatimin e projekteve strategjike të infrastrukturës;
- të vazhdojë me punimet e sinjalizimit; dhe të përfundojë fazën e parë të Rrugës Hekurudhore 10;
- të përmirësojë kapacitetet e autoritetit rregullator për komunikime elektronike dhe postare për të zbatuar rregulloret e tregut të telekomunikacionit.

## Kapitulli 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë dhe ka bërë **progres të kufizuar** me miratimin e Ligjit për ndryshimet klimatike, në dhjetor 2023, që ishte i vetmi zhvillim i rëndësishëm. Kapacitetet administrative dhe të burimeve njerëzore në tërë sektorin janë në nivel kritik të ulët dhe paraqesin një pengesë të konsiderueshme për zhvillimin e duhur e progresiv të tij.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të demonstrojë përkushtim politik duke forcuar ndjeshëm kapacitetet administrative të sektorit të mjedisit dhe të klimës në nivelin lokal dhe atë qendror;
- të amendamentojë ligjin për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe të rishikojë strategjinë për menaxhimin e integruar të mbeturinave; dhe të sigurojë që janë marrë masat e duhura për parandalimin *de facto* të ndotjes së zonave të mbrojtura dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura;
- të miratojë PKEK sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të zbatojë ligjin për ndryshimet klimatike, në veçanti kornizën për monitorim, raportim, verifikim dhe akreditim të emetimeve të gazrave serrë, me synimin për të vënë në zbatim çmimoren e karbonit të emetuar, me qëllim të harmonizimit të kornizës ligjore me sistemin e BE-së për tregtimin e emetimeve.

## GRUPI MI TEMATIK 5: BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI

### Kapitulli 11 – Bujqësia

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në bujqësi dhe zhvillim rural. Kosova ka arritur **njëfarë progresi** në këtë fushë me miratimin e ligjit për organizimin e tregut të produkteve bujqësore, programit kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural për periudhën 2023-2027, planit strategjik të sistemit këshillëdhënës të Kosovës për bujqësi dhe zhvillim rural për 2023-2027 dhe planit kombëtar të veprimit për bujqësi organike për periudhën 2023-2026.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të forcojë kapacitetet administrative dhe teknike të Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural (autoritetit menaxhues) dhe Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor (agjencisë së pagesave);
- të miratojë ligjin për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural dhe legjislacionin zbatues për organizimin e tregut të produkteve bujqësore;
- të amendamentojë ose shfuqizojë ligjin për tokën bujqësore; dhe të marrë masa urgjente dhe efektive për të ndaluar humbjen e tokës bujqësore.

### Kapitulli 12 – Siguria e ushqimit, politikat e veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Kosova është ndërmjet njëfarë niveli dhe një niveli mesatar të përgatitjes në këtë fushë. Është

arritur **progres i mirë**. Në veçanti, Kosova ka marrë përgjegjësinë e financimit të plotë të fushatave të vaksinimit kundër tërbimit dhe ka finalizuar sistemin e menaxhimit të informatave laboratorike dhe sistemin e menaxhimit të kontrollit dhe gjurmueshmërisë së ushqimit, i cili është parakusht për një sektor konkurrues agro-ushqimor.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar pjesërisht dhe vlejnë akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit të menaxhimit të kontrollit të ushqimit dhe gjurmueshmërisë dhe të sistemit të menaxhimit të informatave laboratorike; dhe të forcojë kapacitetet administrative të organeve zbatuese përmes rritjes së numrit të stafit dhe ekspertizës;
- të miratojë projektligjin për shëndetin e kafshëve; të miratojë planin pesëvjeçar të zhvillimit për monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve; dhe të sigurojë burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e tyre;
- të fillojë punën për harmonizimin dhe miratimin e legjislacionit në fushën e politikave fitosanitare, në përputhje me *acquis*-në e BE-së.

### Kapitulli 13 – Peshkataria dhe akuakultura

---

Kosova mbetet në **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë kapitull dhe nuk ka arritur **fare progres**.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar dhe vlejné akoma. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të miratojë një strategji shumëvjeçare kushtuar akuakulturës; dhe të forcojë kapacitetet administrative të organeve zbatuese përmes rritjes së numrit të stafit dhe ekspertizës;
- të hartojë një ligj për peshkimin dhe akuakulturën dhe të përafrojë më tej politikën e saj të tregut me *acquis*;
- të krijojë një inventar të llojeve të peshqve që mbulon tërë territorin e Kosovës.

### Kapitulli 22 – Politikën rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

---

Kosova mbetet në **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e politikave rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore. Është arritur **njëfarë progresi** përmes përmirësimit të kornizës legjislative dhe strategjike, programimit dhe monitorimit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma gjerësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të përmirësojë më tej kapacitetet administrative për programimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e fondeve të BE-së, veçanërisht në ministritë e linjës;
- të forcojë menaxhimin e investimeve publike si çështje urgjente përmes miratimit të: (i) listës së përditësuar të përbashkët të projekteve infrastrukturore dhe listave sektoriale, bazuar në përzgjedhje të shëndoshë, transparente dhe gjithëpërfshirëse të investimeve publike; dhe (ii) një metodologji për menaxhimin efektiv dhe transparent të shpenzimeve të Qeverisë për infrastrukturën publike;
- të krijojë një dialog politikash të strukturuar dhe gjithëpërfshirës të bazuar në sektorë për të përmirësuar dhe udhëhequr programimin e fondeve të BE-së dhe koordinimin e mbështetjes së donatorëve.

## GRUPIMI TEMATIK 6: MARRËDHËNIET ME JASHTË

### Kapitulli 30 – Marrëdhëniet me jashtë

---

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e marrëdhënieve me jashtë, ku është arritur **progres i kufizuar**. Përkundër progresit në zbatimin e Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR) për periudhën 2021-2024, Kosova akoma nuk ka ratifikuar protokollet

shtesë të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) për lehtësimin e tregtisë dhe tregtinë e shërbimeve. Kosova duhet të përmbahet nga marrja e masave të mëtejshme të njëanshme tregtare pa arsyetim dhe konsultim paraprak me Komisionin, në përputhje me zotimet e saj të MSA-së. Kosova ka treguar qëndrim konstruktiv në procesin e zhblokimit të vendimmarrjes së CEFTA-s, i cili ka çuar në miratimin e 12 marrëveshjeve. Ndonëse ka pasur rritje të eksportit, deficitin tregtar mbeti i lartë dhe Kosova akoma nuk ka miratuar një politikë gjithëpërfshirëse tregtare.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe vlejné akoma. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti:

- të vazhdojë të zbatojë zotimet sipas Planit të Veprimit për TPR për periudhën 2021-2024 dhe të zbatojë veprimet sipas planit të ri të veprimit për periudhën 2025-2028, të ratifikojë dhe zbatojë Protokollin Shtesë (PSH) 5 të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe PSH 6 për tregtinë e shërbimeve, dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për zbatimin dhe finalizimin e PSH 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të miratojë Rregulloren për themelimin e pikës hetimore për lehtësimin e tregtisë;
- të fillojë procesin e krijimit të politikave për zhvillim dhe ndihmë humanitare.

\* \* \*

## 2. BAZAT E PROCESIT TË ADERIMIT

### 2.1. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE


#### 2.1.1 Demokracia

Funksionimi i institucioneve demokratike ndikohet nga disa sfida. Qeveria ende mban një shumicë solide në Kuvend, por mosmarrëveshjet dhe mungesa e bashkëpunimit brenda shumicës dhe me partitë opozitare vazhdojnë të pengojnë përparimin e rëndësishëm në reformat në lidhje me BE-në. Këto mosmarrëveshje pengojnë aftësinë e Kuvendit për të miratuar ligje, për të emëruar anëtarë të organeve publike dhe për të ofruar mbikëqyrje efektive. Gjithashtu, anëtarët e *Listës Serbe* bojkotuan punën e Kuvendit gjatë periudhës raportuese. Së fundmi, edhe centralizimi i vendimmarrjes ekzekutive dhe mungesa e koordinimit ndërministror ndikuan negativisht në realizimin e reformave.

#### Zgjedhjet

Nuk ka pasur zgjedhje të përgjithshme apo të rregullta lokale gjatë periudhës raportuese. Kosova ka organizuar zgjedhje për kthimin e kryetarëve në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Organizimi i votimit për kthim nuk ishte pa sfida (përfshirë, për herë të parë, vendosjen e kamerave të sigurisë në qendrat e votimit). Më 7 prill 2024, *Lista Serbe* vendosi të tërhiqet nga procesi dhe të bëjë thirrje për bojkot të votimit për tërheqje të kryetarëve aktualë të komunave në fjalë. Kjo ka sjellë një sërë vështirësish, përfshirë krijimin e disa komisioneve të vendvotimeve pa asnjë anëtar serb të Kosovës. Përveç kësaj, drejtorët e shkollave me plan-program të Serbisë në veri të Kosovës vendosën të mos lejojnë përdorimin e shkollave si vendvotime, gjë që ka krijuar sfida serioze për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Duke qenë se ky vendim është marrë pak ditë para ditës së votimit, KQZ është përballur me vështirësi për t'i ofruar publikut informata të sakta për vendndodhjen e qendrave të votimit të zhvendosura nga shkollat në vende të tjera. Pjesëmarrja në votime ishte jashtëzakonisht e ulët (afërsisht 0.5%), duke e bërë votimin për largimin e tyre të pasuksesshëm.

Kosova ka vazhduar të konsolidojë kornizën e re ligjore për zgjedhjet të miratuar në vitin 2023, e cila ka zbatuar rekomandimet nga misionet e njëpasnjëshme të vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së. KQZ duhet: të sigurojë që legjislacioni dytësor, vendimet dhe procedurat janë në përputhje me ligjin e ri për zgjedhjet e përgjithshme; të garantojë votim të fshehtë; të rregullojë votimin jashtë vendit; dhe të



vendosë rregulla për fushatat zgjedhore. Në janar 2024, KQZ ka miratuar një rregullore të brendshme për financat e partive politike, për të cilën duhet të ndahet një buxhet i dedikuar.

Ndonëse edhe më tej të nën-përfaqësuar, gratë luajnë një rol në rritje në vendimmarrje. Korniza ligjore për zgjedhjet e ka bërë të detyrueshme një kuotë gjinore prej të paktën 30% për Kuvendin, ndërsa rregulli në Ligjin për Barazinë Gjinore

për përfaqësim të barabartë parasheh kuotën prej 50%. Avokati i Popullit e ka dërguar ligjin e ri për zgjedhjet në Gjykatën Kushtetuese për të sqaruar këtë mospërputhje.

#### Parlamenti

Kuvendi ka bërë përpjekje për të ruajtur kuorumin për vendimmarrje, duke rezultuar në vonesa dhe bllokada të konsiderueshme. Nga 129 projektligje, 80 janë miratuar, duke përfshirë 25 marrëveshje ndërkombëtare që janë ratifikuar. Disa ligje dhe një duzinë marrëveshjesh ndërkombëtare po barten nga një seancë në tjetrën. Shumica zgjodhi shpesh seanca të jashtëzakonshme dhe procedura të

shpejta për miratimin e legjislacionit kyç. Kuvendi ka shpërfillur afatet procedurale për miratimin e 18 ligjeve dhe ka humbur afatet e përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese për rishikimin e ligjeve. Deputetët nga *Lista Serbe* kanë vazhduar të bojkotojnë punën e Kuvendit, duke kufizuar më tej mundësinë e tij për të miratuar legjislacionin dhe amendamentet kushtetuese.

Refuzimi i Qeverisë për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare ka dobësuar ndjeshëm rolin mbikëqyrës të Kuvendit. Kuvendi ka mbetur i ngadalshëm në shqyrtimin e raporteve vjetore të agjencive të pavarura; një duzinë prej tyre janë nën shqyrtim që nga viti 2022. Kjo i ka kufizuar mundësinë e Kuvendit për t'iu mbajtur agjencitë përgjegjëse dhe për të vlerësuar performancën e tyre. Me nismën e opozitës, Kuvendi ka ngritur disa komisione hetimore parlamentare. Megjithatë, Kuvendi nuk ka arritur t'iu shfrytëzojë ato në mënyrë efektive.

Forcimi i ndërtimit të konsensusit, transparencës dhe mbikëqyrjes mund të përmirësojë performancën e Kuvendit dhe të ndihmojë në krijimin e një procesi legjislativ më të qëndrueshëm dhe efikas. Kuvendi duhet të përmirësojë menaxhimin e tij të brendshëm, të miratojë planet e punës për dy seancat e tij dhe të vë në funksion një sistem votimi elektronik dhe regjistrim të pranishëm.

## **Integrimi në BE**

Përkundër një përkushtimi të fortë në rrugën e saj evropiane, politika e brendshme përçarëse ka penguar zbatimin e agjendës së Kosovës për integrim në BE. Përgjegjësia për agjendën e përgjithshme të BE-së është e zëvendëskryeministrit të parë, i cili nënvizon se sa e rëndësishme është kjo agjendë për Qeverinë. Megjithatë, ky nivel centralizimi gjithashtu kufizon pronësinë politike në ministritë e linjës dhe ngadalëson koordinimin dhe vendimmarrjen. Mungesa e organeve të përhershme koordinuese ndërministrorë në nivel ekspertësh është sfida tjetër. Aktivitetet e integritit në BE janë ndikuar negativisht edhe nga kapacitetet e dobëta administrativ dhe nga fakti që një sërë postesh kyçe në administratën publike mbahen nga zyrtarë që shërbejnë si ushtrues detyre.

Në prill 2024, Qeveria ka miratuar Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024-2028. Kosova rregullisht ka publikuar raporte mbi zbatimin e PKIE dhe Agjendës për Reforma Evropiane dhe ka diskutuar përparimet e arritura në Kuvend.

Në përputhje me deklaratën e 3 qershorit 2023 të Përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së, BE po zbaton masa të kthyeshme ndaj Kosovës. Kjo përfshin pezullimin e punës së organeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

## **Qeverisja**

Nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh në strukturën qeverisëse, por përgjegjësitë e disa ministrive dhe departamenteve janë riorganizuar.

Komunat kanë bërë progres në forcimin e funksionimit dhe ofrimin të shërbimeve të tyre. Ndonëse mbështeten në grantet e Qeverisë, buxhetet e Komunave janë rritur krahas rritjes së përgjithshme të buxhetit. Në vitin 2024, financimi i komunave është rritur për 12% krahasuar me vitin 2023. Marrëdhëniet ndërmjet komunave (kryesisht të udhëhequra nga kryetarët nga opozita) dhe institucioneve qendrore nuk janë përmirësuar.

Kosova ka bërë progres në përmirësimin e barazisë gjinore në nivel lokal, pasi 16 komuna kanë zhvilluar analiza gjinore specifike për sektorin dhe kanë funksionalizuar një kornizë buxhetore afatmesme përfshirëse gjinore dhe 16 plane veprimi.

## **Shoqëria civile**

Shoqëria civile mbetet aktive dhe e larmishme, duke luajtur një rol domethënës në hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e reformave të lidhura me BE-në. Mekanizmat për përfshirjen e shoqërisë civile në vendimmarrje janë funksionale dhe shumica e propozimeve, përfshirë projektligjet, strategjitë dhe koncept dokumentet, ishin të qasshme për konsultim publik në një platformë online. Megjithatë, konsultimet me shoqërinë civile nuk janë në përputhje me rregulloren përkatëse. Qeveria duhet të respektojë periudhën e konsultimit, të sigurojë informacion të plotë për të mundësuar pjesëmarrjen,



të japë komente dhe të publikojë të gjitha projekt-propozimet e përditësuara dhe raportet përfundimtare. Duhet të lehtësohet sistematikisht pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese dhe duhet të përmirësohen konsultimet në nivel lokal dhe në zonat rurale. Një konsultim më i madh me OSHC-të që avokojnë për të drejtat e grave do të ishte i dobishëm.

Rregullorja për **financimin publik** të OSHC-ve është duke u zbatuar, por mungojnë raportet gjithëpërfshirëse, të sakta dhe në kohë për financimin publik, si dhe vlerësimi i efektivitetit të fondeve të ndarë.

## 2.1.2 Reforma e administratës publike

### Korniza strategjike për reformën e administratës publike (RAP)

**Korniza strategjike për administratën publike** ekziston, por nuk zbatohet në mënyrë efikase. Strategjia mbetet e pakoordinuar mirë me strategjitë e tjera relevante për agjendën e RAP-it, siç është Programi për Parandalimin dhe Reduktimin e Barrës Administrative dhe strategjinë e qeverisjes elektronike. Struktura përkatëse e qeverisjes në RAP, siç është Këshilli Ministror, duhet të sigurojë koordinim efektiv ndërmjet niveleve politike dhe teknike nëpër organet kyçe. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të rrisë kapacitetet e saj për të menaxhuar dhe monitoruar reformat ndërsektoriale dhe të ndjeshme politikisht. Platforma e monitorimit RAP është funksionale. Megjithatë, ka vonesa në ngarkimin e të dhënave të besueshme dhe cilësore. Raporti i monitorimit vjetor për RAP për vitin 2023 është miratuar në qershor 2024. Qëndrueshmëria financiare e planit të veprimit për administratën publike mbetet e pasigurt.

### Zhvillimi dhe koordinimi i politikave

Në **sistemin e politikë-bërjes**, autoritetet e Kosovës duhet të zhvillojnë një **planifikim të politikave** afatmesme dhe vjetore të harmonizuara dhe të besueshme që integron në mënyrë efektive proceset e planifikimit të politikave dhe buxhetit. Në maj 2024, Qeveria ka miratuar rregulla të reja për procedurat e Qeverisë, që qartësojnë dhe përforcojnë aspekte të ndryshme të zhvillimit dhe koordinimit të politikave. Megjithatë, duhet të zhvillohen ende manuale të ndryshme udhëzuese që sistemi i politikë-bërjes të bëhet më efektiv. Proceset vjetore dhe afatmesme të politikave dhe buxhetimit mbesin jo të integruara mirë dhe koordinimi ndërinstucional mbetet sfidë. Prandaj, duhet të sigurohet harmonizimi i rregullave të reja të procedurës së Qeverisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i ligjit të ri për menaxhimin e financave publike. Janë përmirësuar kapacitetet e Zyrës për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit për të kryer planifikim, monitorim, raportim dhe vlerësime *ex-ante* të ndikimit. Megjithatë, duhet të forcohet koordinimi ndërmjet Zyrës së Planifikimit Strategjik dhe Ministrisë së Financave. Monitorimi dhe raportimi mbi strategjitë sektoriale si dhe korniza afatmesme e shpenzimeve mbesin të ndërlidhura dobët në administratë dhe planifikimi i kostos është joreal. Duhet të përmirësohet zbatimi brenda afateve kohore i zotimeve në PKIE. Nuk ka pasur progres në përfshirjen e konsideratave gjinore në të gjitha politikat, apo në zhvillimin e politikave dhe legjislativë gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në fakte.

Përdorimi efektiv i vlerësimeve të ndikimit rregullator (VNRr) dhe konsultimeve publike si mjete të **krijimit të politikave të bazuara në dëshmi** mbetet një sfidë. Kërkesat minimale ligjore për organizimin e procesit të konsultimit publik me shoqërinë civile ose komentet e rregullta nuk janë përmbushur në praktikë.

### Menaxhimi i financave publike

**Menaxhimi i financave publike (MFP)** është gjerësisht funksional, por duhet të përmirësohet më tej. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka miratuar raportin monitorues për 2023 për zbatimin e Strategjisë për MFP. Rregullat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor të kërkuara nga qarkoret e buxhetit nuk janë përfshirë në legjisllacion dhe nuk janë të disponueshme për publikun. Në fushën e investimeve publike, hartimit dhe zbatimit të projekteve investuese, edhe më tej mungojnë studimet e qëndrueshme të fizibilitetit dhe vlerësimet e kostove dhe përfitimeve. Kosova edhe më tej

duhet të përmirësojë cilësinë e informatave për projektet më sistemin e programit të investimeve publike dhe ndërlihdjen e këtij sistemi me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës. Nivelet e larta të detyrimeve tatimore vazhdojnë të përbëjnë sfidë. Është arritur njëfarë progresi në përgatitjen e pasqyrave të rrezikut fiskal. Megjithatë, dispozitat për vlerësimin e rrezikut fiskal duhet të inkorporohen në ligjin e ri për MFP. Sa i përket prokurimit publik, kontrolli i menaxhimit të kontratave dhe zotimeve mbetet i dobët. Lidhur me **transparencën buxhetore**, broshurat informuese për buxhetet publike ose të përshtatshme për lexuesin dhe raportet e zbatimit të buxhetit publikohen sistematikisht. Raportet e buxhetit brenda vitit, të publikuara çdo muaj dhe çdo tre muaj, ofrojnë informata si për përdoruesit e buxhetit të nivelit të parë agregat ashtu edhe për individët (*shihni kapitujt mbi prokurimin publik, tatimet, doganat dhe kontrollin financiar*).

#### Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

**Shërbimi publik dhe sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore** duhet përmirësuar. Ligji për zyrtarët publikë ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2023. Në mars 2024, qeveria ka propozuar ndryshime në Ligjin për Zyrtarët Publikë, për të adresuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese i cili ka konstatuar se disa nga nenet e tij janë jo-kushtetuese, dhe projektligji është në pritje të miratimit nga Kuvendi.

**Rekrutimi, ngritja në pozitë dhe shkarkimi i nëpunësve civilë sipas meritës** ka mbetur joefikas. Cilësia e menaxhimit në institucione ka vazhduar të cenohet nga vonesat në plotësimin efektiv të vendeve të lira të rregullta dhe një numër i madh i pozitave të larta drejtuese të plotësuara nga ushtrues detyre. Zbatimi i ngadalshëm i rregullores për klasifikimin e vendeve të punës dhe rishikimi i vonuar i organizimit të brendshëm të organeve publike është ende në pritje. Këto vonesa rrezikojnë të cenojnë transparencën e të dhënave për nevojat e burimeve njerëzore. Në këtë drejtim, ende duhet të hartohet një plan vjetor i besueshëm dhe realist i rekrutimit për shërbimin civil dhe një raport vjetor monitorues përkatës. Shërbimi civil ka tërhequr një numër të vogël kandidatësh të jashtëm, gjë që vihet re edhe në rritjen e numrit të rekrutimeve të pasuksesshme të menaxhmentit të lartë. Ligji i ri për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore përkatëse rrezikojnë të dëmtojnë **profesionalizimin dhe stabilitetin e shërbimit civil**. Ligji vendos kohë të kufizuar të shërbimit dhe mandate për menaxherët në të gjitha nivelet, duke dëmtuar stabilitetin në shërbimin civil, i cili nevojitet për të ndërtuar përvojën profesionale. Ligji nuk ofron perspektiva të qëndrueshme karriere pasi ngritjet në detyrë nuk janë të mundshme dhe konkurset për anëtarësim në poste drejtuese duhet të jenë të hapura në baza të barabarta për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm. Sistemi për menaxhim efektiv të performancës nuk është i siguruar, pasi ligji nuk specifikon qartë kriteret e bazuara në performancë për uljen ose zgjatjen e afateve. Procedurat e rekrutimit nuk sigurojnë një renditje të bazuar në kritere objektive. Ligji hesht për kualifikimet profesionale që kërkohen nga anëtarët e komisioneve të pranimit, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e cilësisë dhe pavarësisë së tyre. Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në administratën qendrore dhe numri i grave në pozita të larta janë të pakënaqshme.

Sistemi aktual i **shpërblimit** të zyrtarëve publikë është unifikuar sipas ligjit të ri për pagat. Megjithatë, vlerësimi i niveleve të pagave nuk është ende i bazuar në kërkesat e qarta të punës. Për shkak të lidhjeve të paqarta ndërmjet vlerësimit të punës dhe pagesës, efektet e saj më të gjera janë të paqarta. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për ligjin për pagat ende nuk është adresuar plotësisht. Në vend të kësaj, janë miratuar akte nënligjore për të qartësuar dhe ndryshuar disa nga koeficientët e futur, ndikimi fiskal i të cilëve ende nuk dihet.

**Kapaciteti** i Ministrisë së Punëve të Brendshme për sa i përket politikës së menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) mbetet i kufizuar. Nevojitet rritje e trajnimit, transferimit të njohurive dhe shpërndarjes së mjeteve metodologjike nëpër njësitë e MBNJ. Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore duhet të përditësohet për besueshmëri më të mirë të të dhënave. Ky sistem nuk është i lidhur me sistemin e listës së pagave.

**Zhvillimi profesional** i nëpunësve civilë nuk është efikas. Përkundër zhvillimit të planeve të personelit për trajnime, zhvillimi profesional është kryesisht i varur nga mbështetja e donatorëve dhe joefektiv për shkak të kapaciteteve të kufizuara buxhetore dhe të personelit të Institutit Kosovar të Administratës Publike (IKAP). Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC) ka kapacitete të pamjaftueshme për të menaxhuar, vendosur dhe raportuar për ankesat e nëpunësve civilë. Amendamentet e propozuara nga Qeveria në Ligjin për KPMSHC-në janë kualifikuar si jokushtetuese. Sapo këto ndryshime të jenë të pavlefshme, do të garantohet sërish mbikëqyrja efektive e shërbimit civil dhe ruajtja e së drejtës së të gjithë nëpunësve civilë për ankim. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i qershorit 2024 i konsideron këto ndryshime jokushtetuese dhe kërkon tërheqjen e tyre. **Integriteti** në shërbimin publik mbetet një sfidë (*shih Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore*).

#### Llogaridhënia e administratës

**Llogaridhënia e sektorit publik** është e pamjaftueshme. Qeveria ka filluar zbatimin e një qasjeje të re sektoriale për të racionalizuar agjencitë duke zhvilluar propozime për ngritjen, bashkimin dhe shpërbërjen e agjencive dhe plani i parë i veprimit që mbulon dy sektorë është miratuar në shtator 2024. Linjat e llogaridhënies ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe atyre vartëse mbesin të dobëta. Përkundër përmirësimeve në miratimin e një numri më të madh të planeve të performancës për agjencitë e varura se në vitin e kaluar, një sistem i menaxhimit të performancës sipas rregullave të reja të miratuara në vitin 2023 duhet të funksionalizohet në mënyrë efektive. Zbatimi efikas i Ligjit për **qasjen në dokumente publike** mbetet sfidë. Një ligj i ri për mosmarrëveshjet administrative është miratuar në janar 2024, me qëllimin për të përmirësuar kornizën e drejtësisë administrative dhe për të rritur nivelin e mbrojtjes së të drejtave të individëve. Korniza ligjore për **të drejtën për të kërkuar kompensim** nuk është koherent dhe zbatimi i tij nuk është efektiv.

#### Ofrimi i shërbimeve për publikun dhe bizneset

**Ofrimi i shërbimeve për publikun dhe bizneset** është duke u përmirësuar gradualisht, por akoma është joefikas. Është arritur njëfarë progresi në zbatimin e Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative (2022-2030), me progres të vazhdueshëm në shërbimet e thjeshtuara në nivel qendror dhe lokal. Zbatimi i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative akoma është i pamjaftueshëm. Është përmirësuar më tej ofrimi i shërbimeve për publikun në portalin qeveritar e-Kosova, pasi që është rritur numri i shërbimeve të disponueshme në katalogun elektronik. Ofrimi i shërbimeve për personat në gjendje të cenueshme, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, mbetet joefikas. Qeveria ka miratuar Strategjinë për e-Qeverisje, e cila mbulon transformimin digjital të administratës publike, në veçanti me fokus në ridizajnimin e ofrimit të shërbimeve, për t'i përafruar me nevojat e njerëzve.

## **2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE**

### **2.2.1 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore**

*Vlerat themeltare të BE-së përfshijnë sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Një sistem gjyqësor efektiv (i pavarur, me cilësi të lartë dhe efikas) dhe lufta efektive kundër korrupsionit janë të një rëndësie të jashtëzakonshme, siç është respektimi i të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë.*

#### **Funksionimi i gjyqësorit**

##### Dokumentet strategjike

Kosova ka një strategji për sundimin e ligjit për periudhën 2021-2026, por plani i veprimit për 2024-2026 është i vonuar. Zbatimi dhe monitorimi i dokumenteve strategjike ka nevojë për përmirësim. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka miratuar Strategjinë e Komunikimit për periudhën 2024-2027. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka miratuar Planin Strategjik të TI-së për periudhën 2024-2029 për zbatimin e mjeteve të drejtësisë digjitale të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). Zbatimi i planeve strategjike të KGJK-së dhe KPK-së duhet të përmirësohet më tej, duke përfshirë ngritjen e mekanizmave më të fuqishëm të monitorimit. Zbatimi i Deklaratës së Përbashkët të Angazhimit, të nënshkruar nga krerët e institucioneve të sistemit të drejtësisë në mars të vitit 2023, hasi në pengesa dhe vonesa serioze. Procesi i hartimit të këtyre ligjeve kyçe të reformës nuk ka siguruar konsultim kuptimplotë me akterët përkatës kombëtarë e ndërkombëtarë. Përkundër këshillave të forta të BE-së, Qeveria nuk e ka konsultuar Komisionin e Venedikut për pakon e reformave legjislativë. Kjo ka ndikuar negativisht në cilësinë dhe përafrimin e saj me standardet evropiane. Një legjislacion i tillë kyç kërkon vlerësim nga Komisioni i Venedikut. Veçanërisht projektligji i propozuar për vlerësimin e performancës, kontrollin e integritetit dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk ka qartësi dhe ka edhe më tej shqetësime se fushëveprimi i tij nuk është në përputhje me standardet evropiane.


### Organet drejtuese

Funksionimi i KGJK-së dhe KPK-së është adekuat, por përbërja e tyre e plotë duhet të sigurohet vazhdimisht. KPK dhe KGJK emëruan zëvendëskryetarët e rinj, të dyja femra. Planifikimi i aktiviteteve dhe përdorimi i duhur i burimeve duhet të përmirësohet. Praktikrat e përgjithshme të menaxhimit duhet të përmirësohen, veçanërisht brenda KPK-së, duke përmirësuar vendimmarrjen dhe komunikimin dhe duke rritur konsistencën.

KGJK ka rritur transparencën dhe ka përmirësuar komunikimin me publikun. Kuvendi më në fund zgjodhi tre anëtarët porotë të KPK-së. Në korrik të vitit 2024, Kuvendi ka miratuar një ligj të ri për KPK-në, me qëllim uljen e korporatizmit brenda KPK-së. Nuk është arritur të sigurohet që ky ligj të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe autoritetet nuk kanë arritur të konsultohen me Komisionin e Venedikut për draftin e fundit, përkundër këshillave të përsëritura nga BE. KPK duhet të përsërisë shpejt procesin për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, duke respektuar parimet e transparencës dhe meritës.

### Pavarësia dhe paanshmëria

Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit dhe prokurorisë garantojnë nga Kushtetuta dhe ligji, por zbatimi i tyre kërkon përmirësim. Zyrtarët qeveritarë prirën të kritikojnë vendimet në raste individuale apo edhe të shënjestrojnë gjyqtarë apo prokurorë të veçantë, gjë që është shqetësuese. Nevojitet një trajnim i mëtejshëm për gjyqtarët që t'i kryejnë gjykimet në mënyrë profesionale dhe të paanshme. Gjykata Kushtetuese nxori një vendim për Ligjin për pagat e zyrtarëve publikë, duke ngritur çështje për pavarësinë e gjyqësorit dhe organeve të pavarura kushtetuese; Kuvendi ende nuk e ka adresuar këtë vendim. Një numër i vogël kërkesash për mbrojtje të afërt janë paraqitur në polici.



Nevojitet një trajnim i mëtejshëm për gjyqtarët që t'i kryejnë gjykimet në mënyrë profesionale dhe të paanshme. Gjykata Kushtetuese nxori një vendim për Ligjin për pagat e zyrtarëve publikë, duke ngritur çështje për pavarësinë e gjyqësorit dhe organeve të pavarura kushtetuese; Kuvendi ende nuk e ka adresuar këtë vendim. Një numër i vogël kërkesash për mbrojtje të afërt janë paraqitur në polici.


**Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL)** i vendosur mundëson ndarjen e rastësishme të rasteve gjyqtarëve dhe prokurorëve, me përjashtime të kufizuara të

përcaktuara në rregulloret përkatëse.

Ndonëse Ligji për Sistemin Kombëtar Qendror të Evidencës Penale i ofron qasje të plotë Ministrisë së Drejtësisë, duhet të sigurohet përdorimi i duhur i tij në praktikë duke respektuar ndarjen e pushteteve. Duhet të vazhdojë puna për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë.


### Llogaridhënia

Llogaridhënia e gjyqësorit duhet të përmirësohet. Janë vendosur kodet e etikës për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët. KGJK-ja dhe KPK-ja kanë krijuar komisione të etikës që shërbejnë si organe këshillëdhënëse. KGJK dhe KPK kanë sisteme funksionale për procedurat disiplinore, por efikasiteti dhe cilësia e tyre duhet të përmirësohet, duke përfshirë edhe rishikimin e kornizës legjislative. Ndryshimet aktuale legjislative duhet të përputhen me standardet evropiane, veçanërisht në lidhje me kompetencat për të vendosur për fillimin ose refuzimin e procedurave disiplinore. Gjyqtarët dhe prokurorët deklarojnë pasurinë e tyre çdo vit. Përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme, veçanërisht për të siguruar verifikimin e rregullt dhe efektiv të plotë të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të forcuar kornizën legjislative dhe për të ofruar programe trajnimi mbi etikën gjyqësore.



Prezantimi i një procesi të jashtëzakonshëm të kontrollit të integritetit për zyrtarët e lartë në gjyqësor dhe prokurori është në pritje të miratimit nga Kuvendi, pasi propozimi nuk arriti të mbledhë shumicën e kërkuar për ndryshimet kushtetuese.

### Cilësia e drejtësisë



Cilësia e drejtësisë është përmirësuar, por mbetet e pamjaftueshme. Rekrutimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj ka potencial për të rritur nivelin e profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, cilësia e aktakuzave dhe aktgjyqimeve penale mbesin të pamjaftueshme. Krijimi i Gjykatës së specializuar Komerciale ka vazhduar të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së rasteve të gjykuar,

duke reduktuar numrin e referimeve dhe kohën e mbajtjes së rasteve (kohën e nevojshme për sistemin gjyqësor për të zgjidhur një rast). Duhet të forcohet bashkëpunimi ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit për të garantuar trajtimin efikas të rasteve, në veçanti rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjykata Supreme luan një rol kyç në arritjen e uniformitetit të praktikës gjyqësore; kjo mund të përmirësohet përmes publikimit të vazhdueshëm dhe me kohë të aktgjyqimeve nga KGJK.

Përkundër trendit në rritje, buxheti i gjyqësorit mbetet i pamjaftueshëm. Performanca e dobët e

avokatëve mbrojtës duhet të adresohet nga Odën e Avokatëve dhe nga KGJK, duke përfshirë zbatimin më të mirë të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykatat luftojnë për të përmbushur kërkesat e Ligjit për Gjuhët për të publikuar aktgjykimet në të dyja gjuhët zyrtare për shkak të mungesës së përkthyesve serbë. Disponueshmëria dhe cilësia e interpretimit në procedurat gjyqësore mbetet një sfidë.

Statusi dhe funksionimi i Akademisë së Drejtësisë së Kosovës në përgjithësi janë në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, amendamentet në Ligjin për Akademinë janë aktualisht në pritje dhe duhet të sigurohet përafrimi i plotë me standardet evropiane. Akademia vuan nga burimet e pamjaftueshme. KGJK dhe KPK kanë vazhduar të organizojnë rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në kritere meritore. Rekrutimi nga komunitetet joshumicë mbetet sfidë, dhe ka shumë pak aplikime.


Sistemi i vlerësimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët duhet të përmirësohet më tej për të siguruar një proces të bazuar në kritere objektive – me peshën e duhur treguesve cilësorë – dhe ndjekje efektive.

### Efikasiteti



Efikasiteti i drejtësisë duhet të përmirësohet. Ndërkohë që ka pasur progres në shkallën e zgjidhjes së lëndëve civile, aftësia e gjyqësorit dhe e prokurorisë për të trajtuar rastet në kohën e duhur mbetet e kufizuar, veçanërisht në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Gjykimet vazhdojnë të vonohen nga shtyrjet e shpeshta të seancave, shpesh për arsye të pajustificuara dhe menaxhim joefikas të lëndëve. Ndonëse KGJK dhe Gjykata Supreme kanë vënë në funksion një mekanizëm për të minimizuar numrin e rigjykimeve, kjo praktikë ka vazhduar dhe numri i rigjykimeve madje është rritur. Kjo rri numrin e lëndëve të pazgjidhura dhe shpesh çon në zgjatje të paraburgimit. Trupat gjykues duhet të përdorin më mirë mjetet për të ndëshkuar palët për mungesë të paarsyeshme në seanca. Miratimi i shpejtë i Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile është thelbësor për të përmirësuar efikasitetin e drejtësisë civile. Kuvendi ka miratuar Ligjin e ri për Mosmarrëveshjet Administrative, me qëllim përmirësimin e kornizës së drejtësisë administrative dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Ligji për gjykatën administrative, i cili është në pritje të miratimit, gjithashtu ka potencial për të reduktuar ngarkesën e mbetur. Kjo duhet të vlerësohet nga Komisioni i Venedikut.

Dorëheqja e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb të Kosovës në veri të Kosovës, në nëntor 2022, ka vazhduar të shkaktojë vonesa, përkundër rrimërimeve dhe transferimit të rasteve. Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës mbetet i pamjaftueshëm.

Janë bërë përmirësime të dukshme në qëndrueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave që futen në SMIL. Sistemi kombëtar i centralizuar i të dhënave penale është funksional. Megjithatë, të dy sistemet ende nuk janë bërë plotësisht të ndërveprueshme.







### Trajtimi në familje i rasteve të krimeve të luftës dhe personave të zhdukur



Korniza ligjore për trajtimin e krimeve të luftës është i kënaqshëm, por zbatimi i saj pengohet nga kapacitetet e kufizuara të shërbimit prokurorial. Prokuroria Speciale (PSRK) ka ngritur disa aktakuza për krime luftime në *mungesë*. Kosova gjithashtu ka arritur progres në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të dhunës seksuale. Strategjia e re për krimet e luftës është në pritje të miratimit. Numri i prokurorëve të caktuar në departamentin e krimeve të luftës të PS-së është rritur, por departamenti ende lufton për të procesuar lëndët e grumbulluara të shumta. Procesi i krimeve të luftës mbetet i penguar nga mungesa e ndihmës së ndërsjellë juridike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Fati i pazbardhur i **personave të pagjetur** mbetet sfidë. Janë ende 1 612 persona të zhdukur. Gjatë periudhës nga qershori 2023 deri në qershor 2024 janë zgjidhur vetëm dhjetë raste. Në qershor është miratuar Strategjia për Drejtësi Tranzicionale. Miratimi i saj është hap pozitiv. Megjithatë, kjo strategji nuk arrin të jetë plotësisht gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë aspekte të rëndësishme të pajtimit. Kosova duhet t'i adresojë këto mangësi në rishikimin e ardhshëm të Planit të Veprimit. Është funksionalizuar Instituti i ri për Krimet e kryera gjatë Luftës në Kosovë. Shoqëria civile mbetet e angazhuar në mënyrë aktive në iniciativat e kërkimit të së vërtetës, pajtimit dhe përkujtimit.

### **Lufta kundër korrupsionit**

#### Rezultatet e arritura

Ka përmirësime në rezultatet e luftimit të korrupsionit, veçanërisht lidhur me numrin e vendimeve të formës së prerë dhe dënimeve përfundimtare, përfshirë rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.



Konfiskimi i pasurive të fituara me vepër penale është rritur si vlerë totale, por nevojitet më shumë progres sistematik (*shihni kapitullin 24, pjesën mbi konfiskimin dhe rikuperimin e pasurive*).

Në vitin 2023, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) ka trajtuar 66 raste nën hetim paraprak për dyshime për vepra të lidhura me korrupsionin, nga të cilat 59 janë referuar në prokurori dhe 7 raste janë pushuar. 4 698 nga 4 709 zyrtarë (99.8%) kanë dorëzuar deklarata të rregullta vjetore të pasurisë. APK ka trajtuar 216 raste të dyshimit për konflikt të interesit.

### Korniza institucionale

Korniza institucionale për luftën kundër korrupsionit ekziston dhe është pjesërisht e kënaqshme. Zbatimi dhe monitorimi i kornizës duhet të përmirësohet tutje. APK ka zbatuar një projekt të rëndësishëm për të identifikuar fushat më të cenueshme ndaj korrupsionit. Është thelbësore të forcohet buxheti, personeli dhe kapacitetet e ekspertiza e APK-së për të reflektuar rritjen e numrit të subjekteve që janë të obliguar të deklarojnë pasurinë. Kuvendi akoma nuk ka miratuar raportin vjetor të APK për 2023.

Institucionet e specializuara të Kosovës për luftimin e korrupsionit janë funksionale. Njësia e Veçantë Hetimore e Policisë së Kosovës më herët ka funksionuar pa mandat të qartë ligjor. Ligji i ri për Prokurorinë Speciale (PSRK) e plotëson këtë mangësi. Megjithatë, nevojitet një akt nënligjor për të përcaktuar aspektet organizative dhe bashkëpunim me PSRK-në. Si PSRK ashtu edhe Njësia e Veçantë Hetimore duhet të sigurojnë bashkëpunim efektiv dhe të mbajnë kapacitete të mjaftueshme hetimore për të përmbushur funksionet e tyre në mënyrë efektive.

### Dokumentet strategjike

Korniza e nevojshme strategjike nuk ekziston. Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2024-2027 janë në pritje. Është thelbësore që ato të përmbushin praktikat dhe standardet më të mira të BE-së. KPK, KGJK dhe PS duhet të vazhdojnë të kenë prioritet trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar në planet e tyre vjetore.

### Korniza ligjore

Korniza ligjore për luftën kundër korrupsionit ekziston dhe është e kënaqshme, megjithatë duhet të përmirësohet zbatimi i saj. Kosova nuk është palë e konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit. Megjithatë, legjislati i Kosovës në përgjithësi është i harmonizuar me këto instrumente dhe në përputhje me standardet relevante evropiane. Kodi Penal penalizon në mënyrë të përshtatshme veprat e lidhura me korrupsionin.

Në nëntor 2023, Kuvendi ka miratuar Ligjin për PSRK-në, i cili qartëson juridiksionin e saj duke përcaktuar më qartë se çfarë përbën korrupsion të nivelit të lartë.

### **Të drejtat themelore**



## Korniza e përgjithshme

Korniza e përgjithshme për të drejtat themelore është përgjithësisht e kënaqshme. Legjislacioni është në fuqi, por mbetin sfidat kryesore me zbatimin efektiv të tij.


## Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Kosova akoma nuk është anëtare e një numri organizatash ndërkombëtare, por Kushtetuta përfshin instrumentet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Pritet inkorporimi i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës është në pritje të një vendimi nga Komiteti i Ministrave.

## Promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut

Amendamentet e hartuara në Ligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror synojnë të përmirësojnë më tej kornizën legjislative e cila është kryesisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Ligji për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit është në fuqi dhe zbatohet mirë. Aktualisht, korniza legjislative dhe zbatimi i saj është në një nivel që plotëson kërkesat minimale të BE-së për kontrollin kufitar. Strategjia dhe plani i veprimit për menaxhimin e integruar të kufirit janë përditësuar dhe janë në pritje të miratimit. Kosova ka nënshkruar draftin e marrëveshjes së përditësuar të punës me Frontex në pranverën e vitit 2023. Ai ende nuk është ratifikuar nga Frontex.

#### Zbatimi dhe kapacitetet për zbatim

Policia e Kosovës është në gjendje të përmbushë detyrat e saj të sigurisë kufitare kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Task forca ndërinstitucionale e krijuar nga institucionet e integruara të menaxhimit të kufirit për të luftuar krimin ndërkufitar ka përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional. Përditësimi i bazës së të dhënave të sistemit të menaxhimit të kufirit është në vazhdim e sipër. Ka nevojë për forcimin e infrastrukturës kufitare të Kosovës dhe të madhësisë dhe cilësisë së pajisjeve të përdorura. Kosova duhet të përmirësojë procedurën e planifikimit shumëvjeçar, përfshirë menaxhimin e ciklit jetësor, mirëmbajtjen dhe planifikimin e përgjithshëm të sistemit të sigurisë kufitare.

Bashkëpunimi i Kosovës me agjencitë e BE-së është efektiv. Frontex dërgon ekspertë në pikat e kalimit kufitar. Përveç pikës kombëtare të kontaktit, tre koordinatore lokalë janë të punësuar në pikat më të mëdha të kalimit kufitar të Kosovës për të lehtësuar bashkëpunimin me Frontex. Autoritetet marrin pjesë në zbatimin e planifikimit të emergjencës në përputhje me Rregulloren e Frontex. Kosova merr pjesë në rrjetin e analizës së rrezikut të Ballkanit Perëndimor dhe në iniciativat e tjera rajonale. Bashkëpunimi me të gjithë fqinjët është i mirë, përveç Serbisë. Policia kufitare ka caktuar pika kontaktuese për bashkëpunim ndërkombëtar. Marrëveshjet e përbashkëta të patrullimit me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi janë në fuqi dhe aktivitetet e përbashkëta zhvillohen rregullisht. Pikat e Përbashkëta të Përkohshme të Kalimit Kufitar (PPK) ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të jenë funksionale. Vetëm dy nga gjashtë PPK-të e përhershme janë themeluar (Merdare dhe Mutivodë).

### **Falsifikimi i euros (aspektet e së drejtës penale)**

Kosova ka autoritete dhe procedura kompetente për t'u marrë me paratë e falsifikuara. Në aktivitetet e Perikliut ka marrë pjesë edhe Kosova. Kodi Penal duhet të përafrohet më tej me Direktivën e BE-së për mbrojtjen e euros dhe valutave të tjera nga falsifikimi.



## 2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA

### 2.3.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

#### Qeverisja ekonomike

**Në përgjithësi, politikat ekonomike të Kosovës mbetën të matura.** Në vitin 2023 ka vazhduar konsolidimi fiskal, përkundër transfereve të njëhershme për përfituesit e pensioneve bazë dhe të shtesave të fëmijëve<sup>5</sup>, duke arritur në gjithsej rreth 0.7% të BPV-së, dhe ka rritur ndjeshëm shpenzimet kapitale publike. Qeveria ka marrë një vendim të matur në aspektin fiskal duke miratuar, në korrik 2023, ligjin që shkëput pensionet e veteranëve të luftës nga paga minimale. Ligji hyri në fuqi në gusht 2024, pas shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Fatura e pagave publike nuk e ka tejkaluar kufirin ligjor për vitin në tërësi. Zbatimi i Marrëveshjes për Hua (SBA) me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka avancuar mirë, dhe gjithashtu janë bërë përparime në zbatimin e agjendës së gjelbër të Kosovës, të mbështetur nga Instrumenti i FMN-së për dhe Ripërtëritje dhe Qëndrueshmëri.


*\*Euro përdoret si valutë de facto e vendit*

*Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Botërore dhe FMN*

**Udhëzimet e politikave të përcaktuara në konkluzionet e Dialogut Ekonomik dhe Financiar të 16 majit 2023 janë zbatuar pjesërisht.** Masat për zbutjen e ndikimit të krizës energjetike në familjet dhe bizneset e cenueshme ishin kryesisht me objektiva të qartë. Të ardhurat nga tatimet janë rritur fuqishëm, pjesërisht për shkak të disa fitimeve nga formalizimi. Megjithatë, baza tatimore vazhdon të dobësohet nga përjashtime të shumta tatimore, norma tatimore preferenciale dhe regjime të veçanta, ndërsa shpenzimet publike rëndohen nga transferet specifike të bazuara në kategori, duke lënë pak hapësirë për përfitime të vlerësuara sipas kriterëve dhe politikave të punësimit. Mbikëqyrja financiare e ndërmarrjeve publike (NP-ve) është përmirësuar, por puna për krijimin e një organi të mbikëqyrjes fiskale nuk ka ecur përpara. Për periudhën 2024-2026, Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës (PRE) synon t'i mbajë financat publike të qëndrueshme dhe të jetë në përputhje me rregullat fiskale, duke mbështetur rritjen ekonomike kryesisht përmes shpenzimeve më të larta kapitale.

#### Stabiliteti makroekonomik

**Rritja ekonomike e Kosovës në vitin 2023 pati rritje ekonomike mesatare, kryesisht për shkak të dobësimit të kërkesës së jashtme.** Rritja reale e BPV-së është zbutur, duke arritur në 3.3%,




nivel ku megjithatë optimist (një rënie nga 4.3% në vitin 2022), pak mbi normën mesatare prej 3.2% të rritjes së BPV-së në 2015-2020. Faktori kryesor i ngadalësimit ekonomik është kontributi negativ i eksporteve neto në rritje, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të dukshëm të rritjes reale të eksportit. Rritja ekonomike është nxitur nga rritja e konsumit të familjeve si rezultat i rritjes së pagave reale, nivelit më të lartë të kreditimit nga bankat si dhe rritjes së lehtë të remitencave si proporcion i BPV-së. Mbështetje shtesë ka ardhur nga rikuperimi i formimit të kapitalit fiks bruto,

duke reflektuar një rritje të fortë të investimeve publike, si dhe nga përshpejtimi i rritjes së konsumit publik, kryesisht për shkak të pagave më të larta në sektorin publik. Aktiviteti ekonomik është rritur ndjeshëm në tremujorin e parë të vitin 2024, dhe rritja reale e BPV-së është përshpejtuar në 5.6% nga viti në vit, nga 4% në tremujorin e mëparshëm. BPV për kokë banori e Kosovës mbetet më e

<sup>5</sup> Në korrik 2024, qeveria vendosi të ndajë një shumë shtesë prej 50 milionë eurosh, duke arritur në një total prej 100 milionë euro në vit për shtesat e fëmijëve.

ulëta në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke mbetur në 25% të mesatares së BE-së në vitin 2023, vetëm pak më e lartë se mesatarja prej 22% në 2015-2020.

**Në vitin 2023, Kosova ka dëshmuar përmirësim të dukshëm në pozicionin e saj të jashtëm.** Deficiti i llogarisë rrjedhëse ra në 7.6% të BPV-së, nga 10.3% në vitin 2022. Drejtuesit kryesorë ishin ulja e deficitit tregtar të mallrave falë një bilanci më të mirë energjetik, i kombinuar me rikthimin e vazhdueshëm të eksporteve të shërbimeve. Kjo ka rezultuar në uljen e deficitit të përgjithshëm tregtar në një ende shumë të konsiderueshme 30.8% të BPV-së nga 32.8% një vit më parë. Remitencat janë rritur lehtësisht në gati 14% të BPV-së në vitin 2023, ndërsa suficiti i të ardhurave parësore është rritur në 1.9% të BPV-së. Eksportet dhe remitencat e mëtejshme të shërbimeve jozyrtare janë reflektuar nga gabime e lëshime të mëdha në bilancin e pagesave (ekuivalente me 2.9% të BPV-së) në vitin 2023. Në tremujorin e parë të vitit 2024, deficiti i



llogarisë rrjedhëse është përqësuar, duke arritur zgjerim total prej 4 tremujorësh në 8.5% të BPV-së. Në vitin 2023, deficiti i llogarisë rrjedhëse është financuar kryesisht nga flukset hyrëse neto të investimeve të huaja direkte (IHD), të cilat janë rritur për 0.5 pikë përqindjeje (pp) në 6.8% të BPV-së, dhe pjesa më e madhe janë drejtuar në pasuri të paluajtshme, si dhe aktivitete financiare dhe të sigurimit. Në të njëjtën periudhë, pasuritë rezervë zyrtare arritën në 2 muaj të importeve të mallrave dhe shërbimeve.


**Në vitin 2023, inflacioni ka rënë ndjeshëm, pasi kishte arritur kulmin në vitin 2022.** Inflacioni i çmimeve të konsumit është ngadalësuar ndjeshëm në 4.9% mesatarisht në vitin 2023, dukshëm më i ulët se norma prej 11.6% e regjistruar në vitin 2022 dhe ka rënë më tej në 2.1% nga viti në vit në tetë muajt e parë të vitit 2024. Forca kryesore disinflacioniste ishin çmimet më të ulëta globale të mallrave. Gjatë vitit 2023 Qeveria ka vazhduar të mbështesë familjet dhe firmat në nevojë duke subvencionuar faturat e energjisë elektrike për të lehtësuar ndikimin e rritjes së tarifave. Ajo gjithashtu ka subvencionuar faturat mujore të energjisë elektrike për rreth 200,000 familje që kanë konsumuar më pak energji krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Konsolidimi fiskal ka vazhduar në vitin 2023 me reduktim të mëtejshëm në deficitin kryesor si rezultat i rritjes së lartë të të ardhurave dhe përkundër rritjes së shpenzimeve publike kapitale.** Deficiti total buxhetor ka rënë në 0.2% të BPV-së në vitin 2023, rënie nga 0.5% në vitin 2022, që korrespondon me suficit prej 0.5% të BPV-së sipas përkufizimit të rregullit fiskal<sup>6</sup>. Rënia e deficitit të Qeverisë ka rezultuar kryesisht nga rritja e fortë e të ardhurave (14.5% nga viti në vit), pjesërisht për shkak të përmirësimit të pajtueshmërisë tatimore. Shpenzimet publike janë rritur për 13.3% nga viti në vit. Rritja më e madhe (32%) ka ndodhur në shpenzimet kapitale, edhe pse ka arritur vetëm rreth 68% të buxhetit të ndarë, duke reflektuar objektiva tepër optimiste dhe dobësi të mbetura në kapacitetet zbatuese. Përafërsisht në përputhje me planin buxhetor, shpenzimet rrjedhëse janë rritur për 9.3% nga viti në vit, kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve për mallra dhe shërbime (18%) dhe paga (17.5%). Kjo rritje e shpenzimeve për paga ka ardhur si pasojë e Ligjit të ri për pagat në sektorin publik, i cili ka filluar të zbatohet që nga shkurti i vitit 2023. Transferrat dhe subvencionet janë rritur për vetëm 1.3% nga viti në vit, duke reflektuar tërheqjen graduale të mbështetjes lidhur me

<sup>6</sup> Rregulli fiskal vendos një kufi mbi deficitin fiskal prej 2% të BPV-së së parashikuar, duke përjashtuar projektet kapitale të financuara nga të ardhurat e privatizimit dhe donatorët ('klauzola e investimeve'). Ky përjashtim për investimet e financuara nga donatorët mund të përdoret deri në vitin 2026, me kusht që shkalla e borxhit publik të mbetet nën 30% të BPV-së. Një rregull tjetër parasheh se rritja në llogaritë e pagave publike nuk mund të tejkalojë rritjen nominale të BPV-së. Depozitat qeveritare të përdorura si rezerva fiskale janë të detyruara ligjërisht të qëndrojnë në 4.5% të BPV-së për sa kohë që qeveria përdor të ardhurat e privatizimit. Rregulla e borxhit kërkon që borxhi publik dhe i garantuar publikisht nuk mund të tejkalojë 40% të BPV-së.

krizën energjetike. Depozitat e Qeverisë kanë rënë në 2.4% të BPV-së, nga 3.2% në vitin 2022.

**Si rezultat i përmirësimit të performancës së qëndrueshme fiskale dhe rritjes së lartë nominale të BPV-së në vitin 2023, raporti i borxhit publik ndaj BPV-së ra, por baza e investitorëve vendor për borxhin qeveritar mbetet e ngushtë.** Raporti i borxhit publik ra në 17.5% të BPV-së në fund të



vitet 2023 nga 20% e rishikuar një vit më parë dhe më tej në 15.8% të BPV-së në qershor 2024. Këto shifra nuk përfshijnë detyrimin e shtetit për tërheqjet e patatueshme të ndërlidhura me COVID-19 të 10% të kursimeve pensionale nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), të cilat Qeveria ka premtuar se do t'i riimbursonte në vitin 2023<sup>77</sup>. Në vitin 2023, borxhi i brendshëm, i cili mbahet nga një bazë e ngushtë të investimeve, ka rënë ndjeshëm, për gati 13% nga viti në vit, pjesërisht për shkak të mungesës së një Bordi operativ në TKPK në gjysmën e parë

të vitit. Në qershor 2024, pjesa e borxhit të brendshëm të mbajtur nga TKPK mbeti në nivel prej 48%, ndërsa Banka Qendrore e Kosovës dhe bankat komerciale kanë pasur 21%, përkatësisht 22%. Borxhi i jashtëm, që i detyrohet kryesisht donatorëve ndërkombëtarë, është rritur me rreth 8% në vitin 2023. Këtu përfshihen huatë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Investime. Në prill 2024, Kosova mori për herë të parë një vlerësim sovran të kredisë, 'BB', me një perspektivë të qëndrueshme, nga Fitch Ratings. Kjo mund të ndihmojë Kosovën të bëhet pjesë e tregjeve ndërkombëtare të bonove në të ardhmen e afërt.

**Ka pasur njëfarë progresi në adresimin e rreziqeve fiskale dhe përmirësimin e transparencës.** Nismat e Qeverisë për të përmirësuar zbatimin e projektit rezultuan në një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve kapitale publike në vitin 2023. Megjithatë, nën-ekzekutimi i përsëritur i buxhetit kapital tregon për kapacitet ende të dobët planifikimi dhe zbatimin.

Tejkalimi i shpenzimeve për pensionet e veteranëve të luftës nuk është zgjidhur për shkak të mungesës së riklasifikimit të përfituesve. Buxheti i vitit 2024 përfshin alokime totale dukshëm më të ulëta krahasuar me atë të një viti më parë, duke përmirësuar transparencën fiskale. Një analizë e pavarur e rrezikut fiskal të NP-ve, e kufizuar në NP me rrezik të lartë, është publikuar në nëntor 2023. Në dhjetor 2023, kompania e shpërndarjes së energjisë KEDS dhe kompania Elektroserver kanë nënshkruar kontratë komerciale. Ky ishte moment historik i madh në zbatimin e Udhërrëfyesit për Energjinë të rënë dakord në qershor 2022 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE. Lidhja e kësaj kontrate ka mundur fillimin e furnizimit dhe faturimit në katër komuna në veri të Kosovës, duke ulur kështu rreziqet fiskale.

**Tri vjet konsolidim të konsiderueshëm fiskal krijuan hapësirë për një impuls të fortë fiskal të planifikuar në vitin 2024.** Buxheti i vitit 2024 pret që deficiti total të rritet në 2.7% të BPV-së, duke nënkuptuar një stimul të fortë fiskal kryesisht nëpërmjet një rritjeje shumë ambicioze të investimeve publike. Megjithatë, deficiti (sipas përkufizimit të rregullave fiskale) nuk do të tejkalonte kufirin e përcaktuar prej 2% të BPV-së, i cili është i përshtatshëm duke pasur parasysh nevojën për të ruajtur besueshmërinë e grupit të rregullave fiskale të mirëfunksionimit të Kosovës.

## Funksionimi i tregjeve të produkteve

### *Mjedisi afarist*

**Është arritur njëfarë progresi në përmirësimin e mjedisit të biznesit.** Në nëntor 2023, Qeveria ka miratuar Ligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, i cili është në pritje të miratimit nga Kuvendi. Ky ligj përcakton detyrimet e personave fizikë dhe subjekteve që regjistrojnë informata të pronësisë

<sup>7</sup> FMN vlerëson se detyrimi ndaj Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në vitin 2020 ishte 1.8% e BPV-së.

së përfituesve në Regjistrin e Pronarëve Përfitues dhe përcakton gjobat për mosrespektimin e tij. Zhvillime pozitive pati edhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare. Deri në mars të vitit 2024 janë publikuar 2,126 aktgjykime të shkallës së parë dhe 3,027 vendime të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, e cila është funksionalizuar në gusht 2022. Në gusht 2024 ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Investime të Qëndrueshme, pas shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të qëndrueshme në Kosovë.

**Autoritetet kanë intensifikuar përpjekjet për të reduktuar sektorin joformal.** Në korrik 2023, Administrata Tatimore e Kosovës ka miratuar një plan të ri vjetor veprimi për zvogëlimin e ekonomisë joformale, me fokus në adresimin e pasaktësive në të ardhurat personale ose mosdeklarimin dhe mospagesën e tatimit mbi të ardhurat personale dhe identifikimin e tatimpaguesve me të ardhura të larta që nuk dorëzojnë deklarata të tatimit në të ardhurat personale ose dorëzojnë deklarata me gabime. Në dhjetor 2023, Kuvendi ka miratuar Ligjin për Administrimin e Procedurave Tatimore, i cili ka ndryshuar kërkesat ligjore në lidhje me një sërë çështjesh që ndikojnë në formalizimin e aktiviteteve ekonomike apo të punës së padeklaruar. Ai gjithashtu rregullon mbledhjen e informatave dhe ndarjen e tyre me palët e treta, si bankat komerciale dhe vendet partnere. Ndryshime të tjera përfshijnë një limit prej 300 eurosh për transaksionet në para. Sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit nga Transparency International, Kosova ka përmirësuar rezultatin e saj në vitin 2023, duke u renditur në vendin e 83-të, që është 1 pozitë më të lart se në vitin 2022.

*Ndikimi i shtetit në tregjet e produkteve*

**Kosova duhet të harmonizojë më tej kornizën e saj të politikës së ndihmës shtetërore me rregullat dhe parimet e BE-së.** Kornizës aktuale i mungon një qasje koherente për ndihmën shtetërore, si dhe një strategji gjithëpërfshirëse dhe vlerësimet e kostos dhe përfitimit për ndihmën dhe subvencionet e dhëna, ndërsa Kuvendi akoma nuk ka emëruar Komisionin për Ndihmë Shtetërore.

*Privatizimi dhe ristrukturimi*

**Kosova ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm për krijimin e fondit sovran.** Në mesin e dhjetorit 2023, Kuvendi ka miratuar Ligjin për Themelimin e Fondit Sovran, por ai është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese, pas kërkesës së dy partive opozitare.

Fondi pritet të marrë përsipër ndërmarrjet shoqërore<sup>8</sup> dhe asetet e menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si dhe disa ndërmarrje publike të menaxhuara nga Ministria e Ekonomisë pas përmirësimit të performancës së tyre financiare. Megjithatë, krijimi i fondit nuk do të jetë i mjaftueshëm për të adresuar çështjet e vjetra të performancës dhe menaxhimit të dobët financiar të NP-ve. Gjatë periudhës raportuese, është iniciuar një shqyrtim gjithëpërfshirës të aseteve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke identifikuar pronat e përshtatshme për fondin sovran.

Funksionimi i tregut financiar


**Sektori bankar ka mbetur elastik dhe ka vazhduar të zgjerohet me ritme të forta.** Rentabiliteti i sektorit bankar ka shënuar rënie pak, ku raporti mesatar i kthimit në kapital ra në 19.7% në vitin 2023, nga 20.6% në vitin 2022, dhe më tej në 19.3% në korrik 2024. Në fund të vitit 2023, raporti i kredive me probleme ishte në nivel historikisht të ulët prej 2%, ndërsa është rritur në 2.1% në fund të korrikut 2024. Megjithatë, cilësia e aseteve duhet të monitorohet nga afër në kontekst të normave më të larta të interesit dhe likuiditet më të shtrënguar. Raporti e kapitalit rregullator të bankave ndaj pasurive të ponderuara me rrezik është rritur në 15.8% në vitin 2023 dhe më tej në 15.9% në korrik 2024, duke tejkaluar lehtësisht minimumin rregullator prej 12%. Rritja reale e kredisë është përsheptuar në një mesatare prej 9.2% në vitin 2023, nga 5.8% në vitin 2022 dhe më tej në 10.6% nga viti në vit në gjysmën e parë të vitit 2024, ku kreditimi për individë është rritur me ritëm shumë

<sup>8</sup> Në aspektin e pronësisë, ndërmarrjet shoqërore konsideroheshin si pronë e përbashkët shoqërore në ish-Jugosllavi.

më të shpejtë se kreditimi për bizneset. Rritja e depozitave në terma realë ishte mesatarisht 9% në vitin 2023, krahasuar me një rënie prej rreth 1% në vitin 2022, përpara se të ngadalësohej në 6% nga viti në vit në gjysmën e parë të vitit 2024. Përkundër zgjerimit dhe diversifikimit të portofolit të Fondit Kosovar për Garantim të Kredive, mungesa e kredive lehtësisht të qasshme dhe të përballeshme mbetet pengesë për rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).

### Funksionimi i tregut të punës

**Përkundër disa përparimeve, tregu i punës vazhdon të vuajë nga pjesëmarrja shumë e ulët, papunësia e lartë dhe hendeqet e mëdha gjinore.** Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore



vazhdojnë të publikohen me vonesa të mëdha. Të dhënat më të fundit të disponueshme i referohen vitit 2023 në tërësi. Në përputhje me aktivitetin e gjallë ekonomik, shkalla e punësimit është rritur në 36.3%, nga gati 34% në vitin 2022. Në ndërkohë, shkalla e papunësisë ra në 10.9% nga 12.6%, dhe përkundër rritjes së shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në 40.7% nga 38.6% në të njëjtën periudhë. Hendeqet gjinore në punësim (normat janë 53.4% për meshkujt dhe 19.8% për femrat) është rritur. Në vitin 2023, përqindja e të rinjve (15-24 vjeç) jo në punësim,

arsim ose trajnim (NEET) është rritur pak, në 33.4%, nga 33% në vitin 2022, gjë që megjithatë është më e larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për të përmirësuar gjendjen, Qeveria ka nisur fazën e pilotimit të Skemës për Garantimin e Punësimit të të Rinjve në dy komuna, duke reformuar edhe shërbimet publike të punësimit. Rezultatet e dobëta të tregut të punës kontribuojnë në nivel vazhdimisht të lartë të emigrimit. Me përkrahje përmes një huaje dhe asistence teknike të Bankës Botërore, autoritetet njoftuan, në maj 2024, fillimin e një skeme pilot të asistencës sociale të testuar me mjete për të reformuar tërësisht sistemin dhe për ta bërë atë më të shënjestruar gjatë një periudhe pesëvjeçare.

### **2.3.2 Kapaciteti për të përbaluar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE**

#### Arsimi dhe inovacioni

**Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe përafrimi i tij me nevojat e tregut të punës mbetet një sfidë kryesore.** Për të adresuar pjesëmarrjen e pamjaftueshme në edukimin e hershëm të fëmijërisë, Kuvendi, në korrik 2023, ka miratuar Ligjin e parë të Kosovës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Cilësia dhe rëndësia e arsimit janë dëmtuar nga mungesa e materialeve cilësore mësimore në shkolla, mungesa e trajnimit fillestar dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional për mësime të mësimdhënësve dhe numri i pamjaftueshëm i inspektorëve për vlerësimin e mësimeve të mësimdhënësve. Kjo dëshmohet nga renditja e Kosovës në vendin e 81-të dhe të fundit në ciklin e vitit 2022 të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe papunësia ende e lartë në mesin e të diplomuarve në arsimin terciar. Në fund të marsit 2024, Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar rregulloren për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të personelit në institucionet publike arsimore dhe formuese të arsimit parauniversitar. Për të lehtësuar kalimin nga shkolla në tregun e punës, Kosova ka filluar zbatimin e qasjes së arsimit të dyfishtë në vitin shkollor 2023/2024.

**Performanca e Kosovës në kërkime shkencore dhe inovacion është duke mbetur prapa.** Në vitin 2024, buxheti i ndarë për kërkime shkencore dhe zhvillim arrin në 15 milionë euro (0.1% e BPV-së), shumë më poshtë se 0.7% e BPV-së që kërkohet me ligj. Ka pasur njëfarë progresi në zbatimin e programit Horizon Europe për kërkimin dhe inovacionin, me një total prej 35 projekt-propozimesh të dorëzuara në vitin 2023, dhe gjashtë prej tyre morën një financim total të BE-së prej rreth 0.7 milionë euro. Në korrik 2023, Qeveria ka miratuar Programin Kombëtar të Shkencës për periudhën

2023-2028, i cili është dokumenti kryesor strategjik për shkencën dhe kërkimet shkencore.

### Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

**Kosova ka bërë progres të kufizuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore.** Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur progres në autostradën Prishtinë – Merdare apo në 'Autostradën e Paqes'. Punimet rehabilituese për Linjën Hekurudhore 10 vazhduan me ritme të ngadalta. Tenderimi i sistemeve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit, i cili është me prioritet të madh, është ende i vonuar për shkak të mungesës së financimit. Sistemi i transportit ende përballet me një sërë sfidash sa i përket sigurisë, mirëmbajtjes jo të mjaftueshme dhe kapaciteteve të dobëta administrative të institucioneve rregullatore.

**Përkundër përpjekjeve të fundit për të diversifikuar furnizimin me energji, sektori i energjisë mbetet një pengesë kyçe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.** Mungesa e sigurisë energjetike, për shkak të mosbesueshmërisë së njësive të vjetra me linjit, sjell kosto të konsiderueshme për biznesin dhe përfaqëson një nga pengesat më të mëdha për tërheqjen e IHD me cilësi të lartë. Kërkesa dhe konsumi për energji vazhdojnë të rriten me shpejtësi dhe janë dyfishuar që nga viti 2000. Kosova gjithashtu vuan nga humbje të mëdha teknike dhe komerciale në rrjetet e shpërndarjes dhe transmisionit për shkak të infrastrukturës së dobët (më shumë se 20% në total). Në dhjetor 2023, Kuvendi ka miratuar Ligjin për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, i cili parasheh një proces konkurrues tenderimi për të mbështetur projektet e energjisë së ripërtëritshme, duke zëvendësuar sistemin e mëparshëm të tarifave stimuluese. Në mars 2024, Kosova ka përfunduar me sukses ankandin e parë solar.

**Transformimi digjital i ekonomisë po avancohet, por digjitalizimi i shërbimeve publike ende është në një fazë të hershme.** Sipas OBEZH-së<sup>9</sup> (2024), Kosova është lider në rajonin e Ballkanit Perëndimor me 98.6% të familjeve që kanë një formë të qasjes në internet në vitin 2023, duke tejkaluar mesataren e BE-së prej 93.08%. Megjithatë, përdorimi i brezit të gjerë fikse bie nën mesataren rajonale, për shkak të infrastrukturës me cilësi më të ulët, mungesës së rrjeteve në disa rajone, përballeshmërisë dhe kërkesës së ulët.

Duhet bërë më shumë për të trajnuar punëtorë të kualifikuar në sektorin me rritje të shpejtë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), ku kërkesa për punonjës tejkalon ofertën. Agjenda Digjitale 2030, e vendosur që nga qershori 2023, ofron një kuadër gjithëpërfshirës për transformimin digjital, duke përfshirë teknologjitë 5G dhe digjitalizimin e bizneseve dhe shërbimeve publike. Digjitalizimi i këtij të fundit është ende në një fazë të hershme pasi vetëm 10% e të gjitha shërbimeve publike ofrohen online dhe shumica e tyre janë informative (OBEZH, 2024).

### Struktura sektoriale dhe ajo e ndërmarrjeve

**Sektori i shërbimeve ka vazhduar të dominojë aktivitetin ekonomik në vitin 2023, duke siguruar 46% të vlerës së shtuar bruto (VSHB).** Struktura sektoriale e VSHB-së tregon një rritje graduale të peshës së tregtisë me shumicë dhe pakicë, në 14.2% në vitin 2023, nga më pak se 13% në 2019, ndërsa pesha e ndërtimit mbeti e pandryshuar në 8.2% krahasuar me 5 vite më parë. Këto kontribute reflektojnë pjesërisht investimet, të cilat, ndonëse janë të larta gjatë dekadës së fundit, nuk kanë mbështetur rritjen e bazës së prodhimit vendas apo të sektorit të tregtueshëm (OBEZH<sup>10</sup>, 2021). Pësia e bujqësisë në VSHB është rritur lehtësisht në 7.8% në vitin 2023, nga 7.2% në vitin 2019. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e aktiviteteve të pasurive të paluajtshme ka rënë për 1.1 pikë përqindjeje, në 5.9% krahasuar me vitin 2019, e pasuar nga tkurrja e kontributeve nga administrata publike dhe arsimi.

**NVM-të përbëjnë mbi 99% të bizneseve të regjistruara dhe kanë qasje të vështirë në financa.** NVM-të dhe bizneset e drejtuara nga familja përbëjnë 80.4% të punësimit në bizneset jofinanciare


<sup>9</sup> OBZHE (2024), *Perspektiva e Konkurrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor 2024*.

<sup>10</sup> OBZHE (2021), *Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore: Pikëpamja e politikave*.



dhe gjenerojnë 81% të vlerës totale të shtuar. Sipas OBEZH<sup>111</sup> (2022), Kosova ka bërë progres në zbatimin e Aktit të Biznesit të Vogël, me arritjet kryesore në shërbimet mbështetëse për NVM-të, ndërkombëtarizimin e NVM-ve, prokurimin publik dhe standardet dhe rregulloret teknike. Qasja në financa mbetet një pengesë për rritjen për shkak të kërkesave të rrepta të bankave për kredi, duke prekur kryesisht bizneset më të vogla. Për gati 8 vite, portofoli i Fondit Kosovar të Garancive Kreditore ka arritur një vlerë kumulative të kredive të miratuara prej rreth 664 milionë euro (7% e BPV-së), ndërsa vlera e garantuar nga fondi ka arritur në 348 milionë euro, të shpërndara në mbi 15 000 kredi.

### Integrimi ekonomik në BE-në dhe konkurrueshmëria e çmimeve



**BE mbetet partneri më i madh tregtar i Kosovës dhe eksportet e shërbimeve janë zgjeruar me shpejtësi.** Në vitin 2023, BE përbënte 42.4% të importeve totale të mallrave të Kosovës, më e ulët se në vitin 2019 (49.1%), ndërsa pjesëmarrja e partnerëve të CEFTA-s është rritur për pothuajse 2 pp në 16.3%. Importi i mallrave të Serbisë ishte ndaluar që nga mesi i qershorit 2023, përveç lëndëve të para, produkteve gjysmë të gatshme, plehrave minerale, ushqimi të kafshëve, makinerive dhe pajisjeve. Pjesëmarrja e BE-së në eksportin e mallrave të Kosovës është rritur në 32.3% në vitin 2023, nga 33.2% në vitin 2019, ndërsa përqindja e vendeve të CEFTA-s ka rënë në 40% nga 43%.

Hapja tregtare (d.m.th. vlera totale e eksporteve dhe importeve) mbeti në 110.2% të BPV-së në vitin 2023, dukshëm më e lartë se në vitin 2019 (85.8%) falë një vlere shumë më të lartë të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve. Eksportet e shërbimeve janë dukshëm më të mëdha se eksportet e mallrave. Ato dominohen nga shërbimet e udhëtimit me rritje të shpejtë (kryesisht të lidhura me turizmin e diasporës nga Evropa Perëndimore), të ndjekura nga eksportet e shërbimeve TIK, të cilat janë rritur edhe më shpejt vitet e fundit.

**Shtetet anëtare të BE-së mbesin investitorët kryesorë në Kosovë.** Fluksi neto i IHD-ve është rritur për rreth 18% në vitin 2023, kryesisht si rezultat i investimeve të konsiderueshme të diasporës në pasuri të paluajtshme, pasuar nga aktivitetet financiare dhe të sigurimit. Koncentrimi i madh në këta sektorë (82% e flukseve të IHD-ve) bënë pak në përmirësimin e kapaciteteve të eksportit të Kosovës. Pjesëmarrja e BE-së në stokun neto të IHD-ve të Kosovës arriti në 42.4% në vitin 2023, nga 34.2% në vitin 2019. Pjesëmarrja e Gjermanisë dhe Zvicrës (dy vende me diaspora të mëdha nga Kosova), është rritur në 18.6% përkatësisht 18.2% në vitin 2023, nga 12.8% dhe 12.1% në vitin 2019.

## 2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT DHE KONTROLLI FINANCIAR

### Kapitulli 5 – Prokurimi publik

*Rregullat e BE-së sigurojnë që prokurimi publik i mallrave, shërbimeve dhe punëve në çdo Shtet Anëtar është transparent dhe i hapur për të gjitha kompanitë e BE-së mbi bazën e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.*

<sup>11</sup> OBZHE (2022), *Indeksi i politika të NVM: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022*.

## Strukturat institucionale dhe harmonizimi i legjislacionit

**Korniza ligjore** për prokurimin publik mbetet pjesërisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së për prokurimin publik. Një projektligj i ri për prokurimin publik është në pritje të miratimit nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve prej tre vitesh. Legjislacioni zbatues i ligjit të ri ende nuk është hartuar. Një ligj i ri për partneritetet publike-private dhe koncesionet është ende në pritje të miratimit.

Pavarësia funksionale e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) e nënvizuar nga *acquis* e BE-së duhet të pasqyrohet në Ligjin e ri për prokurimin publik. Organi shqyrtues duhet të jetë funksional, të rrisë kapacitetet e tij dhe të menaxhojë procesin e shqyrtimit në kohë, në mënyrë efektive dhe transparente.

Është forcuar dhe zyrtarizuar bashkëpunimi ndërmjet Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), OSHP-së, Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për të reduktuar rreziqet në këtë fushë. Megjithatë, KRPP vazhdon të operojë me kapacitete të pamjaftueshme teknike dhe njerëzore. Në vitin 2023, Komisioni ka filluar aktivitetet e monitorimit *ex ante* të parandalimit për procedurat e prokurimit, evidentimin e rasteve të shkeljeve ligjore dhe kriterëve diskriminuese. Që nga janari i vitit 2024, ky monitorim i bazuar në rrezik është automatizuar dhe lansuar përmes platformës së prokurimit elektronik pa diskrecion të autoritetit kontraktor.

## Zbatimi dhe kapacitetet për zbatim

**Tregu i prokurimit publik** në Kosovë vlerësohet se përbënte 8.23% e BPV-së në vitin 2023, krahasuar me 6.5% të BPV-së në vitin 2022. Në vitin 2023 janë nënshkruar 10,183 kontrata publike, krahasuar me 10,290 në vitin 2022. Sa i përket vlerës, kontratat e nënshkruara në vitin 2023 kanë arritur në 810 milionë euro, nga 559 milionë euro në vitin 2022.

Në vitin 2023, vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përdorur raportin më të mirë çmim-cilësi ka arritur në 114 milionë euro, ose 14.19% (nga 5.66% në vitin 2022 dhe 1% në vitin 2021). Përdorimi i këtij kriteri inkurajohet dhe mbështetet përmes trajnimeve nga KRPP.

Kriteri i çmimit më të ulët mbetet dominues duke përbërë 85.81% të kontratave publike të dhëna, krahasuar me 94.34% në vitin 2022. Një mesatare e mirë prej 3.5 operatorë ekonomikë për tender kanë dorëzuar oferta në vitin 2023.

Kosova duhet të përmirësojë planifikimin e saj dhe të zvogëlojë përdorimin e procedurave të negociuarat ë prokurimit. Për të reduktuar rreziqet e keqpërdorimit dhe mashtrimit, është e rëndësishme të sigurohet transparencë e plotë, për të ofruar arsyetim të qëndrueshëm duke shpjeguar vendimin për dhënien e kontratës dhe për të ruajtur gjurmët e auditimit. Në vitin 2023, procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë ishin 13.5%, me shumicën e kontratave të lidhura nga Korporata Energjetike e Kosovës. Ndërlidhja ndërmjet sistemit të prokurimit elektronik dhe sistemeve të tjera relevante të TI-së të Qeverisë, si Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave i Kosovës, nuk është funksionale.

Ka dallime në **kapacitetet e autoriteteve kontraktuese për të menaxhuar proceset e prokurimit publik**. Në vitin 2023 janë organizuar trajnime për 136 zyrtarë nga 62 autoritete kontraktuese për hulumtimin e tregut dhe përdorimin e raportit më të mirë çmim-cilësi dhe nevojave për të vazhduar për planifikimin dhe zbatimin e kontratave.

## Sistemi efikas i mjeteve juridike

Legjislacioni i Kosovës për **të drejtën e mjeteve juridike** është gjerësisht në përputhje me *acquis*-



në e BE-së. Ankesat për të konkuruar çmimet e prokurimit mund të bëhen përmes platformës së prokurimit elektronik. Megjithatë, Kosova duhet të sigurojë që OSHP të mbetet funksionalisht e pavarur për të menaxhuar ankesat në kohë, në mënyrë efektive dhe transparente. Përdorimi i ekspertizës së jashtme afatshkurtër rekomandohet vetëm për shqyrtimin e rasteve specifike dhe duhet zëvendësuar me ekspertë shqyrtues ligjorë të kualifikuar afatgjatë, të cilët sigurojnë vendime në kohë dhe cilësore për ankesat. Bordi i OSHP-së është ende i pakompletuar.

## Kapitulli 18 – Statistikat

*Statistikat evropiane zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen nga Shtetet Anëtare të BE-së, të udhëhequra nga parimet dhe kriteret e cilësisë të përpunuara në Rregulloren për statistikat evropiane, si pavarësia profesionale, paanshmëria, besueshmëria, transparencja dhe konfidencialiteti. Ekzistojnë rregulla të përbashkëta për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor, të cilat specifikohen më tej në legjislacionin sektorial që përbëjnë acquis-në e BE-së për statistikat.*

Sa i përket **infrastrukturës statistikore**, zbatimi i kornizës ligjore duhet ende të intensifikohet.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) duhet të forcojë rolin e saj si organi kryesor zyrtar i statistikave, të përmirësojë qeverisjen me statistika dhe koordinimin ndërmjet institucioneve të sistemit kombëtar statistikor, dhe të sigurojë qasje më të mirë në burimet e të dhënave administrative. Infrastruktura dhe kapacitetet e zyrave të ASK-së kanë nevojë të vazhdueshme për përmirësim, dhe sistemet e saj të brendshme, proceset dhe menaxhimi i deleguar mbesin sfidë. Transmetimi i të dhënave në Eurostat vazhdon të përmirësohet. ASK ka lansuar uebsajtin e saj të ri në korrik 2023, i cili duhet të përmirësohet më tej me më shumë përmbajtje.

Sa i përket **klasifikimeve dhe regjistrave**, Kosova vazhdon të përdorë klasifikimin evropian të aktiviteteve ekonomike (NACE Rev. 2). Regjistrat e bujqësisë, biznesit dhe amvisërive përditësohen rregullisht, por regjistri i popullsisë mbetet i vjetruar.

**Sa i përket statistikave makroekonomike**, periudha raportuese ka pasur njëfarë përmirësimi me publikimin, për herë të parë, të BPV-së sipas qasjes së të ardhurave për periudhën 2021-2022 dhe BPV-së rajonale sipas rajoneve statistikore në Kosovë për periudhën 2018-2021 në dhjetor 2023. Mospërputhjet metodologjike mbesin. Llogaritë tremujore sektoriale nuk përpilohen rregullisht. Numri i tabelave të transmetimit të Sistemit Evropian të Llogarive 2010 (ESA 2010) të dërguara në Eurostat ka vazhduar të rritet dhe të dhënat janë përmirësuar.

Sa u përket statistikave të financave të Qeverisë dhe procedurës së deficitit të tepërt, nevojitet punë e mëtejshme për të përmbushur plotësisht ESA 2010, duke përfshirë përmirësimin e mbulimit dhe afateve kohore të tabelave të procedurës së deficitit të tepërt dhe plotësimin e pyetësorit. Aspektet cilësore të tabelave të statistikave të financave të Qeverisë që i janë ofruar Eurostatit duhet ende të përmirësohen. Statistikat mujore për tregtinë ndërkombëtare të mallrave dorëzohen në Eurostat.

**Statistikat afariste** strukturore janë të kufizuara në disponueshmëri dhe mungon dallimi ndërmjet investimeve publike dhe private ose sipas sektorëve. Statistikat e turizmit dhe transportit nuk janë në përputhje me *acquis*. Statistikat e TIK-ut për kokë banori publikohen rregullisht. Statistikat e TIK-ut për vitin 2022 për ndërmarrjet janë publikuar në nëntor 2023. HICP është në përputhje me afatet e transmetimit. Ekzistojnë disa statistika kombëtare të biznesit afatshkurtër, por nuk janë në përputhje me kërkesat e Statistikave Evropiane të Biznesit.

Sa i përket **statistikave sociale**, regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare është kryer nga 5 prilli deri më 24 maj 2024. Ka pasur një numër kritikash drejtuar ASK-së për vonesa në përgatitjen dhe shqetësime për një fushatë të pamjaftueshme të vetëdijesimit dhe komunikimit publik, veçanërisht në lidhje me komunitetet joshumicë. Komunitetet në katër komunat në veri e sërish kanë bojkotuar regjistrimin, ndërsa popullatat pakicë në pjesët e tjera të Kosovës kanë marrë pjesë. Regjistrimi ka ngarkuar për së tepërmi burimet njerëzore të ASK-së, duke çuar në vonesa në fusha

të tjera të punës. Statistikat më të fundit për të ardhurat dhe kushtet e jetesës për vitin 2022 janë publikuar në dhjetor 2023. Statistikat e mirëqenies sociale prodhohen çdo muaj, ndërsa statistikat e tregut të punës prodhohen vetëm pjesërisht. Kosova akoma nuk ka publikuar statistika për indeksin e kostos së punës, strukturën e të dhënave të të ardhurave ose vendet e lira të punës. Statistikat e arsimit janë të përafuara me klasifikimin e standardeve ndërkombëtare të arsimit. Statistikat e shëndetit publik dhe kimit nuk janë ende në përputhje me standardet e BE-së. ASK duhet të përmirësojë mbledhjen dhe përpilimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Kosova nuk ka Indeks të Barazisë Gjinore.

Lidhur me **statistikat bujqësore**, përgatitja e anketës së ekonomive bujqësore është bërë në përputhje me *acquis*-në e BE-së, përkundër vonesave. Nuk ka pasur ndryshime sa i përket prodhimit të indekseve të çmimeve bujqësore dhe llogarive ekonomike për bujqësinë, prodhimit të bilanceve të ofertës dhe indeksit të punës në bujqësi, si dhe transmetimit të statistikave të bujqësisë në Eurostat.

**Statistikat e energjisë dhe mjedisit** mbasin pjesërisht në përputhje me *acquis*. Statistikat e konsumit të energjisë mbledhen dhe publikohen rregullisht. Mungesa e treguesve të eficiencës së energjisë është pengesë për raportimin e kursimeve të energjisë. Kosova rregullisht dorëzon të dhëna për mbeturinat komunale. Ka pasur përparim në llogaritë e emetimeve në ajër dhe taksat mjedisore, megjithëse ende nuk plotësohen kërkesat për pajtueshmëri.

## Kapitulli 32 – Kontrolli financiar

*BE promovon reformën e sistemeve të qeverisjes kombëtare për të përmirësuar llogaridhënien menaxherial, menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe auditimin e jashtëm të fondeve publike. Rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së kundër mashtrimit në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe mbrojnë euron nga falsifikimi.*

### Kontrolli i brendshëm financiar publik

Kosova vazhdon të ketë kornizën e politikave të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) të integruar në strategjinë për MFP për periudhën 2022-2026. Megjithatë, shkalla e zbatimit të aktiviteteve të KBFP ka mbetur e ngadaltë. Puna për hartimin e një ligji të ri për menaxhimin e financave publike po vazhdon dhe legjislacioni i KBFP duhet të harmonizohet me Ligjin e ri për MFP pasi të miratohet dhe me rregullat e procedurale të Qeverisë dhe legjislacionin tjetër përkatës për administratën publike. Njësia qendrore e harmonizimit harton një raport të KBFP çdo vit, por publikimi dhe miratimi i tij në kohë mbetet sfidë. Zbatimi efikas i **përgjegjësisë menaxheriale** mbetet sfidë për përdoruesit buxhetorë si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Linjat e delegimit dhe llogaridhënies duhet të përfshihen më mirë në praktikën administrative dhe kulturën e administratës publike.

Korniza ligjore për **kontrollin e brendshëm** vazhdon të mos zbatohet mjaftueshëm dhe kapacitetet e njësive qendrore të harmonizimit mbasin të dobëta. Miratohet Udhëzimi Administrativ për Programin Kombëtar të Trajnimit për Certifikimin e Auditorëve të Brendshëm në Sektorin Publik. Sigurimi i numrit adekuat të stafit në njësitet e auditimit të brendshëm mbetet një sfidë, qoftë për shkak të plotësimit jo të rregullt të vendeve të lira të punës apo pensionimit të zyrtarëve. Përkundër miratimit të metodologjisë së monitorimit për sigurimin e cilësisë së auditimit të brendshëm në entitetet e sektorit publik, skema e sigurimit të cilësisë mbetet joefektive për shkak të kapaciteteve të dobëta të stafit dhe ekspertizës në njësitet e auditimit të brendshëm. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga organizatat buxhetore duhet të përmirësohet. Raportimi i parregullsive vazhdon të mos përdoret siç duhet si mjet menaxhimi dhe siç e kërkojnë rregullat për raportimin e rasteve të mashtrimit të mundshëm. Përkundër zbatimit të kontrollit të zotimeve, funksionimi i tij mbetet joefektiv, pasi shumë institucione publike vazhdojnë të kenë pagesa të vonuara (*shihni pjesën 2.1.2*).

## Auditimi i jashtëm

Në vitin 2023, ZKA ka hartuar një ligj të ri për Auditorin e Përgjithshëm, në përputhje me parimet e INTOSAI-t, për t'i mundësuar ZKA-së të funksionojë në mënyrë më efektive dhe të pavarur. Megjithatë, miratimi i tij mbetet në pritje. Funksionimi i ZKA-së duhet të sigurohet në praktikë dhe të forcohet për të gjithë përdoruesit e buxhetit. Përveç kësaj, kapacitetet administrative të ZKA-së mbesin të dobëta. Praktikrat e menaxhimit të cilësisë mbesin të zbatuara në mënyrë joefektive. ZKA duhet ende të rrisë numrin dhe të përmirësojë praktikrat në **auditimin e performancës**, si dhe përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe përcjelljes. Zbatimi i rekomandimeve të ZKA-së mbetet për t'u përmirësuar. Për më tepër, ZKA ka miratuar Strategjinë e Komunikimit 2023-2026 për të përmirësuar shtrirjen e saj, por ndërgjegjësimi i qytetarëve për punën e auditimit mbetet i ulët.

## Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Ngritja e një njësie të shërbimit të koordinimit kundër mashtrimit (AFCOS) dhe një rrjeti AFCOS mbetet në pritje. Sipas vendimit të Zyrës së Kryeministrit, AFCOS planifikohet të bëhet një organ koordinues pa kompetenca hetimore në kuadër të Thesarit në Ministrinë e Financave. Nuk ka progres të mëtjshëm në zbatimin e legjislacionit përkatës.

## Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Ekziston **përputhje e pjesshme me acquis-në e BE-së** lidhur me sistemin për luftën kundër falsifikimit të euros përmes Ligjit për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) dhe Kodit Penal. BQK ka miratuar një Rregullore për operacionet me para në dorë me qëllimin e deklaruar për të konsoliduar sistemin e pagesave në mënyrë që BQK të bëhet anëtare e Zonës së Vetme të Pagesave në Euro dhe të ketë qasje në Target Instant Payment Settlement (*shihni pjesën 'Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë'*). BQK ka bërë disa përparime me ndalimin e qarkullimit të falsifikimit dhe trajtimin e numrit të shtuar të monedhave euro të konfirmuara si të falsifikuara. Nevojiten përpjekje të mëtjshme në forcimin e koordinimit dhe shkëmbimit në kohë të të dhënave ndërmjet institucioneve kyçe, dhe në forcimin e kapaciteteve të Agjencisë për Mjekësi Ligjore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

## **3. MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL**

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal përbëjnë një pjesë thelbësore të procesit të integritet evropian të Kosovës. Ato ndihmojnë në stabilitetin, pajtimin dhe një klimë të favorshme për adresimin konstruktiv të çështjeve të hapura dypalëshe dhe trashëgimisë të së kaluarës.

Kosova ka vazhduar me angazhimin e saj në një sërë nismash të bashkëpunimit rajonal, siç janë Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Komuniteti i Kapaciteti i Energjisë, Komuniteti i Transportit, Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Samiti i katërt vjetor BE-Ballkani Perëndimor është mbajtur në Bruksel në dhjetor 2023, ku është riafirmuar perspektiva e anëtarësimit në BE të Ballkanit Perëndimor dhe janë diskutuar masat për avancimin e mëtjshëm të integritet gradual.

Kosova është angazhuar në mënyrë aktive në dimensionin rajonal të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, duke marrë pjesë aktive si në takimet ministrore ashtu edhe në takimet e liderëve.

Sa i përket Tregut të Përbashkët Rajonal, Samiti i Procesit të Berlinit është mbajtur për herë të parë në rajon, në Tiranë, në tetor 2023. Aty është miratuar një marrëveshje shtesë për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermierët, kirurgët veterinarë, farmacistët dhe mamitë. Udhërrëfyesi për roaming ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së ka hyrë në fazën e parë të zbatimit. Kosova ka ratifikuar të katër marrëveshjet për lëvizjen e lirë dhe ka depozituar instrumentet përkatëse të njoftimit. Në Komitetin e Përbashkët të CEFTA-s, në tetor 2024m janë miratuar dymbëdhjetë vendime të rëndësishme. Ndalesa për mallrat nga Serbia, e vendosur në qershor 2023, është hequr në tetor

2024 dhe është zëvendësuar me një sistem kontrollesh manuale.

Fati i pazgjidhur i **personave të pagjetur** të zhdukur gjatë konflikteve të viteve 1990 mbetet çështje kyçe për t'u zgjidhur në Ballkanin Perëndimor. Autoritetet e Kosovës kanë zgjidhur dhjetë raste nga qershori 2023 deri në qershor 2024. Deri në shtator 2024 mbeten edhe 1,612 persona të pagjetur si rezultat i konfliktit.

Gjatë periudhës raportuese, puna e përbashkët e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe ekspertëve vendorë të mjekësisë ligjore ka rezultuar në 64 operacione në terren, 11 zhvarrime dhe mbledhje të 32 grupeve të mbetjeve njerëzore. Në gusht 2023, ekspertë të mjekësisë ligjore nga Serbia kanë marrë pjesë në një inspektim të përbashkët mjeko-ligjor të katër rasteve në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, gjë që përbën zhvillim pozitiv.

Që nga prilli i vitit 2021, nuk ka pasur asnjë seancë të Grupit Punues Beograd-Prishtinë për Personat e Zhdukur, i cili udhëhiqet nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, pasi Delegacioni i Kosovës po refuzon të mbajë takime derisa Serbia të ndryshojë Shefin e Delegacionit. Më 31 janar 2024, në Gjenevë është mbajtur një takim *ad hoc* i Grupit Punues në nivel të Zëvendëshefave të Delegacioneve. Përkundër këtij zhvillimi pozitiv, bashkëpunimi Kosovë-Serbi në kuadër të Grupit Punues prapëseprapë është penguar nga sjellja jokonstruktive e të dyja palëve.

Zbatimi i Deklaratës për Personat e Zhdukur të miratuar në takimin e nivelit të lartë të dialogut të ndërmjetësuar nga BE më 2 maj 2023 nuk ka filluar pasi palët janë ende duke negociuar – sipas Dialogut të lehtësuar nga BE – termat e referencës për Komisionin e Përbashkët, i cili parashikohet të mbështesë përpjekjet për të zgjidhur fatin e personave të zhdukur të mbetur.

Kosova ka marrëdhënie të ngushta me **Shqipërinë**. Konsultimet politike ndërmjet dy Ministrive të Jashtme janë mbajtur në prill 2024, nën drejtimin e zëvendësministrave të jashtëm të të dyja palëve. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur takime ndërqeveritare. Marrëveshja për heqjen e kontrolleve me letërnjoftime dhe pasaporta në kufirin e përbashkët ka hyrë në fuqi në maj 2024.

Kosova ka marrëdhënie të mira fqinjësore me **Malin e Zi**. Dy Ministrinë e Punëve të Jashtme zhvilluan konsultime politike në mars 2024. Po ashtu në mars 2024, Kosova dhe Mali i Zi nënshkruan një marrëveshje dypalëshe për programin e bashkëpunimit ndërkufitar të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA) III për periudhën 2021-2027.

Kosova ka marrëdhënie përgjithësisht të mira me **Maqedoninë e Veriut**. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur disa takime të nivelit të lartë.

Përpara zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në Maqedoninë e Veriut në maj 2024, kryeministri Kurti ka bashkëpunuar me përfaqësues të partive opozitare.

Nuk ka marrëdhënie zyrtare me **Bosnjë dhe Hercegovinën**, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe të dy mbajnë një regjim të rreptë vizash. Herë pas here janë mbajtur takime dypalëshe në margjinat e samiteve rajonale dhe shumëpalëshe. Kosova ka avokuar që Bosnja dhe Hercegovina të ratifikojë marrëveshjen rajonale për lëvizje të lirë, për të mundësuar udhëtimin pa pengesë me letërnjoftime.

Kosova vazhdon të ketë marrëdhënie miqësore me **Turqinë**, përfshirë në sektorin politik, atë të mbrojtjes, të ekonomisë dhe kulturës. Presidentja e Kosovës ka vizituar Turqinë për të marrë pjesë në Forumin Diplomatik të Antalisë, më 2 mars 2024, dhe është takuar me Presidentin Recep Tayyip Erdoğan. Turqia dhe Kosova kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ushtarak në janar 2024.

**Gjeorgjia, Republika e Moldavisë dhe Ukraina** nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

#### **4. Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë**

Dialogu i ndërmjetësuar nga BE për **normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe**

**Serbisë** ka vazhduar gjatë periudhës raportuese me takime të rregullta dialogu. Takimi më i fundit i nivelit të lartë ndërmjet liderëve është mbajtur më 26 qershor 2024.

Pas takimit të kryenegociatorëve më 17 shtator 2024, të dyja palët janë zotuar zyrtarisht të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe të çojnë shpejt përpara procesin e normalizimit. Në këtë kontekst, si Kosova ashtu edhe Serbia janë zotuar të zbatojnë plotësisht të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Aneksit të saj të Zbatimit, si dhe të gjitha marrëveshjet e kaluara.

Kjo pason progresin e mëparshëm në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku moment historik është **Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit**, e arritur në Bruksel më 27 shkurt 2023, dhe **Aneksi i Zbatimit të saj**, i dakorduar në Ohër më 18 mars 2023, hapat përgatitorë drejt themelimit të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë Serbe në Kosovë; përparimet në zbatimin e Udhërrëfyesit të Energjisë; njohja reciproke e targave dhe angazhimet për trajtimin e çështjes së personave të zhdukur. Në përputhje me aneksin e zbatimit, Marrëveshja është bërë zyrtarisht pjesë e proceseve përkatëse të anëtarësimit të Kosovës dhe Serbisë në BE.

Si Kosova ashtu edhe Serbia pritet të zbatojnë obligimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit. Kjo përfshin themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe (A/BKS). Kosova pritet të fillojë procesin që çon në themelimin e A/BKS bazuar në propozimin evropian të paraqitur palëve më 21 tetor 2023. Serbia pritet të fillojë të përmbushë obligimet e saj nga Marrëveshja paralelisht duke iniciuar njohjen e dokumenteve, simboleve dhe institucioneve të Kosovës. Marrëveshja është e vlefshme dhe ligjrisht e detyrueshme për palët dhe çdo formalitet, përfshirë miratimin ose "formalizimin" e saj, nuk duhet të pengojë përparimin në zbatimin e saj. Palët gjithashtu kanë për detyrë të zbatojnë plotësisht të gjitha Marrëveshjet e Dialogut të kaluar. Konstruktiviteti i palëve do të vlerësohet bazuar vetëm në performancën e tyre të zbatimit. Normalizimi i marrëdhënieve mbetet kusht thelbësor në rrugën evropiane të të dyja palëve dhe të dyja rrezikojnë të humbasin mundësi të rëndësishme në mungesë të progresit.

Gjatë periudhës raportuese, tensionet në veri të Kosovës mbetën të larta.

Kosova në mënyrë të përsëritur ka kryer aktivitete në kundërshtim me detyrimet e saj në kuadër të Dialogut, duke përfshirë operacionet policore kundër zyrave dhe shërbimeve të mbështetura nga Serbia në veri, miratimin e një rregulloreje nga Banka Qendrore e Kosovës për operacionet me para të gatshme që ndalon transaksionet në çdo valutë tjetër përveç Euros më 1 shkurt 2024, si dhe mbylljen e zyrave të Bankës Postare Serbe dhe Postës Serbe në veri të Kosovës. BE shprehu vazhdimisht shqetësime për mungesën e vazhdueshme të koordinimit nga Kosova dhe ndikimin negativ tek njerëzit në terren, ndërsa përsëriti se veprimet mund të çojnë në përshkallëzim të mëtejshëm të një situatë tashmë të paqëndrueshme – më së fundi në deklaratën e saj të 30 gushtit 2024. Vendimi për operacionet me para të gatshme në mënyrë efektive ndalon transferimin e fondeve nga Qeveria e Serbisë për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera, si dhe zyrat e mbështetura nga Serbia në Kosovë. Fatkeqësisht, nuk ka mundur të gjendet një zgjidhje e përkohshme e pranueshme reciprokisht për njerëzit më të prekur nga kjo rregullore. Procesi i normalizimit vazhdon të ndikohet nga hapat e pamjaftueshëm të Serbisë për të siguruar përgjegjësi për sulmin e dhunshëm nga sulmuesit e armatosur serbë të Kosovës kundër Policisë së Kosovës më 24 shtator 2023 në Banjskë, i cili përbënte përshkallëzimin më të rëndë në vitet e fundit.

Sa i përket gjendjes aktuale të zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të kaluara të dialogut:

- **Tërheqja e serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës** në nëntor 2022 dhe bojkotimi i zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës, në prill të vitit 2023, shkelin detyrimet e Serbisë për dialogun dhe paraqesin prapaktim serioz nga Serbia për të vepruar në përputhje me "Marrëveshjen e parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve", të prillit 2013 dhe shkelje direkte të Marrëveshjes për Drejtësinë të vitit 2015. Votimi i 23 prillit 2024 për largimin e katër kryetarët shqiptarë të Kosovës nga komunat me shumicë serbe të Kosovës në veri, të zgjedhur në vitin 2023, mund të kishte hapur një rrugë për kthimin e serbëve të Kosovës në institucionet e

Kosovës. Megjithatë, votimi për largimin e tyre është bojkotuar nga elektorati serb i Kosovës – ndër të tjera për shkak të pragut prej 50% të të gjithë votuesve të regjistruar – kryetarët aktualë mbesin në detyrë për momentin. Kthimi i zyrtarëve serbë të Kosovës në institucionet e Kosovës dhe mbajtja e zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës, të kërkuara nga Serbia më 13 shtator 2024, duhet të bëhet në përputhje me marrëveshjet e kaluara të Dialogut dhe ligjet e Kosovës.

- Ende nuk ka pasur progres të mëtjshëm në zbatimin e Marrëveshjes së gushtit 2015, e cila ka përcaktuar parimet për **krijimin e A/BKS**. Ndonëse BE mirëpriti prezantimin e projekt statutit të parë të A/BKS-së në Dialogun e Nivelit të Lartë në maj të vitit 2023, drafti i paraqitur nuk është në përputhje me Marrëveshjet përkatëse të Dialogut. Prandaj, propozimi evropian për themelimin e A/BKS-së në Kosovë iu paraqit palëve më 21 tetor 2023. Ky propozim bazohet në standardet evropiane dhe praktikat më të mira dhe plotësisht në përputhje me kornizën kushtetuese të Kosovës. Kosovës dhe Serbisë tani i kërkohet që të angazhohen në mënyrë konstruktive në krijimin e A/BKS-së pa vonesa të mëtjshme. Ky detyrim është pjesë e zbatimit të Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve, të cilën palët pritet ta avancojnë, siç është bërë thirrje nga Këshilli Evropian në tetor 2023. Çështja e strukturave të mbështetura nga Serbia në Kosovë duhet të trajtohet në të njëjtin kontekst dhe jo përmes masave të njëanshme dhe të pakoordinuara.
- Kosova dhe Serbia pritet të angazhohen në mënyrë konstruktive në **hapjen e urës së Mitrovicës** për qarkullimin e automjeteve. Gjatë gushtit 2024, Kosova ka insistuar në hapjen e menjëhershme të plotë të urës. Qëndrimi i BE-së mbetet se çdo vendim apo veprim për hapjen e saj duhet të bihet dakord dhe të koordinohet në kontekstin e Dialogut dhe me partnerët e sigurisë.
- Në dhjetor 2023, kompanitë KEDS dhe Elektroserver nënshkruan marrëveshjen komerciale të nevojshme që Elektroserver të fillojë furnizimin me energji elektrike në katër komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe. Miratimi i kësaj marrëveshjeje ka zhbllokuar zbatimin e **Udhërrëfyesit të Energjisë të vitit 2022**, duke zbërthyer në hollësi zbatimin e marrëveshjeve të vitit 2013 dhe 2015 për Energjinë. Faturimi dhe furnizimi me energji ka filluar zyrtarisht në janar 2024. Palët inkurajohen të bien dakord për një periudhë tranzicioni për të mundësuar një mbulim më të gjerë të faturimit dhe pagesave të energjisë, si dhe përmirësimet e nevojshme të infrastrukturës.
- Sa u përket **marrëveshjeve të dialogut teknik** (2011-2012), shumë nga to nuk janë zbatuar ose janë zbatuar vetëm pjesërisht. Derisa të gjenden zgjidhje të qëndrueshme, të dyja palët duhet të mbesin të përkushtuara për zbatimin e vazhdueshëm të **Marrëveshjeve për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal**, që mundëson pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale. Asnjëra palë nuk duhet të bllokohet punën e forumeve rajonale për mosmarrëveshjet dypalëshe. Zbatimi i **Marrëveshjeve për kadastrin dhe pranimi i diplomave universitare** është ende në pritje për shkak të moszbatimit nga Serbia. Serbia gjithashtu duhet të adresojë ende çështjen e zhvendosjes së **strukturave doganore administrative serbe** me emërtim të Kosovës që veprojnë nga brenda Serbisë.
- Lidhur me **MIK**, Pikat e Përbashkëta të të Përkohshme të Kalimit Kufitar (PPK) ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të jenë funksionale. Vetëm dy nga gjashtë PPK-të e përhershme janë themeluar (Merdarë dhe Mutivodë). Serbia ende nuk ka krijuar PPK të përhershme për pritje në anën e saj (Jarinjë/Rudnicë, Konçul-Dheu i Bardhë dhe Depçe/Muçibabë), gjë që ka çuar në pezullimin e fondeve të BE-së për këtë projekt, në korrik 2018. Përveç kësaj, Serbia duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive për të mundësuar ndërtimin e PPK-së së tretë të organizuar nga Kosova në veri të Kosovës në Tabavijë/Bërnjak. Nga Serbia nevojiten përpjekje shtesë për mbylljen e rrugëve dhe rrugëve anësore ilegale për të siguruar përdorimin ekskluziv të pikave të kalimit zyrtar për mallrat dhe personat që hyjnë ose dalin nga Kosova. Serbia duhet të lejojë rifillimin e takimeve të përbashkëta të MIK të ndërmjetësuar nga BE në të gjitha nivelet (lokale, rajonale dhe qendrore).

- Sa i përket **lirisë së lëvizjes**, BE mirëpret heqjen graduale të targave me emërtimet e qyteteve të Kosovës, të lëshuara nga Serbia, dhe njohjen reciproke të targave, gjë që është bërë në dhjetor 2023 dhe janar 2024. Zbatimi i plotë i marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes edhe më tej kërkon hapa shtesë.
- Të dyja palët duhet të respektojnë plotësisht **Marrëveshjen e Telekomit** dhe në asnjë mënyrë të mos vënë në rrezik zbatimin e saj të suksesshëm deri me tani. Palët pritet gjithashtu të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme për çështjet e mbetura si **harmonizimi i frekuencave** dhe **shërbimeve postare** përmes dialogut.
- Procedimi i kërkesave për **ndihmë të ndërsjellë juridike** është ndërprerë nga Serbia. Së fundmi, Kosova ka refuzuar një kërkesë për ndihmë në rastin Banjska. Të dyja palët duhet të veprojnë në përputhje me Marrëveshjen përkatëse të Dialogut. Serbia duhet të rifillojë menjëherë përpunimin dhe të adresojë gjithashtu kërkesat në pritje.
- Të dyja palët duhet të respektojnë në mënyrë më konsekuente **Marrëveshjet për Vizitat Zyrtare**. Kosova dhe Serbia duhet të lejojnë vizitat e kryenegociatorëve të tyre përkatës dhe zyrtarëve të tjerë të Qeverisë kur ato lajmërohen dhe të zhvillohen në përputhje me Marrëveshjet, gjë që nuk ka qenë gjithmonë rasti gjatë periudhës raportuese.
- Nuk është bërë ndonjë përparim në zbatimin e Deklaratës politike për **Personat e Zhdukur** të miratuar në maj 2023. Palët inkurajohen të përmbahen nga politizimi i kësaj çështje humanitare dhe të fillojnë menjëherë me zbatimin e deklaratës dhe, si hap i parë, të bien dakord për Termat e Referencës për Komisionin e Përbashkët që do të krijohet sipas deklaratës.

Në përgjithësi, Kosova dhe Serbia kanë marrë pjesë në Dialog, por duhet të demonstrojnë përkushtim më serioz dhe konstruktiv për të avancuar procesin e normalizimit. Duke ecur përpara, Kosova dhe Serbia gjithashtu duhet të bëjnë përpjekje të mëtejshme thelbësore për të shmangur veprimet që minojnë stabilitetin dhe retorikën që nuk është e favorshme për dialog dhe pajtim

## 5. STANDARDET EVROPIANE

### GRUPIMI TEMATIK 2: TREGU I BRENDSHËM

Ky grupim tematik mbulon lëvizjen e lirë të mallrave (Kapitullin 1); lirinë e lëvizjes për punëtorët (Kapitullin 2); të drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime (Kapitullin 3); lëvizjen e lirë të kapitalit (Kapitullin 4); të drejtën e kompanive (Kapitullin 6); të drejtën e pronësisë intelektuale (Kapitullin 7); politikat e konkurrencës (Kapitullin 8); shërbimet financiare (Kapitullin 9); dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit (Kapitulli 28).

#### Kapitulli 1 - Lëvizja e lirë e mallrave

*Lëvizja e lirë e mallrave siguron që shumë produkte të mund të tregtohen lirshëm në të gjithë BE-në bazuar në rregullat dhe procedurat e përbashkëta. Kur produktet rregullohen nga rregullat kombëtare, parimi i lëvizjes së lirë të mallrave i pengon këto rregullore nga krijimi i barrierave të pajustificuara për tregtinë.*

##### Parimet e përgjithshme

Lidhur me **prodhimin, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve industriale**, legjislacionin përkatës zbatues për Ligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve (i cili është krijuar për t'u përafuar me *acquis* përkatës të BE-së ) po miratohet gradualisht. Ligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut është në pritje të miratimit.

##### Fushat e paharmonizuara

Shqyrtimi i legjislacionit të Kosovës për të eliminuar barrierat tregtare dhe për të siguruar përafrimin me detyrimet sipas **neneve 34-36** të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) po përparon ngadalë për shkak të kapaciteteve dhe burimeve njerëzore të kufizuara. Pika e kontaktit për njoftim monitoron detyrimin për të njoftuar.

##### Fushat e harmonizuara: infrastruktura cilësore

Agjencia e **Standardizimit** nuk është anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare (Komiteti për Standardizim (CEN)/Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC)) për shkak të statusit të Kosovës. Sistemi i tij online e-standard është pjesërisht i pajtueshëm me atë të CEN/CENELEC dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë të standardizimit dhe nevojiten zgjidhje alternative për të miratuar standardet më shpejt. Agjencia ngriti një qendër informacioni për standardet.

Drejtoria e Përgjithshme e **Akreditimit** e Kosovës (DAK) duhet të sigurojë pavarësinë dhe rolet dhe funksionet e qarta menaxheriale. Në Kosovë ekzistojnë 58 organe të vlerësimit të konformitetit.

Agjencia e **Metrologjisë** e Kosovës aktualisht është ende në pritje të anëtarësimit të asociuar në Asociacionin Evropian të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë (EURAMET). Gjatë periudhës së raportimit, Inspektorati i **mbikëqyrjes së tregut** kreu 3 079 inspektime të sigurisë së produkteve, vendosi 280 gjoba, ka dërguar 108 raste në gjykatë dhe ngriti një mekanizëm njoftimi për të alarmuar rastet e produkteve të pasigurta të identifikuara përmes mbikëqyrjes së tregut. Organet e standardizimit, akreditimit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut nuk kanë kapacitet apo staf të mjaftueshëm. Inspektimet në fushën e metrologjisë tashmë janë duke u zhvilluar nga Inspektorati Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut.

##### Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial

Nuk ka pasur përparim në përafrimin me *acquis*-në e BE-së për produktin e **'qasjes së re dhe asaj globale'**.

Gjithashtu nuk pati përparim në përafrimin me *acquis* për produktin e **'qasjes së vjetër'** duke



përfshirë në REACH dhe në etiketimin kimik (CLP), ose **masat procedurale** gjatë periudhës raportuese.

Inspektoratet përgjegjëse për kontrollet e mbikëqyrjes së tregut dhe sigurisë së produkteve janë të prirur kah korrupsioni. Kompetencat e tyre duhet të identifikohen qartë dhe nuk duhet të mbivendosen. Duhet të ketë staf të mjaftueshëm sa i përket numrit dhe cilësisë.

## Kapitulli 2 - Liria e lëvizjes së punëtorëve

*Shtetasit e një shteti anëtar të BE-së kanë të drejtë të punojnë në një shtet tjetër anëtar dhe duhet t'u ofrohen të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët e tjerë.*

Lidhur me **qasjen në tregun e punës**, lejet e punës janë ende të nevojshme për shtetasit e BE-së dhe anëtarët e familjeve të tyre që të kenë të drejtë të punojnë në Kosovë. Agjencia Kosovare e Punësimit ka lëshuar 202 leje pune afatshkurtra në vitin 2023, nga të cilat 114 ishin për shtetas të BE-së.

Lidhur me **koordinimin e sistemeve të sigurimeve sociale**, Kosova tashmë ka në fuqi marrëveshje dypalëshe për sigurimet sociale me Belgjikën, Holandën, Zvicrën dhe Shqipërinë. Këto marrëveshje sigurojnë që periudhat e punës në Kosovë nga shtetasit e këtyre vendeve (ose periudhat e punës në këto vende nga njerëzit e Kosovës) do të merren parasysh për të drejtën për përfitime të sigurimeve sociale. Negociatat për marrëveshjet e ngjashme po vazhdojnë me Slloveninë, Kroacinë dhe Austrinë.

Nuk ka progres në zbatimin e legjislacionit për të mbrojtur **të drejtat e pensionit suplementar** të punonjësve të lëvizshëm që kanë punuar jashtë vendit, duke përfshirë në shtetet anëtare të BE-së.

## Kapitulli 3 - E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

*Personat fizikë dhe juridikë të BE-së kanë të drejtë të vendosen në çdo shtet anëtar dhe të ofrojnë shërbime ndërkufitare. Për disa profesione të rregulluara, ekzistojnë rregulla për njohjen reciproke të kualifikimeve. Rregullat e BE-së për shërbimet postare fokusohen në përmirësimin e cilësisë së shërbimit universal, hapjen graduale të tregut ndaj konkurrencës dhe krijimin e një rregullatori të pavarur.*

Lidhur me të **drejtat e themelimit dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve**, Kosova ka përafruar pjesërisht legjislacionin e saj me *acquis*-në e BE-së për shërbimet. Është miratuar një plan i ri veprimi tre-vjeçar (2024-2027) për ta bërë legjislacionin sektorial në përputhje me *acquis*-në e BE-së për shërbimet, pas kësaj i mëparshmi ka skaduar pa zbatim të kënaqshëm. Për të siguruar që rregullat e saj janë në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të BE-së, Kosova duhet të rrisë më tej koordinimin ndërinstucional. Kërkesa që kompanitë e huaja të hapin një zyrë në Kosovë ende nuk është shfuqizuar dhe pengon lirinë e tyre për të ofruar shërbime.

Asnjë përparim i dukshëm nuk është bërë në zgjerimin e numrit të profesioneve të regjistruara në pikën e kontaktit të vetëm ose në transformimin e tij në një pikë të ofrimit të shërbimeve online të përshtatshme për përdoruesit. Edhe pse e qasshme për bizneset dhe publikun, platforma ofron vetëm informacione të përgjithshme dhe nuk është e dobishme. Ka mungesë të kapaciteteve administrative kryesisht të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Në fushën e **shërbimeve postare**, tregu postar i Kosovës është hapur për konkurrencë dhe legjislacioni është në përputhje me Direktivën e Shërbimeve Postare. Kosova duhet të përafrojë legjislacionin e saj me Rregulloren për shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare. Ekziston një ofrues i shërbimit universal dhe 28 operatorë të tjerë postarë aktiv në tregun postar. Autoriteti rregullator kombëtar është ligjërisht i ndarë dhe funksionalisht i pavarur por ka nevojë për fuqizim për të monitoruar dhe zbatuar rregullat e reja në tregun postar.

Ligji për **profesionet e rregulluara** nuk është në përputhje me *acquis*-në e BE-së dhe nuk përfshin rregullat për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Kosova duhet të miratojë një ligj të ri horizontal për njohjen e kualifikimeve profesionale për qasje në të gjitha profesionet e rregulluara, të harmonizojë kërkesat minimale të trajnimit për profesionet sektoriale, të ndryshojë ligjet ekzistuese sektoriale që rregullojnë profesionet dhe të hartojë një listë të detajuar të profesioneve të rregulluara. Për më tepër, Kosova duhet të përafrohet me testin e proporcionalitetit përpara se të miratojë një rregullore të re të profesioneve. Divizioni për Profesionet të Rregulluara në kuadër të Ministrisë së Arsimit nuk ka staf të mjaftueshëm dhe duhet të forcohet.

#### **Kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitali**

*Në BE, kapitali dhe investimet duhet të jenë në gjendje të lëvizin pa kufizime me rregulla të përbashkëta për pagesat ndërkufitare. Bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë zbatojnë rregulla të caktuara për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.*

Ekzekutimi i pagesave vazhdon të kryhet kryesisht me para në dorë, përkundër përpjekjeve për të promovuar përfshirjen financiare duke zgjeruar qasjen në shërbimet e pagesave. Transfertat e parave janë kryesisht të kufizuara në institucionet financiare tradicionale. Më shumë punë nevojitet për të reduktuar kostot e transaksioneve dhe për të lehtësuar qasjen e klientëve pa llogari dhe atyre që janë të pakënaqur me shërbimet. Kosova ka miratuar një rregullore që shtrin standardet IBAN në institucionet financiare jobanka. Kosova duhet të harmonizojë më tej legjislacionin e saj me Direktivën 2 e BE-së për Shërbimet e Pagesave dhe të adresojë mangësitë në kornizën rregullatore të tregtisë elektronike. Kjo është thelbësore për të krijuar shërbime më efikase të pagesave elektronike.

**Parandalimi i pastrimit të parave / luftimi i financimit të terrorizmit (PPP/LFT)** duhet të përafrohet më tej me Direktivat e katërt dhe të pestë kundër pastrimit të parave. Regjimi i sanksioneve financiare të synuara duhet të forcohet më tej me legjislacionin e nevojshëm zbatues të detyrueshëm dhe përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë krijimin e një mekanizmi formal koordinues për kuadrin e sanksioneve dhe sanksionet për përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme është shpallur jokushtetues nga Gjykata Kushtetuese në qershor 2024. Qeveria ka miratuar projektligjin në shtator 2024, pasi e ka ndryshuar atë sipas rekomandimeve të Gjykatës Kushtetuese. Projektligji tani është në pritje të miratimit në Kuvend.

Shkëmbimi i informacionit dhe kapacitetet mbikëqyrëse janë përmirësuar në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përmes nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bankës Qendrore të Kosovës dhe Njësisë së Inteligjencës Financiare. Duke miratuar një Manual për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Banka Qendrore ka kaluar nga kuadri i mbikëqyrjes së bazuar në rregulla në kuadrin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, siç kërkohet nga standardet ndërkombëtare dhe TFVF. Nevojitet krijimi i mekanizmave për partneritete efektive publiko-private që synojnë trajtimin e përbashkët të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në vitin 2023, numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta në Kosovë arriti në 888, duke rënë për 6.2% krahasuar me vitin 2022. Në të njëjtën kohë, Kosova ende duhet të forcojë bashkëpunimin ndërinstytucional.

#### **Kapitulli 6 – E drejta e kompanive**

*BE ka rregulla të përbashkëta për formimin, regjistrimin dhe kërkesat për shpalesje të një kompanie, me rregulla plotësuuese për kontabilitetin dhe raportimin financiar, dhe auditimin ligjor.*

**Për ligjin për shoqëritë tregtare dhe qeverisjen e korporatave**, përgatitja e një ligji të ri për

shoqëritë tregtare po vazhdon prej disa vitesh. Ligji duhet të rregullojë fusha specifike të kërkuara nga legjislati i *acquis* i BE-së për shoqëritë tregtare, që ende mungojnë në legjislatin e Kosovës, siç janë kërkesa për kapital minimal, të drejtat e aksionarëve (duke përfshirë inkurajimin e angazhimit afatgjatë të aksionarëve), marrjen e kompanive dhe zbulimin e informacionit për kompanitë dhe degët e tyre. Ai gjithashtu duhet të përafrohet me Direktivën e BE-së për përdorimin e mjeteve digjitale dhe Direktivën e BE-së për operacionet ndërkufitare (bashkimet, ndarjet, konvertimet).

Bazuar në vlerësimet e ekspertëve të jashtëm, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës duhet të përmirësojë infrastrukturën e saj teknike (databazën) dhe të zbatojë plane konkrete për të mundësuar lidhjen me Sistemin e Interkoneksionit të Regjistrimit të Bizneseve (BRIS) deri në momentin e anëtarësimit. Koordinimi dhe shkëmbimi i pamjaftueshëm i të dhënave ndërmjet Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, duke ndikuar raportimin dhe publikimin me kohë të dokumenteve kontabël. Kërkesat e raportimit nuk përfshijnë publikimin e kompanive në situata të caktuara ligjore (p.sh. në procedurat e falimentimit) dhe ende nuk ka asnjë detyrim ligjor për të publikuar pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar publike dhe private në regjistrin e biznesit.

**Për raportimin e kompanisë**, Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim është vetëm pjesërisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së si dhe rregullat e fundit për raportimin nga vendi në vend dhe raportimin e qëndrueshmërisë së korporatës. **Auditimet ligjore** ndjekin standardet ndërkombëtare. Sa i përket raportimit, kompanitë e mëdha rrezikojnë sanksione ligjore nëse nuk respektojnë dhe dorëzojnë pasqyrat financiare të audituara në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar për miratim dhe publikim. Megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit në Këshill, ky vendim nuk zbatohet në praktikë. Kosova ende nuk ka siguruar fonde të mjaftueshme të qëndrueshme për Bordin Mbikëqyrës të Auditimit Publik të emëruar së fundmi, duke e penguar atë të ushtrijë funksionet e veta të mbikëqyrjes dhe zbatimit.

## Kapitulli 7 – E drejta e pronësisë intelektuale

*BE ka harmonizuar në një masë të madhe rregullat për mbrojtjen ligjore dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI), duke përfshirë veçanërisht patentat, markat tregtare dhe dizajnet, shpikjet bioteknologjike dhe farmaceutike, sekretet tregtare, treguesit gjeografikë (artizanale dhe industriale), certifikatat shtesë të mbrojtjes, të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.*

Kosova ka bërë progres të mirë në aspektin e përafërimit legjislativ. Kjo duhet të fillojë të garantojë njëfarë niveli të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale ekuivalente me atë të aplikuar në BE dhe në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA).

Në fushën e **të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta**, hyri në fuqi Ligji i ri për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta. Ai synon përafërimit të Kosovës me Direktivat e BE-së për menaxhimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe licencimin shumë-territorial të të drejtave në veprat muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm dhe për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në Tregun e Vetëm Digjital.

**Në lidhje me të drejtat e pronësisë industriale**, Agjencia për Pronësi Industriale e Kosovës ka nevojë për ristrukturim dhe staf shtesë. Kosova ka legjislatin në fuqi për topografitë e gjysmëpërçuesve, patentat, dizajnet, sekretet tregtare dhe markat tregtare. Në gusht 2023 është miratuar procedura për regjistrimin e markave tregtare. Agjencia ka krijuar një regjistër online në uebsajtin e saj për markat tregtare, patentat dhe dizajnin industrial. Kosova ka dështuar të miratojë një strategji për pronësinë industriale për periudhën 2022-2026, tani e planifikuar për 2024-2027.

Disa operacione në **zbatimin** e DPI-ve në Kosovë janë realizuar në vitin 2023. Megjithatë,

institucionet përgjegjëse, Këshilli Shtetëror i Pronësisë Intelektuale dhe Task Forca kundër Piraterisë kanë nevojë për më shumë kapacitete dhe mjete më të mira koordinuese (e-platformë) për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare dhe për të luftuar mallrat e falsifikuara dhe piraterinë. Procedurat e gjata dhe vendimet e marra pa asnjë pasojë janë një pengesë kryesore për zbatimin efektiv të legjislacionit për DPI. Në vitin 2023, Njësia e Doganës së Kosovës për DPI ka iniciuar 849 raste hetimore, duke sekuestruar 4 618 802 copë mallra false në vlerë totale prej 21 milionë euro, që paraqet një rritje substanciale në krahasim me vitin e kaluar.

Gjykata Komerciale e specializuar në çështjet komerciale dhe gjykata ka mandat të zgjidhë rastet dhe kontestet në fushën e të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të autorit, kanë dëshmuar se janë efikase në përpunimin e lëndëve.

Bashkëpunimi me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian nuk është zhvilluar ende duke kufizuar progresin e mundshëm dhe mbështetjen nga agjencia.

## Kapitulli 8 – Politikat e konkurrencës

*Rregullat e BE-së mbrojnë konkurrencën e lirë. Këto përfshijnë rregullat e antitrustit kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet kompanive dhe abuzimit me pozitën dominuese, si dhe përfshijnë rregulla për përqendrimet ndërmjet kompanive të cilat do të pengonin ndjeshëm konkurrencën efektive. Rregullat e BE-së përcaktojnë gjithashtu sistemin e kontrollit të ndihmës shtetërore. Qeveritë lejohen të japin ndihmë shtetërore vetëm nëse plotësohen kushtet kufizuese, me qëllim të parandalimit të prishjes së konkurrencës.*

### Antitrusti dhe bashkimet

**Korniza legjislative** për antitrust dhe bashkime është pjesërisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së dhe Kosova ka bërë progres gjatë periudhës raportuese duke miratuar legjislacionin zbatues në përputhje me *acquis*-në e BE-së.

Lidhur me **kornizën institucionale**, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) është përgjegjës për zbatimin e kornizës ligjore dhe Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK) vepron si organ vendimmarrës.

Sa u përket **kapaciteteve për zbatim në fushën e konkurrencës**, KKK është funksionalizuar sërish më 2023, pas emërimit të dy anëtarëve në pritje, në tetor. Lidhur me AKK, më 2024 është rekrutuar drejtori i ri i përgjithshëm, një zyrtar ligjor dhe pesë inspektorë të rinj të konkurrencës. Është zyrtarizuar bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet AKK-së dhe Komisionit të Pavarur për Media dhe ndërmjet AKK-së dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Sa i përket **zbatimit**, deri në prill të vitit 2024, AKK kishte nxjerrë 27 vendime për marrëveshje të ndaluara, pozita dominuese dhe bashkime në sektorë si media, transporti, prodhimet e qumështit, shërbimet mjekësore dhe telekomunikacioni. Janë dhënë dy opinione profesionale, njëri prej tyre për një çështje të profilit të lartë, aktualisht nën ankimim gjyqësor.

Është arritur pak progres në zbatimin e rregullave të konkurrencës duke shqiptuar gjoba apo mjete juridike pas vendimeve të marra nga AKK. Përkundër nga një rritjeje të lehtë, numri i rasteve mbetet i ulët dhe autoriteti nuk ka kryer asnjë bastisje në agim dhe nuk ka përdorur programin e masave lehtësuese deri më sot.

Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës për aspektet thelbësore të ligjit të konkurrencës ka vazhduar gjatë periudhës raportuese. Rritja e ndërgjegjësimit të gjyqtarëve për zbatimin e ligjit të konkurrencës mbetet thelbësore.

### Ndihma shtetërore

**Korniza legjislative** për ndihmën shtetërore është përgjithësisht e harmonizuar me *acquis*-në e BE-

së, pa progres në lidhje me ndryshimin e mëtejshëm të kornizës legislative gjatë periudhës raportuese. Projektligji për ndihmën shtetërore dhe legjislacioni tjetër i rëndësishëm zbatues për ndihmën horizontale, duke përfshirë përjashtimet në bllok dhe ndihmën rajonale, duhet ende të miratohen.

Sa i përket **kornizës institucionale**, Departamenti i Ndihmës Shtetërore i Ministrisë së Financave është përgjegjës për vlerësimin e propozimeve për ndihmë shtetërore, hartimin e raporteve të vlerësimit për Komisionin e Ndihmës Shtetërore dhe përditësimin e inventarit të ndihmës shtetërore. Gjatë periudhës raportuese nuk është bërë fare progres në adresimin e mandatit të skaduar të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe Qeveria nuk emëruar një komision të ri, duke e lënë pezull kontrollin e ndihmës shtetërore në tërësi.

Sa i përket **zbatimit**, në vitin 2023 Departamenti i Ndihmës Shtetërore ka nisur vlerësimin e dy masave të njoftuara të ndihmës shtetërore, por gjatë periudhës raportuese nuk ka mundur të miratohet **ndonjë vendim** pasi që Komisioni për Ndihmë Shtetërore nuk ka qenë funksional. Raportet vjetore për ndihmën shtetërore nuk i janë dorëzuar Kuvendit për të dytin vit radhazi.

### Liberalizimi

Ndërmarrjet publike i nënshtrohen Ligjit për Konkurrencën dhe Ligjit për Ndihmën Shtetërore. Kosova ka monopole të natyrës tregtare brenda kuptimit të nenit 37 të TFBE-së. Duhet të rritet ndërgjegjësimi për të zbatuar rregullat e ndihmës shtetërore për aktivitetet e institucioneve qendrore dhe ndërmarrjeve publike.

## Kapitulli 9 – Shërbimet financiare

*Rregullat e BE-së synojnë të sigurojnë konkurrencë të ndershme dhe stabilitetin e institucioneve financiare, përkatësisht bankave, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të letrave me vlerë. Ato përfshijnë rregulla për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve.*

Sa i përket **bankave dhe konglomerateve financiare**, puna duhet të vazhdojë për të përafuar me versionet më të fundit të Rregullores për Kërkesat Kapitale dhe Direktivën për Kërkesat Kapitale. Zbatimi i Rregullores për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit i ka mundësuar Kosovës të avancojë në përbushjen e kërkesave për kapital dhe menaxhim të rrezikut. Sektori financiar mbetet i qëndrueshëm me nivele të larta të kapitalizimit të sektorit bankar me pronësi të huaj. Ndonëse rreziku kreditor mbetet i përmbajtur, duhet t'i kushtohet fokus vlerësimit të rreziqeve nga zgjerimi i shpejtë i kredisë në segmentin e individëve, në veçanti kreditimi hipotekar.

Është arritur progres në lidhje me **çështjet e qeverisjes** së BQK-së duke plotësuar të gjitha pozicionet drejtuese, duke miratuar një plan strategjik pesëvjeçar, duke ristrukturuar strukturën organizative me një departament të ri për rimëkëmbjen dhe rezolucionin e bankave, i cili i raporton drejtpërdrejt Bordit Ekzekutiv të Bankës. Projektligji për bankat prezanton një kornizë rikuperimi dhe zgjidhjeje për institucionet kreditore dhe firmat e investimeve, duke synuar përafrimin me *acquis*-në e BE-së në këtë fushë. Ai gjithashtu parashikon vendosjen e funksioneve të departamentit, duke përfshirë pavarësinë funksionale të autoritetit të rikuperimit dhe rezolucionit. Ligji për garancinë e depozitave ende nuk është ndryshuar për ta përafuar më tej me Direktivën e Skemës së Garancive të Depozitave.

Lidhur me **Sigurimet dhe Pensionet Profesionale**, Kosova ka miratuar një rregullore që rregullon menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit për siguresit që synon ruajtjen e rezervave të mjaftueshme të likuiditetit për të përbushur detyrimet e siguresve. Procesi i liberalizimit të çmimeve për sigurimin e detyrueshëm të automjeteve nga palët e treta ende nuk ka filluar, ndërsa çmimet mbesin fikse, duke lënë të paadresuar opinionin e AKK-së për këtë çështje. Ngjashëm, modeli i ri i bazuar në rrezik për rregullimin e tarifave të sigurimit të makinave nuk është prezantuar.



Për shkak të çështjeve të statusit, Kosova mbetet jashtë sistemit të kartonit të gjelbër. Si rezultat, kërkohet sigurim për automjetet me targa të huaja që hyjnë në Kosovë dhe automjetet me targa të Kosovës që dalin nga Kosova që vazhdon të shkaktojë barrë financiare.

**Tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimeve** mbesin në fazë të hershme të zhvillimit, pasi që pjesa më e madhe e aktivitetit përqendrohet në tregun e bonove të Qeverisë, të cilat janë nxjerrë në ankand nga BQK. Nuk është bërë progres në drejtim të infrastrukturës së tregut financiar. Legjislati nuk është në përputhje me *acquis*-në e BE-së mbi përfundimin e shlyerjes, kolateralin financiar, transaksionet e financimit të letrave me vlerë, depozituesit qendrorë të letrave me vlerë dhe derivativët OTC, palët e tjera qendrore dhe depot tregtare (EMIR).

**Sa i përket financave digjitale dhe të qëndrueshme**, Kosova duhet të kryejë punë të mëtejshme për të përfshirë faktorë të qëndrueshmërisë si në politikat dhe objektivat strategjike bankare ashtu edhe ato jo-bankare, dhe për të zbatuar një kornizë rregullative financiare që mbështet investimet private drejt aktiviteteve të qëndrueshme/të gjelbra. Në vitin 2023, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) iu bashkua Rrjetit të Qëndrueshëm të Bankave dhe Financave (SBFN). Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë mund të garantojë deri në 80% të portofolit të kredive të institucioneve financiare për NMVM-të në fushat siç janë eficientia e energjisë dhe bujqësia e qëndrueshme. Fondi deri më tani ka lëshuar 374 milionë euro garanci dhe 718 milionë euro kredi të garantuara. Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për t'u përafuar me *acquis*-në e BE-së për financat digjitale.

## Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

*Rregullat e BE-së mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve po ashtu ofrojnë siguri të produkteve, parandalojnë imitime të rrezikshme dhe krijojnë përgjegjësi për produktet me defekt. BE garanton gjithashtu një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik dhe në veçanti siguron standarde të larta të përbashkëta për kontrollin e duhanit, gjakun, indet, qelizat dhe organet, si dhe ilaçet për përdorim njerëzor dhe veterinar. BE ka gjithashtu rregulla për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe në përgatitjen dhe reagimin ndaj kërcënimeve shëndetësore ndërkufitare, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse.*

### Mbrojtja e konsumatorit

Sa i përket **aspekteve horizontale**, korniza legjislative e Kosovës mbetet e përafuar pjesërisht me *acquis*-në e BE-së. Përaftrim i mëtejshëm me *acquis* më të fundit të BE-së është e nevojshme për të adresuar zhvillimet në këtë fushë. Zbatimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve dhe ndërgjegjësimi i sektorit privat mbesin të kufizuara, dhe një platformë e integruar për të harmonizuar procesin e ankesave të konsumatorëve ende nuk është krijuar. Ndërsa Ligji për **sigurinë** e përgjithshme **të produktit** është në përputhje me *acquis*-në e BE-së ende nuk është zbatuar plotësisht. Kapacitetet administrative në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe sigurisë së produktit duhet të rriten më tej (*shih gjithashtu Kapitullin 1 për mbikëqyrjen e tregut*). Për **çështjet jo të sigurisë**, dobësia e organizatave për të drejtat e konsumatorëve mbetet një sfidë.

### Shëndeti publik

Sa i përket **shëndetit publik**, cilësia e kujdesit shëndetësor mbetet shqetësuese. Edhe pse Kosova ka ndarë një rritje buxhetore për kujdesin shëndetësor prej rreth 14.2% në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, shpenzimet për shëndetësi si pjesë e BPV-së së përgjithshme mbesin të dytat më të ulëta në rajon dhe dukshëm më të ulëta se mesatarja e BE-së. Nuk ka blerje strategjike, duke rezultuar në joefikasitet të konsiderueshëm dhe rezultate të dobëta shëndetësore. Jetëgjatësia në lindje në Kosovë mbetet më e ulëta në rajon dhe shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve është më e larta në rajon. Shpenzimet nga xhepi mbesin shumë të larta (vlerësohet se variojnë ndërmjet 30% dhe 40%). Kosova ka sistem informativ ekzistues për **e-shëndetësi**, por nuk përdoret nga të gjitha institucionet shëndetësore; në vitin 2024 është miratuar një plan ambicioz veprimi për një sistem të integruar të

informimit për shëndetësi, për të përmirësuar disponueshmërinë e të dhënave dhe politikëbërjen e bazuar në prova.

Legjislacioni për **gjakun, indet, qelizat dhe organet** nuk është plotësisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së. Kosovës vazhdon t'i mungojnë resurset e nevojshme në këtë fushë. Zbatimi i ligjit aktual për **kontrollin e duhanit** duhet përmirësuar. Shërbimet e **shëndetit mendor** mbesin shërbime të integruara.

Sa i përket **sëmundjeve të rënda ngjitëse dhe kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin**, Kosova ka miratuar Ligjin për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse, në përputhje me rekomandimet e Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) dhe *acquis*-në e BE-së. Për këtë qëllim, Kosova ka zhvilluar një modul të mbikëqyrjes dhe monitorimit të ECDC.

Legjislacioni për **të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar** është përafër pjesërisht me *acquis*-në e BE-së. Kosova ka një program për **skrinimin e kancerit**, por skrinimi i kancerit nuk kryhet në mënyrë sistematike dhe nuk ka një regjistër funksional të kancerit. **Sëmundjet jo të transmetueshme** janë shkaku kryesor i vdekjeve.

Kosova nuk ka arritur ndonjë progres në **ushqyeshmërinë dhe aktivitetin fizik**. Nuk pati përparim në përafrimin në **produktet medicinale për përdorim njerëzor** ose në **produktet medicinale për përdorim veterinar**, ose në **pajisjet mjekësore**, të cilat të gjitha mbesin pjesërisht të përafëruara me *acquis*-në e BE-së. Legjislacioni për recetat dhe shitjet e antibiotikëve duhet të zbatohet në mënyrë që të ndalet praktika e zakonshme e shitjeve pa recetë në farmaci. Lista e barnave thelbësore është përditësuar. Pas thirrjes për interesim për t'iu bashkuar Aleancës së Medikamenteve Kritike, tani po merr pjesë një subjekt nga Kosova.

**Pabarazitë shëndetësore** mbesin shqetësim serioz. Mungesa e rregullimeve të duhura të financimit shëndetësor ka penguar progresin drejt mbulimit universal shëndetësor dhe ka kontribuar në pagesat e vazhdueshme të larta nga xhepi. Barra financiare ka qenë veçanërisht e rëndë për segmentet e cenueshme dhe të varfra të shoqërisë së Kosovës, duke përfshirë njerëzit me sëmundje kronike të cilët kanë nevojë për mjekime në baza të rregullta.

Sa i përket luftës kundër korrupsionit, Ministria e Shëndetësisë, me mbështetjen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe USAID-it, ka miratuar një plan për integritetin institucional me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës institucionale.

### GRUPIMI TEMATIK 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE

Ky grupim tematik mbulon transformimin digjital dhe mediat (Kapitullin 10); tatimet (Kapitullin 16); politikat ekonomike dhe ato monetare (Kapitullin 17); politikat sociale dhe punësimin (Kapitullin 19); politikat e industrisë (Kapitullin 20), shkencën dhe kërkimet shkencore (Kapitullin 25); arsimin dhe kulturën (Kapitullin 26); dhe Unionin Doganor (Kapitullin 29).

#### Kapitulli 10 – Transformimi digjital dhe mediat

*BE mbështet funksionimin pa probleme të tregut të brendshëm për komunikimet elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audiovizuale. Rregullat mbrojnë konsumatorët dhe mbështesin disponueshmërinë Kapaciteti i universale të shërbimeve moderne.*

Në fushën e **komunikimeve elektronike**, 98.6% e familjeve kishin qasje në internet në vitin 2023 (krahasuar me 97.9% në 2021). Në vitin 2023, Kosova arriti 100% mbulim me brez të gjerë. Në qershor 2024, Kosova ka nënshkruar Marrëveshje Asociimi me Komisionin Evropian për t'iu bërë pjese e Programit Evropa Digjitale, të financuar nga BE, i cili synon të rrisë qasjen në digjitalizim për njerëzit, bizneset dhe institucionet.

Sfidat mbesin në zhvillimin e infrastrukturës së brezit të gjerë me shpejtësi të lartë, duke përfshirë

kapacitetet e kufizuara të investimeve të sektorit privat, një rrjet kabllor të vjetruar dhe vonesat në zhvillimin e 5G. Ndërsa korniza legjislative për reduktimin e kostos së brezit të gjerë është në përputhje me *acquis*-në e BE-së, ngarkesat administrative lidhur me punimet e ndërtimit vazhdojnë për shkak të mos harmonizimit të plotë të legjislacionit të trashëguar. Kosova duhet të harmonizohet me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, të finalizojë Ligjin e ri për Komunikimet Elektronike dhe të përafrohet me Aktin e BE-së për Infrastrukturën Gigabit (duke rishikuar Direktivën për uljen e kostos së brezit të gjerë), kutinë e mjeteve të lidhjes së BE-së dhe Udhëzimet e rishikuara për ndihmën shtetërore për zhvillimin e rrjeteve të brezit të gjerë.

Rregulloret për të thjeshtuar instalimet e rrjetit 5G janë ende në pritje. Burimet e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare mbesin të kufizuara në mënyrë joproportionale. Përafrimi me Aktet e Shërbimeve Digjitale dhe Aktin e Tregjeve Digjitale duhet të rritet për të ofruar parashikueshmëri për biznesin dhe për të akomoduar pjesën gjithnjë e më të madhe të eksporteve të TIK-ut në ekonominë e Kosovës.

Kosova ka arritur njëfarë progresi sa i përket **shërbimeve digjitale**. Është miratuar Strategjia për e- Qeverisje për periudhën 2023-2027. Megjithatë, numri i shërbimeve mbetet i ulët, pasi që vetëm 10% e shërbimeve publike janë të disponueshme online. Kosova duhet të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis*-në e BE-së për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. Kosova gjithashtu duhet të përafrojë legjislacionin e saj me Kornizën Evropiane të Ndërveprueshmërisë dhe Aktin e Evropës Ndërvepruese.

Autoritetet duhet të sigurojnë dhe lehtësojnë qasjen e barabartë në shërbimet online për të gjithë dhe të përshpejtojnë veprimet për të harmonizuar kornizën ligjore me Aktin e Shërbimeve Digjitale (DSA) dhe Aktin e Tregjeve Digjitale (DMA).

Lidhur me **besimin digjital dhe sigurinë kibernetike**, Kosova ka forcuar kornizën ligjore dhe strategjike për sigurinë kibernetike. Ligji për sigurinë kibernetike është pjesërisht në përputhje me Direktivën NIS dhe Kosova duhet të shtojë përpjekjet për t'u përafruar me Direktivën NIS2. Qeveria ka miratuar Strategjinë e re për Siguri Kibernetike për periudhën 2023-2027 dhe planin e saj të veprimit. Autoritetet duhet të zhvillojnë politika për një internet më të sigurt për fëmijët, duke përfshirë masa efektive për zbulimin dhe reagimin ndaj abuzimit seksual të fëmijëve në internet. Përveç progresit të bërë deri më tani në përafrimin me Rregulloren eIDAS, Kosova duhet të përafrohet me Kornizën e re të Identitetit Digjital të BE-së dhe të krijojë një portofol kombëtar të identitetit digjital. Vendosija e eID-së kombëtare të Qeverisë po përparon.

Sa i përket **medias**, Kuvendi ka miratuar Ligjin e shumëpritur për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) në korrik 2024. Ky ligj ka shkaktuar shqetësime mbi lirinë e mediave, veçanërisht për rregullimin e mediave online. KPM ka nevojë për burime shtesë njerëzore dhe financiare për të ushtruar në mënyrë efektive kompetencat e tij.

## Kapitulli 16 – Tatimet

*Rregullat e BE-së për tatimin mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar, akcizat dhe aspektet e tatimit të korporatave. Ato gjithashtu mbulojnë bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për të parandaluar evazionin fiskal.*

Kosova ka vazhduar të demonstrojë performancë të mirë në **mbledhjen, zbatimin dhe pajtueshmërinë e taksave**. Në periudhën prill 2023 dhe shtator 2024, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka mbledhur të hyra në vlerë prej 1.28 milionë euro, 14.1%, që janë më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë. Gjatë periudhës raportuese, ATK ka kryer 2 939 vizita të pajtueshmërisë, auditime dhe hetime të rasteve të dyshuara të evazionit fiskal. Këto aktivitete rezultuan me të hyra shtesë prej 112,7 milionë euro. Në fushën e menaxhimit të borxhit, ATK ndjek praktikën më të mira ndërkombëtare.



Kosova ka miratuar Ligjin për administratën tatimore dhe procedurat, por nuk është bërë përparim në rishikimin e politikës tatimore. Vlerësimi i hendekut tatimor ende duhet të finalizohet për të gjitha vitet e deritanishme dhe të kryhet rregullisht.

Sa i përket **bashkëpunimi administrativ dhe ndihmës së ndërsjellë**, për shkak të çështjeve të statusit, Kosova nuk ka qenë në gjendje t'i bashkohet kornizës gjithëpërfshirëse të Bazës së Erozionit dhe Zhvendosjes së Fitimit të OBEZH dhe Konventës së Këshillit të Evropës për ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet tatimore. ATK ka bërë progres në lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe për tatimin e dyfishtë, me gjithsej 22 marrëveshje deri më sot. Kosova ka finalizuar strategjinë e re për luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar (2023-2026), por miratimi i saj nga Qeveria është ende në pritje. Nga prilli 2023 deri në gusht 2024 ATK ka kryer 1,173 aktivitete që kanë shënjestruar punën e padeklaruar. Gjatë kësaj kohe janë inspektuar 51 biznese, në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës, në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta për të luftuar punën e padeklaruar. Sa u përket kallëzimeve penale, janë dorëzuar 55 sosh.

Sa u përket **kapaciteteve operacionale dhe digjitalizimit**, ATK ka vazhduar të bëjë progres në digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve, veçanërisht në rritjen e luftës kundër punësimit joformal dhe mosdeklarimit të tatimeve. ATK duhet të forcojë më tej kapacitetet profesionale dhe të përmirësojë efektivitetin e funksioneve të kontrollit tatimor. ATK ka intensifikuar veprimet e saj lidhur me përputhshmërinë tatimore sipas qasjes së bazuar në rrezik.

ATK rriti kapacitetin e saj analitik duke përditësuar të gjithë parametrat e moduleve të analizës së rrezikut, duke rezultuar në një rritje të konsiderueshme të auditimeve të bazuara në rrezik (mbi 80% e të gjitha kontrolleve tatimore). Që nga korriku 2024, ATK ka filluar aktivitetet në lidhje me kontrollet e pajtueshmërisë tatimore për individët me pasuri të lartë, me fokus në mbledhjen e informacionit. Infrastruktura e TI-së e ATK-së mbetet e vjetruar.

## Kapitulli 17 – Politikat ekonomike dhe ato monetare

*Rregullat e BE-së kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore dhe i ndalojnë ato të financojnë drejtpërdrejt sektorin publik. Shtetet anëtare koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes fiskale, ekonomike dhe financiare.*

Politika fiskale mbetet instrumenti kryesor i politikës makroekonomike, pasi Kosovës i mungon një **politikë monetare** e pavarur dhe nuk ka në dispozicion mjete standarde të politikës monetare. Përdorimi i euros nga Kosova si mjet ligjor është plotësisht i ndryshëm nga anëtarësimi në eurozonë.

Ka pasur progres të mirë në përmirësimin e strukturës së qeverisjes korporative të BQK-së. Pas emërimit të guvernatorit të ri nga Kuvendi në korrik 2023, është emëruar menjëherë një ushtrues detyre i zëvendësguvernatorit. Në nëntor 2023 është miratuar struktura e re organizative e Bankës Qendrore dhe në janar 2024 është emëruar dy zëvendësguvernatorë, duke kompletuar Bordin Ekzekutiv. Plani i ri strategjik i BQK-së për 2024-2028 është publikuar në fund të vitit 2023.

**Sa i përket politikës ekonomike**, megjithëse rregullat fiskale janë të mirëpërcaktuara në legjislacion, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të siguruar përputhshmërinë e tyre të plotë, ndërkohë që ka nevojë që Kosova të përafrohet më tej me kërkesat e Direktivës së BE-së për kornizat buxhetore.

Në periudhën raportuese, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ndërmori iniciativa për përmirësimin e kapaciteteve modeluese makrofiskale dhe parashikuese të stafit kompetent, ndërkohë që janë ndërmarrë disa hapa për të lidhur më mirë procesin vjetor buxhetor me politikën afatmesme. Megjithatë, nevojitet vullnet i fortë politik dhe bashkëpunim ndërinstucional për të transformuar buxhetin në një mjet për planifikimin e politikave dhe për të forcuar kornizën buxhetore afatmesme.

Ndonëse Kosova ka bërë përmirësime sa u përket afateve kohore dhe plotësisë së të dhënave të

llogarive kombëtare, duhet të vazhdojnë përpjekjet drejt një tërësie të plotë të llogarive kombëtare vjetore dhe tremujore. *(Shih edhe Kapitullin 18)*

**Programi i Reformës Ekonomike (PRE) 2024-2026** është dorëzuar më kohë. Ekziston një shkallë e konsiderueshme e pasigurisë rreth kornizës makroekonomike dhe fiskal. PRE parashikon një përshejtim të fuqishëm të aktivitetit ekonomik në 2024-2025 përpara se të lehtësohet në vitin 2026, kryesisht si rezultat i një rritjeje të fortë të investimeve. Megjithatë, kjo perspektivë përballet me rreziqe të mëdha negative që lidhen me dobësitë në menaxhimin e investimeve publike, rritje më pak dinamike në partnerët kryesorë tregtarë, rritje të çmimeve të mallrave, kushte më të shtrënguara financimi dhe flukse financiare më të ulëta se sa pritej nga diaspora. Udhëzimet e politikave të përcaktuara në konkluzionet e Dialogut Ekonomik e Financiar të majit 2023 janë zbatuar pjesërisht.

## Kapitulli 19 – Politikat sociale dhe punësimi

*Rregullat BE-së në fushën sociale përfshijnë standardet minimale për ligjin e punës, barazinë, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mosdiskriminimin. Ato gjithashtu promovojnë përfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale dhe dialogun social në nivel evropian.*

Kosova ende duhet të miratojë ndryshimet në legjislacionin e **punës dhe shëndetit dhe sigurisë në punë**, dhe të harmonizojë më tej me *acquis*-në e BE-së, duke përfshirë edhe Direktivën e BE-së për balancën e jetës dhe punës. Qeveria ka ndarë fonde për kompensimin e nënave të reja në pushim të lehonisë dhe ka hartuar një strategji për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Ligji për sigurimet shëndetësore i vitit 2014 nuk është zbatuar. Inspektorati i Punës ka zgjeruar kapacitetet dhe ka intensifikuar inspektimet në sektorët me rrezikshmëri të lartë, duke shënuar rënie të aksidenteve me fatalitet. Inspektorati i Administratës Tatimore dhe Inspektorati i Punës vazhduan veprimet për të luftuar ekonominë joformale, ndërsa ndryshimet në Ligjin për administratën tatimore kanë ndihmuar në formalizimin e 5 000 vendeve të punës në muajt e parë të vitit 2024. Masat e Qeverisë në mbështetje të punëdhënësve kanë kontribuar në rënien e shkallës së papunësisë gjatë dy viteve të fundit.

**Dialogu social** mbetet i kufizuar. Ngritja e kapaciteteve të partnerëve socialë, veçanërisht në sektorin privat, duhet të rritet. Mandati i Këshillit Ekonomik Social ka përfunduar më 2023. Këshilli i ri nuk është emëruar. Kosova më në fund ka në fuqi Ligjin e ri për pagën minimale, i cili e rrit pagën minimale nga 170 euro në 264 euro, rritja e parë që nga viti 2011.

Sa u përket **politikave të punësimit**, Kosova ka miratuar dhe publikuar strategjinë e re të punësimit dhe tregut të punës për 2024-2028 dhe ka hartuar një rregullore të re për masat aktive të tregut të punës dhe një ligj të ri për punësimin. Norma e përgjithshme e aktivitetit ishte 42.3% në TM4 2023, një rritje e lehtë krahasuar me 38.6% në vitin 2022.

Lidhur me **pjesëmarrjen në fuqinë punëtore dhe shkallën e papunësisë shih aneksin statistikor dhe seksionin mbi funksionimin e tregut të punës në pikën 2.3. Kriteret ekonomike.**

Pas miratimit të planit të zbatimit të Garancisë për Rininë, Kosova ka filluar pilotimin e Skemës së Garancisë Rinore në dy komuna në janar 2024 dhe paraqiti një raport monitorimi në korrik 2024.


Qeveria ka finalizuar planin e ristrukturimit të **Agjencisë së Punësimit** dhe rregullorja e re është paraparë të miratohet këtë vit. Sistemi i informacionit të tregut të punës për të mbështetur hartimin e politikave dhe planifikimin e bazuar në fakte është i vjetruar dhe i mungon kapaciteti operacional në fushat kritike.

Nuk pati zhvillime në përgatitjen e **Fondit Social Evropian** *(shih Kapitullin 22 – Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore)*. Sa i përket **përfshirjes dhe mbrojtjes sociale**, një qasje e re e bazuar në testimin e mjeteve të përafërta që synon shënjestrimin më të mirë të varfërisë po pilotohet në mbarë Kosovën që nga maji 2024.

Aktualisht, nuk ka bazë ligjore për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve sociale. Rritja për 50% e fondeve të Qeverisë dedikuar OJQ-ve të licencuara që ofrojnë shërbime sociale në vitin 2023 nuk i plotëson nevojat. E kombinuar me mungesën e fondeve të qëndrueshme shumëvjeçare dhe pagat e ulëta për punonjësit socialë, kjo kufizon kapacitetet e OJQ-ve dhe qendrave të punonjësve socialë. Kapaciteti i komunave në lidhje me planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, mbledhjen e të dhënave dhe kujdesin e integruar është i dobët. Rreth 9% e fëmijëve janë të përfshirë në punë, prej të cilëve 5.6% punojnë në kushte të rrezikshme, çështje kjo që është veçanërisht e dukshme në mesin e komunitetit rom dhe ashkali.

Janë të kufizuara përpjekjet për të adresuar **diskriminimin ndaj grave në punësim dhe politika sociale**, veçanërisht gjatë

procedurave të punësimin, avancimit dhe pagesës. Ka boshllëqe në zbatimin e legjislacionit për mundësi të barabarta. Mungesa e objekteve për kujdesin ndaj fëmijëve dhe të të moshuarve, pjesëmarrja e pabarabartë e përgjegjësive në pushimet e lehonisë, atësisë dhe prindërimit pengojnë punësimin e grave. Ndërprerja e periudhës provuese për shkak të shtatzënisë nuk trajtohet si diskriminim i drejtpërdrejtë. Inspektorëve të punës dhe gjyqtarëve u mungojnë njohuritë për të trajtuar më mirë çështjen e diskriminimit me bazë gjinore.



Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të siguruar qasje të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në institucione, shërbime cilësore, punësim dhe arsim. Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme njih të drejtën për kompensim material vetëm për një kategori të përcaktuar ngushtë të fëmijëve që kanë aftësi të kufizuara të përhershme dhe të rënda dhe përjashton fëmijët me aftësi të kufizuara më të lehta, kushtet e të cilëve mund të përmirësoheshin potencialisht nëse do të ofrohej mbështetje me përfitime në para dhe shërbime mjekësore dhe sociale.

## Kapitulli 20 – Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

*Politika industriale e Be-së forcon konkurrencën, lehtëson ndryshimin strukturor dhe inkurajon një mjedis të përshtatshëm ndaj bizneseve që stimulon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të).*

Sa i përket **politikës së sipërmarrjes dhe asaj industriale**, strategjia për zhvillimin industrial dhe mbështetjen e biznesit, e miratuar në qershor 2023, është ambicioze, duke synuar përmirësimin e mjedisit të biznesit, promovimin e zhvillimit industrial, adresimin e deficitit tregtar, krijimin e vendeve të punës dhe sigurimin e efikasitetit të burimeve dhe një ekonomi më qarkore. Megjithatë, raporti i parë i monitorimit të strategjisë ka treguar se aktivitetet e planifikuara janë zbatuar vetëm pjesërisht. Kosova duhet të dedikojë burime shtesë dhe të mbyllë boshllëqet financiare për zbatimin e suksesshëm të saj. Më 2023 janë publikuar katër studime gjithëpërfshirëse të nënsektorëve kryesorë në sektorin e prodhimit, të cilat Qeveria planifikon t'i përdorë për të përmirësuar politikat dhe veprimet e saj.

Në lidhje me **instrumentet e politikës**, Ligji për investime të qëndrueshme, i miratuar nga Kuvendi në vitin 2023, krijon dy agjenci të reja: Agjencinë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe Agjencinë për Investime dhe Eksport në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Të dy agjencitë do të luajnë një rol të rëndësishëm në asistimin e kompanive dhe tërheqjen e IHD-ve, duke adresuar rekomandimin afatgjatë për ristrukturimin e Agjencisë Kosovare të Investimeve dhe Mbështetjes së Eksportit (KIESA). Gjykata Kushtetuese vendosi se Ligji për investime të qëndrueshme nuk cenon Kushtetutën, duke hapur rrugë krijimit të agjencive. Qeveria gjithashtu ka ndërmarrë hapa drejt përmirësimit të dialogut me sektorin privat duke lansuar një platformë formale për dialogun publik-privat.

KIESA ka vazhduar organizimin e panairëve të biznesit, duke lehtësuar pjesëmarrjen e bizneseve kosovare në panairët ndërkombëtare tregtare dhe menaxhimin e granteve në mbështetje të zbatimit të strategjisë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit 2030. Rreth 3 milionë euro grante janë ndarë për bizneset nga komunitetet joshumicë. Agjencia ende kishte vështirësi në përmbushjen e objektivave të saj, në veçanti për të mundësuar zbatimin e shërbimeve dhe programeve para dhe pas kujdesit dhe promovimin e lidhjeve ndërmjet ndërmarrjeve shumëkombëshe dhe NVM-ve.

Institucionet e dobëta dhe mungesa e përgjigjeve në kohë dhe profesionale ndaj kërkesave legjitime nga bizneset mbeten një sfidë e madhe. Kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme, procedurat e zgjatura administrative dhe mungesa e koordinimit ndërministror përjetësojnë mungesën e një sistemi funksional të dosjeve/memories institucionale brenda autoriteteve të Kosovës. Rrjedha e fragmentuar dhe joefikase e informacionit ndërmjet institucioneve mbetet problem. Kjo paraqet pengesa për NVM-të për të hyrë në shërbimet mbështetëse të biznesit dhe për të marrë leje dhe licenca. Kërkesat e tepërta të dokumenteve kur aplikoni për mbështetje nga Qeveria e zgjasin kohën e aplikimit.

Pati zhvillime të dukshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjykata Komerciale arriti listën e saj të synuar prej 18 gjyqtarësh të emëruar. Me funksionalizimin e saj, gjithsej 6 754 lëndë janë zhvendosur në dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerciale, ndërsa 1 342 lëndë janë transferuar në dhomën e shkallës së dytë. Gjatë periudhës raportuese, gjykata tregtare ka zgjidhur 6 945 lëndë në shkallën e parë dhe 1 702 në shkallën e dytë. Shërbimet gjyqësore kanë marrë një vlerësim përgjithësisht pozitiv nga përdoruesit, por ka vend për përmirësim në efikasitetin e procedimeve pasi, me rritjen e numrit të lëndëve, është sfiduese për gjykatën që të përfundojë lëndët brenda një afati të arsyeshëm. 30 lëndë janë transferuar në ndërmjetësim nga Gjykata Komerciale në vitin 2023. Asnjë lëndë e re nuk është transferuar në vitin 2024. Ndërmjetësimi në internet i prezantuar si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19 mbeti një mjet praktik për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Kosova ka vazhduar të zgjerojë shërbimet e disponueshme në platformën e saj të e-qeverisjes. Të e vetëpunësuarit përballen me barrë të ulët tatimore dhe NVM-të e inkorporuara përfitojnë nga stimujt e tatimit mbi të ardhurat e korporatave. Thjeshtimi dhe digjitalizimi i shërbimeve ka ulur koston e pajtueshmërisë tatimore për NVM-të.

Qasja në financa mbetet një pengesë për rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) përkundër zgjerimit dhe diversifikimit të portofolit të Fondit Kosovar të Garancive Kreditore. Deri në shtator 2024, fondi ishte zgjeruar duke mundësuar kredi me vlerë 731.8 milionë euro për NMVM-të në sektorët e prodhimit, bujqësisë së shërbimeve dhe tregtisë, duke përfshirë firmat fillestare dhe bizneset në pronësi të grave. Qeveria duhet të vazhdojë përpjekjet për të diversifikuar burimet e financimit.

Kosova merr pjesë në Shtyllën e NVM-ve të Programit të Tregut të Vetëm.

Kosova është zotuar që të harmonizojë legjislacionin përkatës primar dhe sekondar me Direktivën e BE-së për pagesat e vonuara në transaksionet tregtare deri në qershor 2025.

## **Kapitulli 25 – Shkenca dhe kërkimet shkencore**

*BE ofron mbështetje të konsiderueshme për kërkimin dhe inovacionin. Të gjitha shtetet anëtare mund të marrin pjesë në programet e kërkimit dhe inovacionit të BE-së dhe të përfitojnë prej tyre, veçanërisht kur ka ekselencë shkencore dhe investime solide në kërkimin dhe inovacionin.*

Dokumenti kryesor i politikave për **kërkimin dhe inovacionin**, përveç PRE-së 2023-2025, është Programi Kombëtar i Shkencës për periudhën 2023-2028, i miratuar nga Qeveria në korrik 2023. Programi kërkon një rritje të konsiderueshme të fondeve publike në sektorin e kërkimeve shkencore, që mbetet pamjaftueshëm i financuar në masë të konsiderueshme si pjesë e fondeve të ndara nga buxheti i Qeverisë për kërkime dhe zhvillim.

Financimi i kërkimit shkencor nuk është identifikuar qartë; është pjesë e një buxheti të përgjithshëm për institucionet e arsimit të lartë, i cili financon kërkimin shkencor dhe inovacionin, si dhe universitetet. Cilësia e programeve të përgatitjes së studentëve pasuniversitar në karrierë kërkimore mbetet e pakënaqshme. Financimi i masave mbështetëse të inovacionit është i nevojshëm urgjentisht. Kosova inkurajohet të shfrytëzojë mundësitë e vëna në dispozicion nga Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjisë. Sistemi i informacionit të kërkimit ofron të dhëna në lidhje me iniciativat kërkimore të BE-së si Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST).

Sa i përket **Horizon Europe**, Kosova ka ulur në mënyrë dramatike performancën e saj gjatë periudhës raportuese, (një rënie prej rreth 75%), me tre projekte me një financim total prej 237 125 euro në vitin 2023.

Megjithëse nuk ka një plan të qartë për miratimin e një strategjie gjinore, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit vazhdon të mbështesë studentët femra që dëshirojnë të studiojnë shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë me një program bursash.

## **Kapitulli 26 – Arsimi dhe kultura**

*BE mbështet bashkëpunimin në arsim dhe kulturë përmes programeve të financimit dhe koordinimit të politikave të shteteve anëtare përmes metodës së hapur të koordinimit. BE dhe shtetet anëtare duhet gjithashtu të parandalojnë diskriminimin dhe të sigurojnë arsim cilësor për fëmijët e punëtorëve migrantë, duke përfshirë ata me prejardhje të pafavorshme.*

**Shpenzimet publike** të Kosovës për arsimin në vitin 2023 ishte parashikuar të ishte 385 milionë euro. Vlerësimet e përkohshme tregojnë se pjesa e ndarjes buxhetore për sektorin e arsimit në vitin 2023 ra si përqindje e BPV-së (3%, ndërsa ishte 4.1% në vitin 2022).

Sa i përket **regjistrimit dhe frekuentimit të nxënësve dhe popullsisë studentore**, një trend i përgjithshëm rënës në shkallën bruto të regjistrimit është regjistruar në nivelet e mëparshme të arsimit (parashkollor, parafillor dhe fillor), ndërsa trendi është lehtësisht në rritje në arsimin e mesëm të ulët.

Në fushën e **edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme** është arritur njëfarë progresi me zhvillimin e legjislacionit për zbatimin e Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe pilotimi i kurrikulave të reja për vitin akademik 2023/2024.

Edhe pse Kosova po bën disa përpjekje për të përmirësuar **cilësinë e arsimit**, ka ende pak përparim në zbatimin e strategjisë së arsimit të Kosovës për periudhën 2022-2026. Progresi nuk është ende i dukshëm në aspektin e performancës së studentëve pasi ndikimi i hapave të ndërmarrë do të jetë i dukshëm vetëm afatgjatë. Siç është raportuar nga OBEZH në dhjetor 2023, rezultatet mesatare të testeve të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) të marra në vitin 2022 tregojnë një rënie të performancës së nxënësve kosovarë në matematikë, lexim dhe shkencë, krahasuar me rezultatet mesatare të vitit 2018. Rezultatet e PISA-s dhe një përqindje e lartë e nxënësve 15-vjeçar që nuk arrijnë të demonstrojnë aftësi bazë (niveli 2) në lexim (83%), në matematikë (85%) dhe në shkencë (79%). Studimi i fundit ndërkombëtar i progresit në shkrim-lexim (PIRLS 2021) tregon se performanca e Kosovës në lexim është dukshëm nën mesataren

ndërkombëtare.

Kosova ka bërë përparim të mirë sa i përket njohjes së mësimi paraprak. Shërbimi i vlefshmërisë së të mësuarit joformal dhe joformal është funksionalizuar dhe tani po u ofrohet qytetarëve, përfshirë shërbimet publike të punësimit. Digjitalizimi dhe shkathtësitë digjitale përbëjnë një element thelbësor të strategjisë arsimore 2022-2025.

Reformat e rekrutimit të stafit në sektorin e arsimit kanë ecur me miratimin e një akti zbatues për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimeve në arsimin parauniversitar. Kjo reformë është veçanërisht e rëndësishme për përmirësimin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënësve. Vlerësohet se vetëm 3% e mësimdhënësve i janë nënshtruar vlerësimit formal të performancës gjatë dekadës së fundit. Në vitin 2023 janë miratuar dy udhëzime administrative lidhur me vlerësimin dhe licencimin e mësimdhënësve. Aktualisht janë rreth 21 inspektorë arsimor me ekspertizë në vlerësimin pedagogjik, i cili është i pamjaftueshëm për të kryer vlerësimin e performancës së mbi 23 000 mësimdhënësve, përveç roleve dhe përgjegjësive të tjera. Ky është një faktor kyç që kontribuon në vonesat në zbatimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, duke minuar rrjedhimisht zbatimin efektiv të politikave/reformave të tjera.

**Projektligji për tekstet shkollore**, e paraqitur në vitin 2022, është ende në pritje të miratimit përfundimtar në Kuvend. Përmirësimet teknike të projektligjit janë ende të nevojshme për të përmbushur standardet e cilësisë dhe për të siguruar zbatimin efektiv.

Arsimi dual në **AAP** është zgjeruar me pilotimin e tetë profileve shtesë në vitin akademik 2023/2024. Një total prej 12 profilesh të arsimit të dyfishtë po aplikohen tani për të përmirësuar punësueshmërinë e djemve dhe vajzave të reja. Në tetor 2023, Kryeministri ka filluar një fushatë ndërgjegjësuere për të mbështetur zbatimin e AAP-së së dyfishtë në Kosovë. Ende duhet të finalizohet një koncept dokument për një ligj të ri të AAP-së.

Sa i përket **përfshirjes**, përkundër disa përmirësimeve, fëmijët nga grupet e cenueshme dhe minoritetet vazhdojnë të jenë të marginalizuar kur bëhet fjalë për mundësitë për arsimim. Në veçanti, fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë në rrezik më të lartë të braktisjes së arsimit të detyrueshëm. Qendrat mësimore nuk janë ende të institucionalizuara. Për më tepër, janë mbyllur disa qendra që mbështeten në mbështetje të jashtme financiare dhe ofrojnë mbështetje shtesë arsimore dhe psikosociale për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacion (MASHTI), në koordinim me drejtoritë komunale të arsimit, duhet të sigurojë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të mbështetur këto qendra. Përpjekje shtesë duhet të bëhen gjithashtu për të përmirësuar qasjen në hapësirat publike dhe transportin për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me dëmtime fizike.

Pas regjistrimit të vitit 2024, të dhënat për fëmijët në shkolla duhet të përdoren nga MESTI për të racionalizuar rrjetin e shkollave dhe për të adresuar nevojën për riorganizimin e shkollave të mbipopulluara si dhe shkollave të papopulluara në zonat rurale.

Kosova përfiton nga dimensionin ndërkombëtar in programit **Erasmus+** 2021-2027. Në vitin 2023, Kosova ka regjistruar numrin më të madh të studentëve dhe stafit në mobilitetin e jashtëm (duke shkuar në BE) dhe numrin më të madh të projekteve në arsimin e lartë krahasuar me vitet e mëparshme. Në ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë, viti 2023 ka shënuar numrin më të madh të projekteve të suksesshme: Gjithsej 13 projekte me 27 institucione të arsimit të lartë si përfitues dhe pesë institucione të arsimit të lartë të Kosovës si koordinatorë të projekteve. Kosova nuk po merr pjesë në grupet punuese të Zonës Evropiane të Arsimit (Procesi i Bolonjës) 2021-2025. Si pjesë e partneritetit të zgjeruar me rajonin, Kosova mund të aplikojë në thirrjet e Iniciativës për Universitetet Evropiane, por asnjë universitet kosovar nuk është përzgjedhur si partnerë në aleancat e financuara deri më tani.

Sa i përket **sportit**, Kosova ka vazhduar pjesëmarrjen në Javën Evropiane të Sportit.



Kosova ende duhet të zhvillojë një strategji për **kulturë**. Është miratuar Ligji për artin dhe kulturën, i cili përcakton parimet e përgjithshme të politikave kulturore dhe rregullon kushtet për zbatimin e tyre. Ai rregullon fushën e artit dhe kulturës dhe përcakton rregullat bazë për themelimin, organizimin, financimin, administrimin dhe funksionimin e institucioneve publike të artit dhe kulturës. Kosova nuk mund të marrë pjesë në programin MEDIA të programit Evropa Kreative derisa Kosova të harmonizojë Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale.

## Kapitulli 29 – Unioni Doganor

*Të gjithë shtetet anëtare janë pjesë e unionit doganor të BE-së dhe ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Kjo kërkon përafrim legjislativ, si dhe kapacitet adekuat zbatues dhe fuqizues dhe qasje dhe ndërveprueshmëri me mjedisin elektronik doganor të BE-së.*

Në fushën e **legjislacionit doganor**, Kodi Doganor dhe i Akcizave, i harmonizuar me Kodin Doganor të Bashkimit Evropian, është miratuar në mars 2024; Kosova duhet të vazhdojë me hartimin dhe miratimin e legjislacionit përkatës zbatues. Për shkak të çështjeve të shtetësisë, nuk është arritur progres në aplikimin e Kosovës për t'u bërë vëzhguese sipas Konventës të Transitit të Përbashkët. Sa i përket rregullave të origjinës, Kosova vazhdon të zbatojë Konventën Pan-Euro Mesdhetare. Dogana e Kosovës shkëmben sistematikisht të dhëna për lëvizjen ndërkufitare të mallrave ndërmjet ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Legjislacioni për masat doganore që rregullon të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI) dhe kontrollet e eksportit për mallrat kulturore është në përputhje me *acquis-në e BE-së*.

Dogana e Kosovës ka vazhduar të shënojë progres të mirë në **lehtësimin e tregtisë**. Është rritur numri i operatorëve ekonomikë të autorizuar nga 10 në 13.

Rritje 55% ka pasur edhe në dërgesat e importuara nëpërmjet Portit të Durrësit, Shqipëri, duke rezultuar në mbi 9 milionë euro të kursyera për bizneset nëpërmjet përshtetimit të procedurave dhe zhdoganimit. Është arritur përparim në heqjen dhe uljen e tarifave për eksportuesit/importuesit në терминаlet doganore të brendshme, me heqjen e tarifave të importit në терминаlet e Pejës, Podujevës dhe Vërmicës, duke rezultuar në kursime për bizneset në vlerë miliona euro.

Në përputhje me dispozitat e MSA-së BE-Kosovë për ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore (NNA), Kosova duhet të forcojë luftën kundër mashtrimit doganor, në veçanti kontrabandës së produkteve të duhanit dhe duke bashkëpunuar me OLAF-in për të aderuar në Konventën Kornizë të OBSH-së për protokollin e kontrollit të duhanit për të eliminuar tregtinë e paligjshme të produkteve të duhanit. Nuk është raportuar asnjë përparim në lidhje me anëtarësimin.

Sa u përket **kapaciteteve administrative dhe operative**, Kosova vazhdon të marrë pjesë në Programin e BE-së për Dogana dhe në forume të ndryshme në Organizatën Botërore të Doganave. Dogana e Kosovës ka bërë progres përmes zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe rishikimit të udhëzimeve administrative lidhur me transferimin, ngritjen në detyrë dhe proceset meritore e transparente të përzgjedhjes. Deklarimet e pasurisë nga doganierët janë bërë të detyrueshme, me procesin e menaxhuar dhe monitoruar nga Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit.

Kosova ka miratuar planin e ri strategjik afatmesëm të Doganës së Kosovës për periudhën 2024-2028 dhe ka finalizuar raportin për zbatimin e Planit Strategjik Afatmesëm 2019-2023. Janë zbuluar dhe sekuestruara sasi të konsiderueshme lënde narkotike. Në Doganën e Kosovës është vënë në funksion për herë të parë një njësi qensh për të avancuar luftën kundër kontrabandës së armëve, parave të gatshme dhe narkotikëve. Dogana e Kosovës vazhdon të ketë mungesë zyrtarësh. Infrastruktura e zyrave është e pamjaftueshme dhe nuk i plotëson standardet ndërkombëtare.



Ky grupim tematik mbulon transportin (Kapitullin 14); energjinë (Kapitullin 15); Rrjetet trans-evropiane (Kapitullin 21); dhe mjedisin dhe ndryshimet klimatike (Kapitullin 27).

## Kapitulli 14 – Politikat e transportit

*BE ka rregulla të përbashkëta për standardet teknike dhe të sigurisë, për standardet sociale, ndihmat shtetërore dhe liberalizimin e tregut në transportin rrugor, hekurudhat, rrugët ujore të brendshme, transportin multimodal, aviacionin dhe transportin detar.*

Sa u përket **çështjeve të transportit**, Kosova ka vazhduar pjesëmarrjen proaktive në aktivitetet e Komunitetit të Transportit. Në dhjetor 2023, Qeveria ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë së Transportit Multimodal (STMM) 2023-2030. Në qershor, Komiteti i Planifikimit Strategjik i Qeverisë ka miratuar Listën e Projekteve Prioritare për sektorin e transportit. Duhet përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar dhe zbatuar *acquis*-në e BE-së në të gjitha fushat e këtij sektori, si dhe për të përshpejtuar zbatimin e Planeve të Veprimit të Komunitetit të Transportit. Kosova duhet të forcojë kapacitetet e pamjaftueshme administrative dhe operacionale për të përmirësuar koordinimin dhe për të siguruar zbatimin e duhur, në kohë dhe profesional të të gjitha projekteve të infrastrukturës. Kosova duhet të fillojë të përmirësojë qëndrueshmërinë klimatike të transportit dhe përdorimin e lëndëve djegëse alternative dhe të zhvillojë plane të qëndrueshme të lëvizshmërisë urbane duke respektuar standardet mjedisore dhe sociale si dhe duke ndjekur praktikën e BE-së. Në përputhje me Agjendën e Gjellbër dhe Strategjinë e Lëvizshmërisë Smart dhe të Qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor.

Lidhur me **transportin rrugor**, Ligji për rrugët ende nuk është miratuar nga Kuvendi; Ligji i propozuar për rrugët përfshin zhvendosjen e departamenteve të caktuara në një Agjenci Rrugore të sapokrijuar, e cila do të mbikëqyrë planifikimin e infrastrukturës rrugore, masat e sigurisë dhe menaxhimin e përgjithshëm.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përafuar me *acquis*-në e BE-së për rregullat sociale dhe të tregut në transportin rrugor. Në prill, Qeveria ka themeluar Këshillin për Siguri Rrugore, i cili do të monitorojë zbatimin e dokumenteve strategjike, do të koordinojë punën e institucioneve dhe do të propozojë politika për përmirësimin e sigurisë rrugore. Megjithatë, Kosova duhet të përshpejtojë veprimet e saj për të ngritur një sistem të menaxhimit të pasurisë rrugore. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, sistemi ekzistues i të dhënave të aksidenteve në Kosovë nuk është ende në përputhje me protokollin e grupit të përbashkët të të dhënave të aksidenteve (CADaS). Kosova duhet të vazhdojë ngritjen e ndërgjegjësimit për të arritur rezultate më të mira në përputhje me objektivin e OKB-së dhe BE-së për të përgjysmuar numrin e vdekjeve dhe lëndimeve në aksidente rrugore deri në vitin 2030. Përafrimi me Direktivën për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore është ende në pritje. Krijimi i një sistemi për rritjen e kapaciteteve të inspektorëve dhe auditorëve të sigurisë rrugore mbetet prioritet.

Kosova ka bërë progres të kufizuar në zbatimin e *acquis* të **transportit hekurudhor**; Agjencia Rregullativ e Hekurudhave, e cila kryen funksionet e organit rregullator, autoritetit të licencimit dhe sigurisë dhe ndëroperueshmërisë, ka publikuar disa akte legjislative që kanë të bëjnë kryesisht me specifikimet teknike të ndërveprueshmërisë. Tregu i shërbimeve të transportit hekurudhor është i hapur dhe funksional. Është themeluar një Organ Kombëtar Hetimor, i cili i raporton drejtpërdrejt Kabinetit të Kryeministrit. Megjithatë, legjislati për hekurudhat ende duhet të përafrohet plotësisht me tregun dhe shtyllat teknike të paketës së katërt hekurudhore. Hartimi i ligjit të ri për hekurudhat dhe ligji për sigurinë dhe ndëroperueshmërinë hekurudhore është ende në proces. Përkundër përfundimit të punimeve në stacionin e përbashkët hekurudhor me Maqedoninë e Veriut, fillimi i funksionimit të përbashkët është vonuar. Është nënshkruar një kontratë shumëvjeçare ndërmjet menaxherit të infrastrukturës dhe autoritetit përkatës.

Sa i përket **transportit ajror**, Kosova ka bërë progres me hapjen, në janar 2024, të korridoreve të

reja ajrore ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, të cilat do të shkurtojnë kohën e fluturimeve me vendet evropiane deri në 12 minuta dhe do të ndikojnë pozitivisht në aviacionin civil. Sektori vazhdon të përballet me një numër sfidash që dalin nga mosanëtarësimi i Kosovës në disa organizata ndërkombëtare të aviacionit civil. Forca e Kosovës e udhëhequr nga NATO (KFOR) ende menaxhon dhe koordinon hapësirën e sipërme ajrore të Kosovës. Probleme mbesin mangësitë institucionale të Agjencisë së Shkërbimeve të Navigimit Ajror dhe Autoritetit të Aviacionit Civil Evropian, si dhe mungesa e të ardhurave nga menaxhimi i hapësirës së sipërme ajrore. Përpjekjet duhet të vazhdojnë për të përafuar me pikat e mbetura të fazës së parë të Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA).

Sa i përket **transportit multimodal**, ndonëse Qeveria ka miratuar Planin e Veprimit për zbatimin e STMM për periudhën 2023-2030, ai nuk specifikon masat për zhvillimin e infrastrukturës intermodale apo mbështetjen e shërbimeve logjistike efikase dhe të qëndrueshme brenda periudhës 2023-2025.

Sa u përket të drejtave të pasagjerëve të BE-së, Kosova ka miratuar masat kombëtare të transpozimit në lidhje me të drejtat e pasagjerëve që udhëtojnë me rrugë ajrore në kuadër të Marrëveshjes ECAA. Kosova duhet të shtojë përpjekjet e saj për zbatimin e *acquis*-në e BE-së për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha llojet e transportit.

## Kapitulli 15 – Energjia

*Politikat e BE-së për energji mbulojnë furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e ripërtëritshme, eficiencën e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.*

Kosova ka arritur njëfarë progresi sa i përket **sigurisë së furnizimit**. Në janar të vitit 2024, Kosova ka përruar tregun e energjisë elektrike dhe ka nisur bashkimin e tregut të energjisë elektrike me atë të Shqipërisë, i pari i këtij lloji midis Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Nuk ka pasur progres në ristrukturimin e marrëveshjes ekzistuese të furnizimit me shumicë mes Kompanisë së Furnizimit me Energji Elektrike të Kosovës (KESCO) dhe Korporatës Elektrike të Kosovës (KEK).

Sipas kësaj marrëveshjeje, KEK-u rezervon pjesën më të madhe të kapacitetit të tij gjenerues për KESCO-n në masën e nevojshme për të përmbushur obligimet e tij të shërbimit publik. Kosova duhet të ristrukturojë marrëveshjen e furnizimit me shumicë, e cila do të jetë thelbësore për të krijuar një treg të qëndrueshëm, të drejtë dhe konkurrues dhe për të mbështetur funksionimin e suksesshëm të ALPEX.

Devijimet e konsiderueshme të zonës së kontrollit të Kosovës në Kosovë vazhduan deri në fund të vitit 2023. Megjithatë këto devijime nga rrjeti evropian kaluan nga negative (në vitin 2023) në pozitive (në vitin 2024), kjo ende çon në çekuilibre që mund të rrezikojnë frekuencën dhe besueshmërinë e rrjetit. Situata është stabilizuar pas lidhjes së kontratës ndërmjet KEDS-it dhe Elektrosever-it (shih paragrafin më poshtë). Pajtueshmëria me detyrimet sipas Marrëveshjes së Koneksionit të sapa nënshkruar me ENTSO-E është një çështje urgjente.

Një moment historik i rëndësishëm në zbatimin e udhërrëfyesit të rënë dakord për energjinë e qershorit 2022, është lidhja e kontratës komerciale ndërmjet kompanisë së shpërndarjes KEDS dhe Elektroseverit në dhjetor 2023, gjë që ka mundësuar fillimin e faturimit në katër komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe dhe i ka dhënë fund praktikës së parregulluar. Operatori serb i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike EMS ende nuk ka përcaktuar kapacitetet neto të transmisionit në interkoneksionin me Kosovën, gjë që pengon shpërndarjen e kapaciteteve ndërkufitare për pjesëmarrësit e tregut.

Kosova duhet të sigurojë një zbatim me efikasitet dhe dinamik të programit të saj të zbatimit të strategjisë së energjisë për periudhën 2022-2025 për të përmbushur objektivat e saj ambicioze. Kosova mbetet shumë e varur nga termocentralet e vjetruara, shumë ndotëse me qymyr, që

paraqesin rreziqe serioze për shëndetin dhe mjedisin. Kosova është ende në shkelje të kërkesave të Komunitetit të Energjisë për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë nga termocentralet e mëdha me djegie, gjë që kërkon gjithashtu harmonizim me Direktivat e BE-së për impiantet e mëdha me djegie dhe emetimet industriale. Kosova duhet të përshpejtojë përmirësimin mjedisor të termocentralit Kosova B dhe të punojë në dekomisionimin e pjesëve jofunkionale të termocentralit Kosova A. Në qershor, Komiteti i Planifikimit Strategjik i Qeverisë ka miratuar Listën e Projekteve Prioritare për sektorin e energjisë.

Kosova nuk është në përputhje me **acquis për naftën**. Projektligji për rezervat e detyrueshme të naftës është në pritje. Nuk ka procedura për lirimin e rezervave emergjente të naftës.

Sa i përket **tregut të brendshëm të energjisë**, nuk ka pasur progres në hapjen e mëtejshme të tregut me pakicë. Kosova është vonuar në transpozimin dhe zbatimin e Paketës së Integritimit të Energjisë Elektrike, e cila është parakusht për integrimin e tregut. Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës (ZRRE) ende duhet të zbatojë liberalizimin e tregut me pakicë të energjisë elektrike bazuar në çmimin e tregut. Në prill të vitit 2024, Bordi i ZRRE-së ka miratuar të hyrat maksimale të lejuara për operatorët e rregulluar dhe tarifat e pakësuara të energjisë elektrike. Kosova duhet të krijojë një regjistër gjithëpërfshirës të konsumatorëve në nevojë dhe të caktojë një objektiv kombëtar për të mbështetur familjet dhe konsumatorët në nevojë për energji në përputhje me objektivat e PKEK. Kosova duhet të miratojë PKEK-në e saj sa më shpejt që të jetë e mundur.

Sa u përket **burimeve të ripërtëritshme të energjisë**, Kosova ka miratuar Ligjin për burimet e ripërtëritshme të energjisë në prill të vitit 2024. Ky ligj është i harmonizuar me Direktivën për Energjinë e Ripërtëritshme dhe krijon një skemë gjithëpërfshirëse të mbështetjes së bazuar në treg për burimet e ripërtëritshme, e cila pritet të lehtësojë ankandet e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Kosova ka përfunduar me sukses ankandin e parë të energjisë diellore, në mars 2024, dhe në maj 2024 ka nënshkruar marrëveshje për zhvillimin e projektit. Procesi ka qenë i hapur, transparent dhe i mirëpritur nga investitorët e interesuar. Ofertuesit fitues do t'i jepet një kontratë koncesioni 30-vjeçare për ndërtimin dhe funksionimin e centralit diellor, shoqëruar me një marrëveshje 15-vjeçare për blerjen e energjisë elektrike.

Për të arritur objektivat e saj strategjike për një pjesë prej 35% të energjisë së rinovueshme në energjinë elektrike të konsumuar deri në vitin 2031, Kosova duhet të përshpejtojë vendosjen e projekteve të energjisë së ripërtëritshme dhe të nisë menjëherë ankandin e parë të ardhshëm të erës për të cilin draft kriteret janë publikuar në korrik 2024 dhe të cilat do të jenë 75 MW. Mësimet e nxjerra nga ankandi i parë pilot i energjisë diellore, në të cilin ka pasur vonesa të konsiderueshme, duhet të merren parasysh në proceset e mëpasshme të ofertave konkurruese. Është nënshkruar marrëveshja ndërmjet ZRRE-së dhe ofruesit të shërbimeve për shfrytëzimin e regjistrit elektronik kombëtar për garancitë e origjinës. Dispozitat që lidhen me qëndrueshmërinë dhe kriteret e kursimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, biomasën dhe biolikuidet që rrjedhin nga Direktiva e Energjisë së Rinovueshme (RED II) duhet ende të harmonizohen.

Sa i përket efijencës së energjisë, është arritur progres i mirë me zbatimin e masave të efijencës së energjisë në sektorin e amvisërisë dhe atij privat si pjesë e Paketës për Mbështetjen e Energjisë të financuar nga BE. Modeli financiar për investimet në sektorin e amvisërisë është në zhvillim e sipër. Kosova ende duhet të miratojë Ligjin e ri për efijencën e energjisë. Ligji i amendamentuar për performancën energjetike të ndërtesave është miratuar në maj 2024. Miratimi dhe zbatimi i Direktivës së Etiketimit mbetet në pritje. Për të përmirësuar efijencën e energjisë, siç është paraparë në Strategjinë e Energjisë, Kosova duhet të mobilizojë financim shtesë dhe të forcojë kapacitetet institucionale për të zbatuar dhe monitoruar kursimet shoqëruese.

Kapacitetet e Agjencisë së Sigurisë Bërthamore dhe Mbrojtjes nga Rrezatimi janë të dobëta. Kosova ende duhet të sigurojë trajtimin dhe ruajtjen e përkohshme të mbeturinave radioaktive në përputhje me standardet e BE-së. Nuk ka pasur progres në lidhje me pjesëmarrjen e Kosovës në shkëmbimin

urgjent të informacionit radiologjik të Komunitetit Evropian (ECURIE) dhe në platformën evropiane të shkëmbimit të të dhënave radiologjike EURDEP. Kosova nuk është anëtare e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), as palë e ndonjë konvente dhe marrëveshjeje për mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore.

## Kapitulli 21 – Rrjetet trans-evropiane

*BE promovon Rrjetet trans-evropiane (TEN) në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe energjisë për të forcuar tregun e brendshëm dhe për të kontribuar në rritje dhe punësim.*

Progresi në Rrjetin e **Transportit** Trans-Evropian (TEN-T) është i kufizuar, kryesisht për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme ndër-institucionale për të siguruar analiza realiste të kostos/përfitimit, standardeve të BE-së, rregullat e prokurimit publik, ndihmën shtetërore dhe vlerësimet e ndikimit në mjedis. Rregullorja e rishikuar TEN-T 2024/1679 e datës 13 qershor 2024 po krijon një korridor të ri transporti Ballkani Perëndimor-Mesdheu Lindor i Evropës që përfshin Kosovën.

Nuk ka përparim as në autostradën Prishtinë – Merdare as në 'Autostradën e Pages'. Punimet hekurudhore në korridorin Orient/East-Med (Rruga hekurudhore 10) që lidh Fushë Kosovën me Mitrovicën vazhduan me ritëm të ngadaltë. Tenderimi i sistemeve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit, i cili është me prioritet të madh, është ende i vonuar. Studimi i fizibilitetit për lidhjen hekurudhore midis Durrësit dhe Prishtinës është duke u zhvilluar.

Sa u përket **rrjeteve të energjisë**, në janar 2024, integrimi i tregut të energjisë elektrike me Shqipërinë ka përparuar me inaugurimin e tregut një ditë përpara në Kosovë dhe fillimin e bashkimit të tregut një ditë përpara të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë, i pari i këtij lloji në Komunitetin e Energjisë. Kosova gjithashtu ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi për lidhjen e tregut të energjisë elektrike me Greqinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Rregullorja e vjetër TEN-E 347/2013 është përafuar dhe zbatuar. Kosova ende duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me Rregulloren e rishikuar të TEN-E 2022/869.

Sa u përket **rrjeteve të telekomunikacionit**, kapaciteti institucional i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare duhet të rritet ende.

## Kapitulli 27 – Mjedisit dhe ndryshimet klimatike

*BE promovon veprim të fortë klimatik, zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit. Rregullat e BE-së përbajnë dispozita që adresojnë ndryshimet klimatike, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.*

### Mjedisit

Lidhur me çështjet horizontale, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rishikuar dhe miratuar strategjitë, planet e veprimit dhe legjislacionin përkatës për të siguruar konsistencën me objektivat e Agjendës së Gjelbër dhe zbatimin e angazhimeve sipas Udhërrëfyesit të Dekarbonizimit të Komunitetit të Energjisë. Kapacitetet e autoriteteve mjedisore si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal për të zbatuar dhe fuqizuar *acquis* mjedisor janë ende shumë të kufizuara, gjë që pengon seriozisht progresin në këtë sektor. Reformat strukturore vazhdojnë të vonohen. Angazhimi dhe financimi i pamjaftueshëm politik përbëjnë sfidat kryesore për zbatimin e kornizës strategjike. Miratimi i strategjisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm për periudhën 2022-2033 mbetet në pritje. Përafrimi i plotë me Direktivat e BE-së për Përgjegjësinë Mjedisore dhe për Krimin ende nuk është përfunduar. Zbatimi i legjislacionit për vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis nuk zbatohet në mënyrë të vazhdueshme. Në qershor 2024, Komiteti i Planifikimit Strategjik i Qeverisë ka miratuar Listën e Projekteve Prioritare për sektorin e mjedisit. Duhet të sigurohet cilësia e përgatitjes dhe zbatimit të investimeve në infrastrukturë, duke përfshirë transparencën e procedurave, në përputhje me Direktivën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe

Direktivën Strategjike të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe elementë të tjerë të *acquis*. Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit është ende i kufizuar.

Ndërsa është bërë njëfarë progresi në përmirësimin e **cilësisë së ajrit**, ai vazhdon të paraqesë një rrezik të madh për shëndetin mes vonesave në zbatimin e masave të duhura korigjuese për të frenuar ndotjen e ajrit. Zbatimi i planit për cilësinë e ajrit në Prishtinë ka filluar me futjen e autobusëve të rinj të transportit publik dhe aplikimin e masave të kontrollit për gazrat e shkarkimit nga automjetet, por miratimi i planeve në pjesën tjetër të Kosovës është ende në pritje. Kosova ende nuk është në përputhje me kufijtë e emetimeve të përcaktuara me planin e saj për reduktimin e emetimeve. Zbatimi i masave që ndalojnë përdorimin e qymyrit për ngrohje duhet ende të zbatohet. Vazhdon puna për planet e cilësisë së ajrit për zonat ku nivelet e ndotësve i kalojnë vlerat kufitare.

Zbatimi i legjisllacionit për **menaxhimin e mbetjeve** ka shënuar progres, me miratimin e legjisllacionit zbatues për eksportin, importin, transitin dhe lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve, si dhe miratimin e legjisllacionit për paketimin dhe mbetjet e paketimit, i cili paraqet një bazë për të zgjeruar përgjegjësinë e prodhuesit dhe zbatimin e parimit 'ndotësi paguan'. Përveç kësaj, po zhvillohen aktivitete që synojnë reduktimin e përdorimit të qeseve plastike transportuese të lehta dhe futjen e një sistemi të rimbursimit të depozitave për kontejnerët e pijeve. Së fundi, numri i vend-deponimeve ilegale ka vazhduar të bjerë në mënyrë të vazhdueshme, nga 747 në vitin 2022, në 373 në vitin 2023, që përbën një reduktim prej 374 deponi ilegale.

Kapaciteti shumë i kufizuar inspektues i institucioneve të nivelit qendror duhet të rritet urgjentisht. Nevojiten më shumë përpjekje për të amenduar Ligjin për menaxhimin e mbeturinave dhe strategjinë e menaxhimit të integruar të mbeturinave duke futur objektiva për riciklimin, si dhe për të miratuar dhe zbatuar planet ndërkomunale të menaxhimit të mbeturinave. Kosova gjithashtu duhet të fillojë një reformë të ndërmarrjeve komunale, të sigurojë menaxhimin e duhur të mbeturinave industriale dhe të rrezikshme dhe të nxisë ekonominë qarkore. Kompania Energjetike e Kosovës (KEK) duhet të kryejë procedurën e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme.

Kosova ka bërë progres të kufizuar në **menaxhimin e ujërave** duke miratuar dhe zbatuar strategjinë e saj të rishikuar të ujit. Pritet miratimi i ligjit të ri për ujërat dhe miratimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore.

Kapacitetet e institucioneve kyçe si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, ndërmarrjeve publike dhe autoriteteve të menaxhimit të pellgjeve lumore mbesin të ulëta dhe kanë nevojë për fuqizim të mëtejshëm. Mungesa e identifikimit të aglomerateve dhe zonave të ndjeshme në përputhje me Direktivën e BE-së për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, si dhe mungesa e një strategjie për menaxhimin e llumit pengojnë përparimin në infrastrukturë. Nuk ka pasur progres në harmonizimin e legjisllacionit për menaxhimin e ujërave dhe përmbytjet me *acquis*-në e BE-së në periudhën raportuese. Nevojiten më shumë përpjekje për reduktimin e humbjeve të ujit dhe menaxhimin e zonave mbrojtëse ujore.

Kosova ka bërë progres të kufizuar në **mbrojtjen e natyrës** me përcaktimin e tri zonave të reja të mbrojtura. Kosova duhet të fillojë identifikimin dhe paracaktimin e vendeve që do të mbulohen nga rrjeti Natura 2000. Atyre u mungon menaxhimi i duhur, vazhdojnë të jenë të ndotura dhe të keqmbajtura, vuajnë nga aktivitete të paligjshme dhe kapacitete të pamjaftueshme zbatuese në nivel qendror dhe lokal. Miratimi i draft strategjisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm për periudhën 2022-2033 mbetet në pritje. Gjithashtu nuk ka pasur progres në harmonizimin e legjisllacionit për mbrojtjen e natyrës. Identifikimi i vendeve potenciale të Natura 2000 është në një fazë shumë të hershme. Kosova ka bërë progres të kufizuar në zbatimin e Ligjit dhe strategjisë për pylltari. Shpyllëzimi dhe prerja e paligjshme e pyjeve mbesin një çështje shqetësuese serioze.

Nuk ka pasur përparim në përafrimin me *acquis* për **ndotjen industriale** dhe zbatimi i parandalimit

dhe kontrollit të ndotjes industriale është shumë i ngadaltë. Mbetjet e rrezikshme të minierave si dhe shkarkimet industriale në lumenj dhe deponitë industriale vazhdojnë të përbëjnë kërcënim serioz për tokën, ujin dhe shëndetin. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të përafuar me *acquis*-në e BE-së në lidhje me Direktivën e Emetimeve Industriale dhe për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e duhur.

Nuk ka pasur përparim në përafrimin me *acquis*-në e BE-së për **kimikatet**. Zbatimi i legjislacionit përkatës mbetet në nivel të ulët. Kosova ende duhet të përmirësojë zbatimin e kornizës rregullative për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.

Nuk është arritur ndonjë përparim në përafrimin me *acquis*-në e BE-së për **zhurmën**.

Sa i përket **mbrojtjes civile**, Kosova ka bërë disa përparime me miratimin e planit kombëtar të reagimit ndaj fatkeqësive, dhe miratimin e Strategjisë për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera për periudhën 2023-2028. Koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal është ende i pamjaftueshëm Kosova nuk ka bërë përparim në zhvillimin e vlerësimit kombëtar të nevojave për rrezikun nga fatkeqësitë dhe nuk ka hartuar një strategji për rimëkëmbje. Kosova duhet të bëjë më shumë përpjekje për të përgatitur legjislacionin si dhe kornizën qeverisëse dhe financiare për parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Kosova duhet të përmirësojë koordinimin ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në fatkeqësitë në shkallë të gjerë. Edhe pse nuk është pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Unionit (UCPM), Kosova përfiton nga mjete të ndryshme në kuadër të UCPM-së (projekte, sesione trajnimi, ushtrime, vlerësime nga kolegët dhe misione këshilluese).

#### Ndryshimet klimatike

Kosova ka bërë progres në ndryshimet klimatike duke miratuar Ligjin për ndryshimet klimatike. Megjithatë, një objektivi i neutralitetit klimatik për vitin 2050 mungon dhe miratimi dhe zbatimi i legjislacionit zbatues është në pritje. Miratimi i strategjive të dekarbonizimit dhe përshtatjes është gjithashtu në pritje. PKEK duhet të miratohet sa më shpejt të jetë e mundur. Korniza legjislative për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin e emetimeve të gazeve serrë duhet të zhvillohet dhe zbatohet si dhe një mekanizëm për çmimin e karbonit me synimin për t'u përafuar me sistemin e tregtimit të emetimeve të BE-së. Paralelisht, Kosova duhet të zbatojë masat e adaptimit dhe zbutjes. Duhet të merret parasysh gjithashtu përafrimi me përmirësimet kryesore të politikës klimatike të BE-së si rezultat i paketës 'Fit for 55'.

Kapaciteti i institucioneve përkatëse, përfshirë inspektimet, për të përmbushur përgjegjësitë e tyre duhet të forcohet urgjentisht dhe në mënyrë të konsiderueshme. Së fundi, ndërgjegjësimi duhet të forcohet dhe bashkëpunimi me operatorët në sektorin privat duhet të bëhet më efikas.

### **GRUPIMI TEMATIK 5: RESURSET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI**

Ky grupim tematik mbulon bujqësinë dhe zhvillimin rural (Kapitullin 11); sigurinë e ushqimit, politikat e veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë (Kapitullin 12); peshkatarinë dhe akuakulturën (Kapitullin 13); politikat rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore (Kapitullin 22); dhe dispozitat financiare dhe ato buxhetore (Kapitullin 33).

#### **Kapitulli 11 – Bujqësia**

*Politika e përbashkët bujqësore e BE-së mbështet fermerët dhe siguron sigurinë ushqimore të Evropës. Ajo ndihmon në trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve kombëtare; mirëmban zonat rurale dhe peizazhet në të gjithë BE-në; dhe mban gjallë ekonominë rurale duke promovuar vende pune në bujqësi, industri agroushqimore dhe sektorë të ndërlidhur. Kjo kërkon sisteme të fuqishme të menaxhimit dhe kontrollit. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të përbashkëta të BE-së për standardet e marketingut, politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike.*



Sa i përket **çështjeve horizontale**, në tetor 2023 është miratuar Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2023-2027. Masat mbështetëse duhet të harmonizohen me *acquis*-në e BE-së.

Kosova duhet të forcojë dhe ruajë kapacitetet e saj dhe të ndërmarrë hapa drejt zhvillimit të një sistemi të integruar të administrimit dhe kontrollit, rrjetit të të dhënave për qëndrueshmërinë e fermave.

Sa i përket **organizimit të përbashkët të tregut**, Ligji për organizimin e tregut të produkteve bujqësore është miratuar në dhjetor të vitit 2023. Legjislacioni zbatues i tij duhet të përgatitet.

Sa i përket **politikës së cilësisë**, Kosova ka vazhduar të bëjë progres me regjistrimin e indikacionit të dytë gjeografik. Megjithatë, procesi i regjistrimit dhe kontrollit duhet të përafrohet me *acquis*-në e BE-së.

Sa i përket **bujqësisë organike**, legjislacioni duhet të përafrohet me *acquis*-në e BE-së, duhet të zbatohet plani kombëtar i veprimit organik 2023-2026 dhe duhen ndërmarrë veprime për t'i dhënë përparësi bujqësisë dhe prodhimit organik si një element ndërsektorial në kuadër të programit kombëtar për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Kosova ende duhet të ndryshojë ose shfuqizojë Ligjin për tokën bujqësore dhe një plan veprimi për të adresuar humbjen dhe degradimin e tokës bujqësore.

## **Kapitulli 12 – Siguria e ushqimit, politikat e veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë**

*Acquis i BE-së për ushqimin, duke përfshirë rregullat e higjienës së BE-së për prodhimin e produkteve ushqimore, sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë së ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë dhe një mbrojtje të nivelit të lartë të interesave të konsumatorëve. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria e ushqimit me origjinë shtazore ruhen së bashku me cilësinë e farërave, materialit mbrojtës të bimëve, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.*

Në fushën e **sigurisë ushqimore**, Kosova ende duhet të miratojë legjislacionin dytësor për Ligjin për ushqimin dhe strategjinë për përafrimin me *acquis*-në e BE-së në fushën e politikës veterinarë dhe fitosanitare. Burimet financiare dhe njerëzore të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë mbeten të pamjaftueshme për të zbatuar *acquis*-në e BE-së.

Sistemi i gjurmueshmërisë dhe menaxhimit të kontrollit të ushqimit dhe sistemi i menaxhimit të informacionit laboratorik janë funksionalë, por nevojiten më shumë burime për t'i forcuar dhe mirëmbajtur në mënyrë sistematike. Pas transferimit të 58 inspektorëve në Ministrinë e Shëndetësisë, agjencia duhet të rekrutojë me zell inspektorët e ushqimit, të krijojë një njësi epidemiologjike dhe të zbatojë legjislacionin përkatës lidhur me qasjen e bazuar në rrezik në inspektimet brenda Kosovës si dhe në importe.

Agjencia ka vazhduar punën e saj për zbatimin e planit kombëtar për kontrollin dhe monitorimin e ushqimit dhe sëmundjeve të kafshëve dhe ka përfunduar me sukses skemat e detyrueshme të testimit të aftësisë me laboratorët referencë të BE-së si pjesë e akreditimit laboratorik.

Në fushën e **politikave të veterinarisë**, ndërsa Kosova mori nga BE financimin e fushatës për çrrënjosjen dhe vaksinimin për tërbimin, **Qeveria** duhet të miratojë ende një ligj për shëndetin e kafshëve dhe të shfuqizojë ligjin e vitit 2004 për veterinarinë me një ligj të ri. Agjencia ende nuk ka miratuar planin pesë-vjeçar të zhvillimit për monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve dhe nuk ka caktuar burime për zbatimin e tij. Burimet për kontrollet e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve në nivel ferme, gjatë transportit mbeten të pamjaftueshme, duke përfshirë thertoret dhe tregjet e bagëtive. Kosova ka miratuar një udhëzim të ri administrativ për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve. Megjithatë, lëvizjet e kafshëve mbeten të nën-raportuara dhe kontrollet ende nuk janë forcuar. Kosova duhet të përfundojë harmonizimin e legjislacionit të saj me legjislacionin e BE-së për mirëqenien e kafshëve dhe të sigurojë burime adekuate për zbatimin e tij. Kosova ka arritur njëfarë



progresi në identifikimin e masave të përputhshmërisë në fushat e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve. Janë përgatitur listat kontrolluese dhe udhëzimet përkatëse.

Sa i përket **vendosjes në treg të ushqimit për njerëz, ushqimit për kafshë dhe nënprodukteve të kafshëve**, vendimtar mbetet zbatimi i një sistemi për grumbullimin dhe asgjësimin e sigurt të nënprodukteve shtazore si dhe miratimi i modelit për funksionimin e fabrikës ekzistuese të riprodhimit. Kosova ka adresuar gjetjet e Komisionit Evropian për planin kombëtar të monitorimit të mbetjeve.

Në fushën e **politikës fitosanitare**, përafrimi me *acquis*-në e BE-së ende duhet të përmirësohet. Është e rëndësishme të forcohen veprimet në lidhje me anketat, zbulimin e hershëm dhe çrënjosjen e dëmtuesve. Së fundi, Kosova ende nuk ka filluar të punojë në zhvillimin e bazës ligjore për ushqimin e ri dhe për **organizmat e modifikuar gjenetikisht**.

### **Kapitulli 13 – Peshkataria dhe akuakultura**

*Politika e përbashkët e peshkatarisë përcakton rregulla për menaxhimin e peshkatarisë, mbron burimet e gjalla të detit dhe kufizon ndikimin mjedisor të peshkatarisë. Kjo përfshin përcaktimin e kuotave të kapjes, menaxhimin e kapacitetit të flotës, rregullat për kontrollin dhe inspektimin, rregullat për tregjet dhe akuakulturën, si dhe mbështetjen për peshkatarinë dhe komunitetet bregdetare. Më tej, ajo promovon një akuakulturë të qëndrueshme.*

Pasi që Kosova ka vetëm peshkim dhe akuakulturë të brendshme, *acquis* për kuotat e peshkimit, inspektimit dhe kontrollit është i zbatueshëm vetëm pjesërisht. Kosova duhet të hartojë një ligj për peshkim dhe akuakulturë për t'u përafuar me *acquis*-në e BE-së.

Miratimi i strategjisë shumëvjeçare kushtuar akuakulturës dhe përafrimin e legjislacionit me *acquis* është ende në pritje.

Kosova duhet të fokusohet në krijimin e një **politike të tregut** dhe mbledhjes së të dhënave në përputhje me *acquis* si dhe një inventari të llojeve të peshkut. Kosova po ashtu duhet të rrisë shumë kapacitetin administrativ për menaxhimin e politikave dhe **inspektimin dhe kontrollin**.

Nuk pati asnjë zhvillim të rëndësishëm në lidhje me **menaxhimin e burimeve dhe flotës, masat strukturore, ndihmën shtetërore dhe marrëveshjet ndërkombëtare**.

### **Kapitulli 22 – Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore**

*Politika rajonale është mjeti kryesor i BE-së për reduktimin e pabarazive rajonale dhe investimin në rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse socio-ekonomike. Ajo funksionon përmes “menaxhimit të përbashkët” ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare të BE-së. Zbatimi i programeve të politikës së kohezionit kërkon kapacitete të përshtatshme administrative në nivel të programit dhe projektit, krijimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të shëndoshë financiar dhe gjithashtu përmbushjen e elementeve të tjera të *acquis*-në e BE-së, siç janë legjislacioni mjedisor ose i prokurimit publik.*

Ka përparim të mirë në **kornizën ligjore** duke mbështetur zhvillimin rajonal, veçanërisht sa i përket rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse (*shih edhe Kapitujt 15, 27 dhe 19*). Eurostat ka miratuar klasifikimin e rajoneve statistikore në Kosovë, i cili do të lehtësojë krijimin e statistikave rajonale në përputhje me standardet e BE-së. Sa i përket kornizës strategjike, është arritur njëfarë progresi me miratimin e planit të veprimit 2023-2025 për zhvillimin rajonal, i cili megjithatë tregon një rënie graduale të financimit për rajonet e Kosovës gjatë periudhës 3-vjeçare (2023: 4.3 milionë euro; 2024: 3.4 milionë euro; 2025: 3.3 milionë euro).

**Korniza institucionale** për menaxhimin e fondeve të BE-së ende nuk është vendosur dhe kjo ndikon gjithashtu në **sistemet e menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit për fondet e BE-së**, të cilat mbeten në një fazë të hershme. Sistemet kombëtare për zhvillim rajonal janë të dobëta për

shkak të mungesës së fondeve, përfshirjes së pamjaftueshme të aktorëve të zhvillimit rajonal dhe bashkëpunimit të dobët ndërkomunal; ato duhet të forcohen ndjeshëm për të nxitur rritjen rajonale dhe për të adresuar pabarazitë rajonale. **Kapaciteti administrativ** i institucioneve kyçe të përfshira në programimin dhe menaxhimin e fondeve të BE-së po përmirësohet gradualisht, por në përgjithësi mbetet i dobët për shkak të vonësive në reformën e administratës publike dhe mungesës së mekanizmit efektiv për trajnimin mbi çështjet e BE-së.

Kosova ende duhet të përmirësojë planifikimin dhe menaxhimin e investimeve publike dhe të zhvillojë listat solide të projekteve të vetme.

Kosova ka avancuar në **monitorimin dhe vlerësimin** e asistencës së BE-së me drejtim të përmirësuar nga Koordinator i Instrumentit Kombëtar për Asistencën e Para-Aderimit (IPA), dialogu i rregullt me BE-në dhe raportimi vjetor i përmirësuar. Kosova duhet të përparojë më tej në këtë fushë dhe të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Monitorues të IPA-s dhe procesit të MSA-së.

Në dhjetor 2023, Kosova ka nënshkruar tri marrëveshje financimi për bashkëpunim ndërkufitar me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi për periudhën 2021-2027. Kosova nuk merr pjesë në programet e bashkëpunimit transnacional dhe ndërrajonal që mbulojnë Ballkanin Perëndimor.

## GRUPIMI TEMATIK 6: MARRËDHËNIET ME JASHTË

Ky grupim tematik mbulon marrëdhëniet me jashtë (Kapitullin 30).

### Kapitulli 30 – Marrëdhëniet me jashtë

*BE ka një politikë të përbashkët tregtare ndaj vendeve të treta, bazuar në marrëveshje shumëpalëshe dhe dypalëshe dhe masa autonome. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të BE-së në fushën e ndihmës humanitare dhe politikave zhvillimore.*

Sa i përket **politikës së përbashkët tregtare**, Kosova nuk ka miratuar një politikë gjithëpërfshirëse tregtare as nuk ka ratifikuar Protokollin Shtesë të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe tregtinë e shërbimeve as nuk ka miratuar së fundmi protokollin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Qeveria mbështet TPR-në si bazë për një marrëveshje rajonale të tregtisë së lirë.

Kosova vazhdon të arrijë progres në zbatimin e masave teknike të planit të veprimit CRM për periudhën 2021-2024, veçanërisht në lidhje me korsitë e gjelbra. Rreth 11 operatorë ekonomikë të autorizuar janë licencuar në vitin 2023. Është përditësuar shkëmbimi sistematik i të dhënave elektronike. Qeveria ka miratuar projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale të Infermierëve, Kirurgëve, Veterinerëve, Farmacistëve dhe Mamive në kuadër të CEFTA-s.

Ka nevojë urgjente për të forcuar kapacitetet në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përfshirë numrin e personelit, veçanërisht duke pasur parasysh përgjegjësitë e ardhshme të kryesimit të CEFTA-s të Kosovës në vitin 2025, por edhe negociatat tregtare.

Mosmarrëveshjet në lidhje me përfaqësimin dhe emërtimin e Kosovës në **CEFTA** janë zgjidhur, për të mundësuar zhblokimin e mekanizmave vendimmarrës të CEFTA-s. Kosova, së bashku me të gjithë pjesëmarrësit në planin e veprimit për TPR, duhet të luajë rol konstruktiv dhe të përmbushë zotimet e përbashkëta të përcaktuara në planin e veprimit. Ndalesa për mallrat me origjinë nga Serbia, i vendosur në qershor 2023, është hequr në tetor 2024 dhe zëvendësuar me një sistem kontrollesh manuale. Në korrik 2023, pas kërkesave të komunitetit afarist, Qeveria ka hequr një masë të tillë për lëndët e para dhe gjysmëproduktet.

Ligji i Kosovës për **mallrat me përdorim të dyfishtë** është në përputhje me *acquis* më të fundit të BE-së, konkretisht Rregullorja (BE) 2021/821 dhe përditësimet e saj vjetore në lidhje me listën e artikujve me përdorim të dyfishtë. Kosova nuk është as pjesëmarrëse dhe as anëtare e Grupit

Australia.

Sa u përket **marrëveshjeve dypalëshe me vendet e treta për bashkëpunimin ekonomik / tregtar / teknik**, Kosova ka marrëveshje të tregtisë së lirë me Turqinë dhe Mbretërinë e Bashkuar, përveç vendeve të zgjerimit (CEFTA). Negociatat e tregtisë së lirë me vendet e Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë, të nisura në qershor 2022, janë në vazhdim.

Ka pasur progres të kufizuar në fushat e **politikës zhvillimore dhe ndihmës humanitare**. Si përfitues i programeve të ndihmës, Kosova nuk ofron ndihmë humanitare për vendet e treta në mënyrë sistematike dhe nuk ka agjenci për ndihmë zhvillimore. Kosova inkurajohet të fillojë procesin e krijimit të kornizës ligjore që mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe politikat zhvillimore dhe ndihmën humanitare, në përputhje me politikat dhe parimet e BE-së. Kosova gjithashtu inkurajohet të ndërtojë struktura të dedikuara administrative.

## **SHTOJCA I – MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-SË DHE KOSOVËS**

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) BE-Kosovë është në fuqi që nga prilli i vitit 2016. Kjo marrëveshje gjithëpërfshirëse ofron një kornizë për dialogun politik dhe mbulon bashkëpunimin në sektorë të ndryshëm. Që nga viti 2016, janë mbajtur pesë takime të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe shtatë cikle takimesh të nënkomisioneve. Që nga qershori i vitit 2023, në përputhje me masat e BE-së ndaj Kosovës, mbledhjet e organeve të Stabilizim-Asociimit janë pezulluar. Përfaqësuesja e Lartë ka rekomanduar heqjen e këtyre masave.

Më 2 prill 2024, Qeveria ka miratuar Programin Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2024-2028. Ky program parasheh masat dhe prioritetet për zbatimin e MSA-së si dhe reformat e tjera për rrugën evropiane të Kosovës.

Për të udhëhequr më tej zbatimin e reformave në kuadër të MSA-së, në nëntor të vitit 2016, Komisioni dhe Kosova miratuan Agjendën e Reformës Evropiane (ERA). Në vitin 2021, Kosova ka miratuar fazën e dytë të ERA-s (ERA II) përmes një plani veprimi të dedikuar që ka skaduar në vitin 2023 dhe është në pritje të përditësimit.

Kosova zyrtarisht paraqiti kërkesë për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit më 15 dhjetor 2022.

Liberalizimi i vizave për Kosovën ka hyrë në fuqi më 1 janar 2024, duke i lejuar mbajtësve të pasaportave biometrike të Kosovës të udhëtojnë në BE pa vizë për një periudhë qëndrimi prej 90 ditësh brenda çdo periudhe 180-ditore. Pas miratimit përfundimtar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, është hequr kërkesa për viza për mbajtësit e pasaportave të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Serbisë.

Alokimet e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA) III në vargun dypalësh arritën në 233.8 milionë euro për periudhën 2021-2023, nga të cilat 33.3% për reformat themelore dhe 66.7% për rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo gjithashtu përfshin financimin për shoqërinë civile, financimin sipas masave individuale për migrimin dhe menaxhimin e kufijve, dhe ndihmën për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e Unionit si Erasmus+, Programi i Tregut të Vetëm, Programi për Qytetarë, Barazi, të Drejta dhe Vlera, Evropa Kreative, Programi i Doganave, programi Fiscalis, Horizon Europe, Evropa Digjitale dhe programi për Drejtësi. Për të rritur qasjen në iniciativat dhe fondet e BE-së, Kosova po merr pjesë si vëzhguese në një projekt pilot nën Instrumentin e Mbështetjes Teknike.

Kosova vazhdon të përfitojë nga zbatimi i asistencës së BE-së prej 602 milionë euro në kuadër të Instrumentit për Para-anëtarësimin II (2014-2020), 44% e së cilës synon demokracinë, qeverisjen, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, ndërsa 56% është ndarë për konkurrencë dhe rritje.

Kosova gjithashtu merr mbështetje plotësuese në kuadër të programeve shumë-vendëse dhe rajonale dhe në kuadër të tre programeve të bashkëpunimit ndërkufitar – me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi.

Sipas Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), që nga viti 2009, BE ka dhënë 300 milionë euro, duke mobilizuar investime totale prej 2 miliardë eurosh për projektet e infrastrukturës.

Një total prej 315 milionë eurosh nga financimi i BE-së janë vënë në dispozicion për zbatimin e Planit Ekonomik dhe Investiv (PIE) për Kosovën, i cili pritet të mobilizojë 892 milionë euro nga investimet totale për projekte prioritare me ndikim të lartë.

Pas miratimit të masave ndaj Kosovës, BE ka pezulluar programimin e IPA 2024 dhe miratimin e dy projekteve të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Sa i përket mbështetjes së vazhdueshme, procedurat e prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave të reja janë pezulluar.

Në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike Kosova mund të përfitojë nga një alokim indikativ prej 882 milionë euro, që do të kanalizohet nëpërmjet një Agjende reformuese që mbulon

reformat kyçe në pesë fusha të politikave: qeverisja, reforma e administratës publike dhe menaxhim financiar publik; tranzicioni i gjelbër dhe digjital; zhvillimi i sektorit privat dhe Mjedisi afarist; zhvillimi i kapitalit njerëzor; dhe bazat/sundimi i ligjit. Disbursimi i mbështetjes së Unionit do të kushtëzohet me përmbushjen e parakushteve – duke përfshirë, për Kosovën dhe Serbinë, angazhimin konstruktiv në normalizimin e marrëdhënieve të tyre me synimin për të zbatuar plotësisht të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Shtojca e Zbatimit të saj dhe të gjitha Marrëveshjet e Dialogut të kaluar dhe të angazhohen në negociata për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (TPS) të krijuara për të hetuar dhe ndjekur penalisht akuzat që dalin nga Raporti i Këshillit të Evropës për vitin 2011, vazhduan punën e tyre, duke zgjidhur rastet në pritje. Në dhjetor të vitit 2023, DhSK ka marrë vendimin e parë të apelit në një rast që kishte të bënte me krimet e luftës. Rasti ishte tregues i sfidave me të cilat përballlet DhSK, duke përfshirë pengimin e drejtësisë, zbatimin e dënimit dhe kompensimin e viktimave kosovare.

Që nga viti 2008, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka ndihmuar autoritetet e Kosovës në krijimin e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura të sundimit të ligjit. Sipas mandatit të tij aktual (i zgjatur deri në qershor 2025), EULEX-i ka funksione të kufizuara ekzekutive. Ajo vazhdon të kryejë aktivitete monitoruese dhe rolin e reaguesit të dytë të sigurisë përmes Njësisë të Formuara të Policisë. EULEX-i gjithashtu ndihmon DSK/PS-në me mbështetje logjistike dhe operacionale në përputhje me mandatin e tij dhe legjislacionin e Kosovës.

Frontex është duke dërguar zyrtarë e tij në disa pika të kalimit kufitar në Kosovë bazuar në planet operative të dakorduara reciprokisht. Për më tepër, Frontex ofron mbështetje të tjera të lidhura me menaxhimin e kufirit, si këshilla për ngritjen e një qendre koordinimi kombëtare.

Deri më sot, sipas Qeverisë, Kosova është njohur nga 117 vende, duke përfshirë 22 shtete anëtare të BE-së.

Gjatë periudhës raportuese, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka vazhduar të ofrojë përditësime të rregullta mbi zbatimin e misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Forca e Kosovës e udhëhequr nga NATO (KFOR) ka vazhduar të ndihmojë në sigurimin e një mjedisi të sigurt. Në qershor 2024, ajo kishte personel prej 4,490 nga 28 vende kontribuuese.

Kosova ka vazhduar të dënojë agresionin ushtarak të pajustificuar dhe të paprovokuar të Ruisë kundër Ukrainës dhe vazhdon të zbatojë masa kufizuese kundër Ruisë dhe Bjellorusisë. Sa i përket mbështetjes së Kosovës për Ukrainën, Qeveria ka ndarë 100,000 euro ndihmë humanitare dhe fonde të dedikuara për strehimin e 20 gazetarëve nga Ukraina. Kohët e fundit, Kosova ka njoftuar për pakot e para të ndihmës ushtarake për Ukrainën.

## SHTOJCA II - TË DHËNA STATISTIKORE

TË DHËNA STATISTIKORE (deri më 05/09/2024)

Kosova

<b>Të dhënat bazë</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Popullsia (mijë)		1 794 bi	1 799 i	1 796 i	1 782 i	1 798 i	:
Sipërfaqja totale e vendit (km <sup>2</sup> )		10 908 w	10 905 w	10 905 w	10 905 w	10 905 w	10 905 w
<b>Llogaritë kombëtare</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Bruto produkti vendor (BPV) (milionë në valutë kombëtare)		4 556	6 672	7 056	6 772	7 958	8 896
Bruto produkti vendor (BPV) (milionë euro)		4 556	6 672	7 056	6 772	7 958	8 896
BPV (euro për kokë banori)		2 539 bi	3 709 i	3 930 i	3 800 i	4 426 i	:
BPV për kokë banori (në standardet e fuqisë blerëse (SFB))		:	:	:	:	:	:
BPV për kokë banori (në SFB), në raport me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Norma reale e rritjes së BPV-së: ndryshimi i vëllimit të BPV-së në krahasim me vitin e kaluar (%)		6.3	3.4	4.8	- 5.3	10.7	4.3
Rritja e punësimit (të dhënat e llogarive kombëtare), në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	C	C	:	:	:
Rritja e produktivitetit të punës: rritja e BPV-së (në vëllim) për person të punësuar, në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	C	C	:	:	:
Rritja e kostos së punës për njësi, në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	C	C	:	:	:
**Ndryshim 3 vjeçar (T/T-3) në indeksin nominal të rritjes së kostos së punës për njësi (2015 = 100)		:	C	C	:	:	:
Produktiviteti i punës për person të punësuar: BPV (në SFB) për person të punësuar në raport me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		10.0	8.1	9.0	8.9	8.6	9.2
Industria (%)		23.6	24.2	23.4	24.1	23.6	23.3
Ndërtimi (%)		10.4	10.4	10.1	9.3	10.6	10.7
Shërbime (%)		56.0 i	57.2 i	57.5 i	57.7 i	57.2 i	56.9 i
Shpenzimet e konsumit final, si pjesë e BPV-së (%)		100.2	91.9	92.6	98.8	95.9	97.5
Formimi i kapitalit fiks bruto, si pjesë e BPV-së (%)		31.2	31.7	31.0	29.7	32.9	32.5
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV-në (%)		25.0	29.1	29.3	21.7	33.4	38.6
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV-në (%)		61.2	57.3	56.4	53.9	65.2	71.4
Formimi i kapitalit fiks bruto nga sektori i qeverisë së përgjithshme, si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:
<b>Biznesi</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Numri i ndërmarrjeve aktive (numri)		31 556 w	31 028 w	34 615 w	40 056 w	45 468 w	46 157 w
Norma e themelimeve: numri i ndërmarrjeve të themeluara në periudhën e referencës (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		12.7 w	4.8 w	:	:	:	:

Norma e mbylljeve: numri i ndërmarrjeve të mbyllura në periudhën e referencës (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		4.7 w	3.7 w	4.2 w	2.6 w	:	:
Personat e punësuar në NVM si përqindje e të gjithë personave të punësuar (brenda ekonomisë së biznesit jofinanciar) (%)		:	77.6 iw	77.8 iw	80.9 iw	82.1 iw	81.3 piw
Vlera e shtuar nga NVM-të (në ekonominë e biznesit jofinanciar) (milionë euro)		:	:	:	:	:	:
Vlera totale e shtuar (në ekonominë e biznesit jofinanciar) (milionë euro)		:	:	:	:	:	:

<b>Shkalla e inflacionit</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), ndryshim në raport me vitin e kaluar (%)		:	1.1 d	2.7 d	0.2 d	3.4 d	11.6 d

<b>Bilanci i pagesave</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Bilanci i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse (milionë euro)		- 611.4	- 508.8	- 399.5	- 472.2	- 694.6	- 917.0
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milionë euro)		- 2 047.1	- 2 737.7	- 2 840.2	- 2 573.2	- 3 567.0	- 4 287.2
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milionë euro)		395.7	855.8	926.0	391.6	1 034.9	1 367.5
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci neto për të ardhurat primare (milionë euro)		111.2	113.1	160.6	164.0	150.9	119.8
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci neto për të ardhurat sekondare (milionë euro)		928.8	1 260.0	1 354.1	1 545.4	1 686.2	1 881.8
Bilanci neto për të ardhurat primare dhe sekondare: nga të cilat transfere të qeverisë (milionë euro)		322.2	226.1	236.6	276.6	233.7	295.9
**Mesatarja lëvizëse 3-vjeçare e bilancit të llogarisë rrjedhëse në raport me BPV-në (%)		- 12.2	- 7.1	- 6.3	- 6.8	- 7.1	- 8.7
**Ndryshim pesë vjeçar në pjesëmarrjen e eksporteve botërore të mallrave dhe shërbimeve (%)		:	37.5	36.9	14.8	48.5	34.6
Bilanci neto (hyrës - dalës) i investimeve të huaja direkte (IHD) (milionë euro)		378.9 w	225.8 w	188.4 w	286.6 w	320.4 w	556.9 w
Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë vendit (milionë euro)		5.5 w	46.3 w	66.2 w	59.1 w	100.3 w	175.2 w
nga të cilat IHD të ekonomisë raportuese në vendet e BE-27 (milionë euro)		:	13.0	6.1	16.5	26.5	37.8
Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë raportuese (milionë euro)		384.4 w	272.1 w	254.6 w	345.7 w	420.7 w	732.0 w
nga të cilat IHD të vendeve të BE-27 në ekonominë raportuese (milionë euro)		:	58.7	158.6	152.1	215.6	388.9
**Pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare, në raport me BPV-në (%)		2.4 w	- 6.1 w	- 5.8 w	- 12.3 w	- 11.6 w	- 17.9 w
Norma e ndryshimit nga viti në vit në fluksin bruto të remitencave (në valutë kombëtare) nga punëtorët migrantë (%)		10.8 iw	12.0 i	12.1 i	14.5 i	14.5 i	13.7 i

<b>Financat publike</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Deficiti/suficiti i qeverisë së përgjithshme, në raport me BPV-në (%)		:	- 1.0 w	- 0.5 w	- 5.2 w	:	:
Borxhi bruto i qeverisë së përgjithshme në raport me BPV-në (%)		5.3 ew	17.1 ew	17.5 w	21.8 w	:	:
Të ardhurat totale të qeverisë, si përqindje e BPV-së (%)		27.1 w	30.1 w	31.5 w	32.6 w	:	:
Shpenzimet totale të qeverisë, si përqindje e BPV-së (%)		28.8 w	29.6 w	30.5 w	34.4 w	:	:

<b>Treguesit financiarë</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Borxhi i jashtëm bruto i gjithë ekonomisë, në raport me BPV-në (%)		31.4 iw	30.5 iw	31.2 iw	37.2 iw	37.4 iw	38.6 iw
Borxhi i jashtëm bruto i gjithë ekonomisë, në raport me totalin e eksporteve (%)		125.7 w	105.0 w	106.4 w	171.2 w	111.9 w	:
Oferta e parave: M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat njëditore, milionë euro)		:	:	:	:	:	:
Kredia totale nga institucionet financiare monetare për rezidentët (e konsoliduar) (milionë euro)		1 840.9 w	2 939.2 w	:	:	:	:
**Ndryshimi vjetor në detyrimet e sektorit financiar (%)		:	:	:	:	:	:
**Borxhi privat, i konsoliduar, në raport me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
Normat e interesit: norma e parave ditore, në vit (%)		:	:	:	:	:	:
Kurset e këmbimit të euros: mesatarja e periudhës (1 euro = ... valutë kombëtare)		1 w	1 w	1 w	1 w	1 w	1 w
Indeksi i kursit efektiv të këmbimit i ponderuar sipas tregtisë, 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
**Ndryshim 3 vjeçar (T/T-3) në indeksin e kursit efektiv të këmbimit të ponderuar sipas tregtisë, 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e pasurive rezervë (përfshirë arin) (milionë euro)		- 61.2	86.8	95.2	46.3	168.9	67.6
<b>Tregtia e jashtme e mallrave</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022



Vlera e importit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milionë euro)		2 437	3 347	3 497	3 297	4 684	5 639
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milionë euro)		307	368	384	475	756	920
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milionë euro)		- 2 131	- 2 980	- 3 114	- 2 822	- 3 929	- 4 719
Kushtet e tregtisë (indeksi i çmimeve të eksportit / indeksi i çmimit të importit * 100) (numri)		97.2 iw	91.0 iw	94.2 iw	92.6 iw	101.4 iw	87.5 iw
Pjesa e eksporteve në vendet e BE-27 në vlerën e eksporteve totale (%)		43.3 iw	27.5 iw	33.2 iw	34.4 iw	31.5 iw	33.9 iw
Pjesa e importeve nga vendet e BE-27 në vlerën e importeve totale (%)		39.9 iw	42.7 iw	49.1 iw	45.9 iw	44.3 iw	42.4 iw
<b>Demografia</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Shkalla bruto e ndryshimit natyror të popullsisë (shkalla e rritjes natyrore): numri i lindjeve minus vdekjet (për një mijë banorë)		11.5 b	7.7	6.9	7.4 ep	:	:
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave dhe vdekjeve të fëmijëve nën moshën një vjeçare (për një mijë lindje të gjalla)		13.1	10.6	8.7	:	:	:
Jetëgjatësia në lindje: mashkull (vite)		:	:	:	:	:	:
Jetëgjatësia në lindje: femër (vite)		:	:	:	:	:	:
<b>Tregu i punës</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat e moshës 20-64 vjeçare: përqindja e popullsisë 20-64 vjeçare që është ekonomikisht aktive (%)		:	46.6 w	45.2 w	42.9 w	43.9 w	43.2 w
*Shkalla e punësimit për personat e moshës 20-64 vjeçare: përqindja e popullsisë së moshës 20-64 vjeçare që është e punësuar (%)		:	33.2 w	34.2 w	32.3 w	35.1 w	37.9 w
Shkalla e punësimit të meshkujve për personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	52.6 w	53.0 w	48.8 w	51.9 w	55.7 w
Shkalla e punësimit të femrave për personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	14.1 w	15.6 w	16.0 w	18.5 w	20.5 w
Shkalla e punësimit për personat e moshës 55-64 vjeçare: përqindja e popullsisë së moshës 55-64 vjeçare që është e punësuar (%)		:	31.5 w	32.2 w	30.9 w	32.1 w	32.1 w
Punësimi sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		:	3.5 w	5.2 w	4.8 w	2.8 w	2.2 w
Industria (%)		:	14.3 w	15.1 w	16.3 w	14.8 w	13.3 w
Ndërtimi (%)		:	11.9 w	12.6 w	11.1 w	10.5 w	11.0 w
Shërbime (%)		:	70.3 w	67.1 w	67.9 w	71.9 w	73.4 w
Personat e punësuar në sektorin publik si pjesëmarrje në punësimin total, personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	30.8 w	27.6 w	28.7 w	28.3 w	27.7 w
Personat e punësuar në sektorin privat si pjesëmarrje në punësimin total, personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	69.2 w	72.4 w	71.3 w	71.7 w	72.3 w
Shkalla e papunësisë: përqindja e fuqisë punëtore që është e papunë (%)		:	29.4 w	25.5 w	25.8 w	20.6 w	12.5 w
Shkalla e papunësisë së meshkujve (%)		:	28.3 w	22.4 w	23.4 w	18.9 w	11.0 w
Shkalla e papunësisë së femrave (%)		:	33.3 w	34.4 w	32.2 w	24.9 w	16.5 w
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë: përqindja e fuqisë punëtore të moshës 15-24 vjeçare që është e papunë (%)		:	55.4 w	49.4 w	49.1 w	38.0 w	21.4 w
Shkalla e papunësisë afatgjatë: përqindja e fuqisë punëtore që ka qenë e papunë për 12 muaj ose më shumë (%)		:	17.2 w	16.2 w	18.4 w	14.5 w	8.1 w
Shkalla e papunësisë për personat (25-64 vjeçar) që kanë përfunduar më së shumti arsimin e mesëm të ulët (nivelet ISCED 0-2) (%)		:	35.8 w	28.3 w	30.2 w	27.6 w	21.8 w
Shkalla e papunësisë për personat (25-64 vjeçar) që kanë përfunduar arsimin e lartë (nivelet ISCED 5-8) (%)		:	16.8 w	18.0 w	17.0 w	13.7 w	9.7 w
<b>Kohezioni social</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Pagat dhe mëditjet nominale mesatare mujore (valuta kombëtare)		:	453 w	477 w	466 w	484 w	521 w
Indeksi i pagave dhe mëditjeve reale (indeksi i pagave dhe mëditjeve nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2016 = 100)		:	:	:	:	:	:
Koeficienti GINI		:	44 w	46 w	45 w	57 w	:
Hendeku i varfërisë		:	47.4	55.3 w	46.6 w	65.0 w	:
*Të larguarit e hershëm nga arsimi dhe aftësimi: përqindja e popullsisë së moshës 18-24 vjeçare me arsim të mesëm të ulët që nuk është në arsim ose aftësim të mëtejshëm (%)		:	9.6 w	8.2 w	7.8 w	7.0 w	7.8 w

<b>Nivel i jetesës</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i veturave të pasagjerëve në raport me madhësinë e popullsisë (numri për një mijë banorë)		94.9 biw	155.9 iw	162.2 iw	164.4 iw	179.3 iw	191.2 iw
Numri i abonimeve për telefona celularë në raport me madhësinë e popullsisë (numri për një mijë banorë)		:	1 281.1 ew	1 266.4 ew	1 095.0 ew	1 072.0 ew	:
Depërtimit i brezit të gjerë celular (për 100 banorë)		:	73.9 ew	78.4 ew	84.5 ew	88.4 ew	88.2 ew
Depërtimit i brezit të gjerë fiks (për 100 banorë)		:	18 ew	20 ew	21 ew	22 ew	23 ew
<b>Infrastruktura</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linjat në funksionim për mijë km <sup>2</sup> )		30.5 iw	30.5 iw	30.5 iw	30.5 iw	30.5 iw	30.5 iw
Gjatësia e autostradave (kilometra)		38 w	119 w	137 w	137 w	137 w	137 w
<b>Arsimi, inovacioni dhe kërkimi</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Shpenzimet publike për arsim në raport me BPV-në (%)		:	4.5 iw	4.6 iw	4.6 iw	4.3 iw	3.9 iw
*Shpenzimet e brendshme bruto për kërkim dhe zhvillim në raport me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
Ndarjet buxhetore të qeverisë ose shpenzimet për kërkim dhe zhvillim (GBAORD), si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë qasje në internet në shtëpi (%)		:	93.2	93.2	96.4	:	:
<b>Mjedisi</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
*Indeksi i emetimeve të gazrave serrë, ekuivalent të CO2 (1990 = 100)		:	:	:	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg ekuivalent naftë për 1 000 euro BPV me çmime konstante të 2015)		525.2	398.1	392.3	413.9	405.0	358.0
Energjia elektrike e prodhuar nga burime të ripërtëritshme në raport me konsumin bruto të energjisë elektrike (%)		1.4	4.2	5.2	5.3	5.1	5.8
Pjesëmarrja rrugore e transportit të brendshëm të mallrave (bazuar në ton-km) (%)		:	:	:	:	:	:
<b>Energjia</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Prodhimi primar i të gjitha produkteve energjetike (mijë TOE)		1 795	1 822	1 849	1 901	1 937	1 796
Prodhimi primar i naftës së papërpunuar (mijë TOE)		0	0	0	0	0	0
Prodhimi primar i lëndëve djegëse të ngurta (mijë TOE)		1 545	1 428	1 503	1 562	1 591	1 543
Prodhimi primar i gazit (mijë TOE)		0	0	0	0	0	0
Importet neto të të gjitha produkteve energjetike (mijë TOE)		699 i	757 i	815 i	787 i	942 i	858 i
Konsumi bruto i energjisë së brendshme (mijë TOE)		2 541	2 585	2 669	2 665	2 888	2 662
Prodhimi bruto i energjisë elektrike (GWh)		5 801	5 915	6 351	6 711	6 892	6 998
<b>Bujqësia</b>	Shënim	2011	2018	2019	2020	2021	2022
Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor të mallrave dhe shërbimeve (me çmimet e prodhimit) (2015 = 100)		99.3 w	108.3 w	119.0 w	120.5 w	115.3 w	113.3 w
Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar (mijë hektarë)		408.5 e	419.5	421.0	421.1	421.2	421.4
Numri i bagëtive: gjedhe të gjalla (mijë krerë, fundi i periudhës)		:	259.7	257.7	261.4	260.5	250.9
Numri i bagëtive: derra të gjallë (mijë krerë, fundi i periudhës)		:	40.2	40.5	45.4	47.4	45.4
Numri i bagëtive: dele dhe dhi të gjalla (mijë krerë, fundi i periudhës)		:	209.8 i	216.3 i	241.7 i	241.4 i	233.5 i
Qumështi i papërpunuar i disponueshëm në ferma (mijë ton)		:	334.3	:	:	:	:
Prodhimi kulturave të vjela: drithëra (përfshirë orizin) (mijë ton)		435.0	441.8	459.4	529.1	504.4	518.7
Prodhimi kulturave të vjela: panxhar sheqeri (mijë ton)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi kulturave të vjela: perime (mijë ton)		162.1	155.3	177.8	169.4	165.0	175.6

**Burimi: Eurostati dhe/ose autoritetet statistikore në Kosovë**

: = nuk është në dispozicion

b = ndërprerje në seri

c = vlerë konfidenciale

d = përkufizimi ndryshon

e = vlerë e përafërt

p = e përkohshme

i = vlerësim i Eurostatit

w= të dhëna të ofruara nga dhe nën përgjegjësinë e autoritetit kombëtar statistikor dhe të publikuara mbi bazën “siç janë” dhe pa asnjë siguri në lidhje me cilësinë e tyre dhe respektimin e metodologjisë statistikore të BE-së

\* = Tregues i Evropës 2020

\*\* = Tregues i Procedurës së Çekuilibrit Makroekonomik (MIP)